


KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Bashkinë Dibër”

**RAPORT PËRFUNDIMTAR
I AUDITIMIT FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË,
TË USHTRUAR NË BASHKINË DIBËR**

Tiranë, tetor 2021

Nr. Përmbajtja	Faqe
Legjenda dhe shkurtimet	1-2
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2-7
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	
II. HYRJA	8-13
1. Objekti i auditimit.....	
2. Qëllimi i auditimit.	
3. Identifikimi i çështjes.....	
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	
6. Kriteret e vlerësimit.....	
7. Standardet e auditimit.....	
8. Metodatat e auditimit.....	
9. Dokumentimi i auditimit.....	
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	14-14
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
A/1. Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm í í í í í í .	14-16
A/2. Mbi vlerësimin e auditimit të brendshëm publik.....	16-19
B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetití í í í í	19-24
B.1. Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyreí	24-38
C. Vlerësimi i raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitet 2018-2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performances financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisëí ..	38-50
D.1. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publikeí í í	50-82
D.2. Hartimi dhe zbatimi i kontratave të punëve publikeí í	82-89
E. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshmeí ..	89-92
G. Shqyrtim ankeseí ..	93-97
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	98-117
V. ANEKSE	118-225

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.466/1 prot., datë 02.06.2020, nga data 02.06.2020, deri më datën 24.07.2020, në institucionin Bashkia Dibër u krye auditimi ÷Financiar dhe i përputhshmërisë. Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.01.2018 deri më datën 31.12.2020 dhe u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit, si menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, të ardhurat, zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, si dhe u shqyrtua një ankesë. Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohet), të besueshme (burimi nga vjen evidenca) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt akt konstatimet dhe akt verifikimet dhe pas kryerjes së takimit përmbyllës mes palëve nga subjekti u paraqitën kundërshtitë për aktet e mbajtura. Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshtitë, të cilat janë trajtuar nga audituesit përkatës. Projektraporti është kthyer nga subjekti në datën 18.09.2020, protokolluar në KLSH me nr.466/5 prot., dhe në datën 24.09.2020 në ambientet e KLSH u realizua takimi përmbyllës, në të cilin në përfundim nga subjekti nuk ka pasur kundërshtime lidhur me gjetjet e auditimit.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

R.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1.	<p>Gjetje: Llogaria 210 ÷Toka, troje, terreneö, Llogaria 211 “Pyje kullota plantacioneö, Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, Llogaria 213 -Rrugë, rrjete, vepra ujore, në pasqyrat financiare të viteve 2018 e 2019, nuk përfaqsojnë vlerën e saktë të asetëve të njësisë vendore, sepse në këto llogari nuk janë pasqyruar të gjitha asetet, të cilat nuk janë rregjistruar në ZRPP. Për katër llogaritë e mësipërme, njësia vendore nuk ka një listë përfundimtare të asetëve në formën e regjistrimit të aktiveve, me elementët e duhur përbërës, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö, si dhe nuk ka hartuar një plan për regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö, kapitulli IV. pika 74 dhe 96 dhe të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ÷Për</p>	40-45	E lartë	<p>Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtori Ekonomik, të marrin masa për sistemin dhe saktësimin e asetëve të llogarisë 210 ÷Toka, Troje, Terreneö , llogarisë 211 ÷Pyje, kullota, plantacione, llogarisë 212 ÷Ndërtesa e Konstruksioneö llogarisë 213 ÷Rrugë, rrjete, vepra ujoreö, duke kryer inventarizimin e tyre dhe hartimin e regjistrimit kontabël, me të gjitha të dhënat e nevojshme (vendndodhje, sipërfaqja etj.). Në vijim të këtyre veprimeve të merren masa për regjistrimin e këtyre asetëve në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe pasqyrimin në pasqyrat financiare të të gjitha asetëve që njësia vendore administron.</p>

	<i>procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.</i>			
2.	Gjetje: Llogaria 466 <i>ðKreditorë për mjetet në ruajtje</i> (garanci punimesh në masën 5% të vlerës së investimit), në pasqyrat financiare të vitit 2019, ka vlerën 34,394,184 lekë, por njësia vendore ka listë analitike vetëm për vlerën 23,474,067 lekë, për 38 raste, ndërsa diferenca prej 10,920,117 lekë është e pa analizuar, nuk ka dokumentacion vërtetues dhe nuk ka informacion se me cilat investime dhe cilët kontraktorë lidhet kjo garanci punimesh.	40-45	E lartë	Kryetari i Bashkisë Dibër dhe nëpunësi zbatues, të analizojnë dhe saktësojnë përbërjen analitike të vlerës 10,920,117 lekë, të ngurtësuar në thesar, duke përcaktuar arsyen e moslikuidimit, emrin e investimit, emrin e shoqërisë. Të merren në referencë kontratat e lidhura për këtë qëllim, detyrimet e përcaktuara në to dhe të bëhen krahasime nëse vlera e ngurtësuar rakordon me detyrimet e përcaktuara në kontratën dypalëshe. Për këtë të hartohen akte rakordimi midis degës së thesarit Dibër dhe njësisë vendore, me të dhëna të detajuara për shoqëritë dhe investimet.
3.	Në pasqyrat financiare të vitit 2019, Llogaria 401-408 <i>ðFurnitorë e llogari të lidhura me to</i> ka vlerën 167,254,617 lekë, por vlera e kësaj llogarie e shprehur në pasqyrat financiare, nuk rakordon me vlerën që pasqyrojnë librat e kontabilitetit, pasi sipas analizës përbërëse të saj, kjo llogari përbëhet nga detyrimet e njësisë vendore për 78 subjekte në vlerën 42,206,100 lekë. Pra vlera që pasqyrojnë pasqyrat financiare nuk mbështetet në dokumente vërtetues. Vlera prej 125,048,418 lekë është paraqitur tepër në këtë llogari dhe nuk ka dokumentacion mbështetës për të justifikuar këtë diferencë	40-45	E lartë	Drejtoria ekonomike e njësisë vendore të marrë masa për sistemimin e llogarisë 401-408 <i>ðFurnitorë e llogari të lidhura me to</i> , në mënyrë që kjo llogari në pasqyrat financiare të pasqyrojë vlerën reale të detyrimeve që njësia vendore ka ndaj furnitorve. Për këtë të saktësohet nëse ka mangësi në listat analitike, apo mangësia i përket pasqyrave financiare.
4.	Gjetje nga auditimi: Në datën 31.12.2019 Bashkia Dibër ka një vlerë të detyrime të prapambetura prej 288,500,252 lekë, e cila përbëhet nga: - Detyrime për investime në vlerën 125,048,518 lekë; - Detyrime për vendimet gjyqësore në vlerën 124,458,768 lekë; - Detyrime për shërbime në vlerën 36,497,523 lekë; - Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga ish komunat në vlerën 2,495,464 lekë. Detyrimet e prapambetura të cilat janë krijuar si rezultata të mosrealizimit të të ardhurave kanë vlerën 254,778,897 lekë, vlera e detyrimeve që i përket mos alokimit të plotë të fondeve nga FZHR për dy investime të përfunduara në vitin 2017 dhe vitin 2018, ka vlerën 30,116,909 lekë, vlera e detyrimeve që i përket grantit qeveritar (detyrimi i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë për tetë procedura prokurimi për blerje mallra ushqimore për kopshte dhe çerdhe), ka vlerën 3,604,466 lekë.	40-45	E lartë	Nga Kryetari i Bashkisë Dibër të analizohet situata e detyrimeve të prapambetura dhe të nxirren përgjegjësitë për këtë situatë. Të mos marren angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, në mënyrë që të mos krijohen detyrime të reja në vijimësi. Për detyrimet e prapambetura, të hartohet një grafik për likuidimin e tyre, duke zbatuar radhën e pagesave sipas kronologjisë së tyre. Të paraqitet në mbledhjen e këshillit bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara si dhe planin dhe grafikun për likuidimin e tyre. Detyrimet financiare të konstatuara dhe të papaguara ndaj palëve të treta të ulen nën nivelin 15 për qind të

	<p>Bazuar në ligjin nr. 68, datë 27.04.2017, òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, kreun XI-Vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 dhe 56, si dhe në udhëzimin e MF nr. 26, datë 27.09.2019, òProcedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendoreò, konstatohet se njësia vendore Bashkia Dibër ndodhet në vështirësi financiare, pasi vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta është 38% e shpenzimeve vjetore.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar, neni 40 òE drejta për të kryer shpenzimeò;(Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 40-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).</p>			shpenzimeve vjetore.
5	<p>Gjetje:Bashkia Dibër ka lidhur kontrata për dhënien me qira të aseteve të cilat janë pronë e njësisë vendore, llogaritja e vlerës së qirasë nuk është bërë e saktë, duke bërë që qiramarrësit të kryejnë pagesa më të ulta se vlera e duhur, për katër raste në vlerën 8,494,504 lekë, shumë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore.</p>	21-40	E lartë	<p>Nga Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtoria Juridike të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e vlerës prej 8,494,504 lekë, sipas subjekteve dhe vlerave në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Subjekti òA.ò SHPK dhe òB.ò SHPK, për vlerën 3,074,174 lekë; - Subjekti òH. L.ò SHPK, për vlerën 2,386,410 lekë; - Subjekti òL. E.ò SHPK, për vlerën 88,425 lekë; - Subjekti “H. S.ò SHPK për vlerën 2,945,495 lekë
6	<p>Gjetje: Në auditimin e procedurave të prokurimeve të zhvilluara në Bashkinë Dibër, u konstatua se gjashtë procedura prokurimi (pesë procedura të zhvilluara në vitin 2018 dhe një procedurë e zhvilluar në vitin 2020) janë kryer në kundërshtim me nenin 2, òParimet e përzgjedhjesò, nenin 55, òKriteret e përcaktimit të ofertës fitueseò, nenin 24, òAnulimi i një procedure prokurimiò dhe pika 5 e nenit 53, òShqyrtimi i ofertaveò, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër rregullat e prokurimit publikò, i ndryshuar, pasi:</p> <p>Operatorët ekonomikë janë shpallur fitues edhe pse nuk plotësojnë kriteret për kualifikim të vendosura në DST e të miratuara nga Autoriteti Kontraktor. Në të gjitha këto raste tenderi duhej të anulohet. Mos anulimi i procedurës së prokurimit ka çuar në kualifikim dhe shpallje fitues të OE cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, duke shkaktuar paligjshmëri në procedurat e prokurimit publik, në një vlerë prej 33,345,802 lekë.</p>	55-85		<p>Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të analizojë shkaqet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për anomalitë e konstatuara në gjashtë procedurat e mësipërme të prokurimit, në të cilat janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST. Të marrë masa nëpërmjet strukturave përkatëse të prokurimit publik, për eliminimin e praktikave të tilla në të ardhmen.</p>
7	<p>Gjetje:Për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim për largime nga puna të punonjësve, për periudhën janar 2018 - qershor</p>	16-21		<p>Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dibër, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve</p>

	<p>2020, Bashkia Dibër ka shpenzuar vlerën 12,915,472 lekë, ndërsa për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt për çështje të tjera gjyqësore, si òkthim detyrimiò, òshpërblim dëmiò, òdetyrim situacioniò, etj., për të njëjtën periudhë, Bashkia Dibër ka shpenzuar vlerën 54,047,518 lekë.</p> <p>Bashkia Dibër për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, pavarësisht natyrës së çështjes, për periudhën janar 2018 - qershor 2020, ka shpenzuar vlerën 66,962,990 lekë, e cila përbën efekt financiar negativ në buxhetin e njësisë vendore</p>		<p>gjyqësore, të nxjerr përgjegjësitë dhe arsyet që kanë çuar në lindjen e një procesi të tillë gjyqësor, arsyet për humbjen e tyre, që të kuptohet se çfarë praktika janë bërë të gabuara, me qëllim shmangien e tyre në të ardhmen.</p> <p>Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga sektori juridik dhe titullari të zbatohen të gjitha procedurat e nevojshme të afateve të njoftimit dhe të pagesave të duhura ligjore, me qëllim që të ulët risku i humbjes së proceseve gjyqësore. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor titullari të nxjerr përgjegjësitë administrative për personat përgjegjës, si dhe aktin që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.</p>
--	--	--	--

3. Konkluzioni dhe opinionin i auditimit

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare.

Opinion i kundërt. KLSH ka audituar pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Dibër për vitin ushtrimor 2018 dhe 2019, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e fluksit të arkës, pasqyra e lëvizjes së kapitalit si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat. Në opinionin tonë, të cilin e japim për vitin 2019, pasi anomalitë e pa sistemuara të vitit 2018 pasqyrohen në vitin pasardhës, pasqyrat financiare përgjatë përgatitjes dhe raportimit financiar të transaksioneve për ekzekutimin e buxhetit, shoqërohen me mangësi dhe parregullsi të cilat janë materiale dhe të përhapura, në mospërputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare (ISSAI 1700)¹

KLSH ka kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendura në ISSAI-n 5000 -Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare -Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në

¹Opinionin i kundërt shprehet kur ka të dhëna të mjaftueshme se parregullsitë, individualisht apo së bashku janë materiale dhe të përhapura në pasqyrat financiare

përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Grupi i auditimit konstatoi se hartimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2019 nuk ka të përfshirë të gjitha aktivet e katër llogarive kryesore të aktiveve afatgjata materiale: Llogaria 210 òToka, troje, terrene, Llogaria 211 òPyje kullota plantacioneò, Llogaria 212 òNdërtesa e Konstruksioneò, Llogaria 213 òRrugë, rrjete, vepra ujoreò, duke sjellë si pasojë mos pasqyrim të saktë të tyre në pasqyrat financiare. Për këto aktive nuk është hartuar regjistri kontabël, nuk janë përfshirë në procesin e inventarizimit vjetor dhe nuk janë rregjistruar në ZVRPP (sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës).

Llogaria 401-408 òFurnitorë e llogari të lidhura me toò dhe llogaria 466 òKreditorë për mjetet në ruajtjeò, respektivisht për vlerat 125,048,418 lekë dhe 10,920,117 lekë, nuk kanë dokumentacion vërtetues, duke sjellë mos rakordim midis vlerës së pasqyrave financiare dhe vlerës së dokumenteve kontabël.

Për vitin 2019 janë përfituar pa pagesë tre projekte në vlerën 91,950,921 lekë, por kjo vlerë nuk është e rregjistruar në librat e kontabilitetit dhe nuk është e përfshirë në pasqyrat financiare.

Formati nr. 3 (Cash Floë), i pasqyrave financiare ka një vlerë 7,124,450 lekë më shumë se vlera e shpenzimet faktike e rakorduar me degën e thesarit, duke mos pasqyruar saktë shpenzimet faktike të institucionit për vitin 2019.

Opinion mbi përputhshmërinë

KLSH ka audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë vendore me kuadrin rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve publike për vitin 2018 dhe 2019, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit (të ardhurat dhe shpenzimet), menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, etj. Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 4100 shprehim një **opinion të modifikuar**² për përputhshmërinë, për periudhën e auditimit 01.01.2018 deri më datën 30.06.2020.

Baza për dhënien e opinionit

Bazuar në punën e kryer të auditimit, kemi zbuluar se përveç çështjeve të mos përputhshmërisë në fushën e prokurimeve publike, e cila ka të bëjë me anomali materiale por jo të përhapura në kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë, krijimin e detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta në masën mbi 25% të shpenzimeve vjetore, e cila ka krijuar vështirësi financiare për njësinë vendore, vlera e pa arkëtuar prej 47 milion lekë nga debitorët për taksat dhe tarifatat vendore, mangësi kryesisht në fushën e identifikimit dhe vlerësimit të riskut, informacioni mbi çështjen e subjektit të audituar është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e aplikuara. Devijimet e përputhshmërisë nuk janë të përhapura në masën sa të garantojë një opinion të kundërt.

Përgjegjësitë e drejtuesve të njësisë vendore

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshime dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

²Opinion i modifikuar shprehet kur ka të dhëna të mjaftueshme se parregullsitë janë materiale por jo të përhapura

Përgjegjësitë e audituesve të KLSH mbi auditimin

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kritereve të DST, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur përsa i takon çështjeve të audituara, është ose jo në përputhje, në të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

I. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

Mbështetur në ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 për Organizimin dhe funksionimin e KLSHö, në zbatim të Programit të Auditimit nr.466/1 prot., datë 02.06.2020, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 02.06.2020 deri në datën 24.07.2020, në institucionin Bashkia Dibër u krye auditimi financiar dhe i përputhshmërisë. Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.01.2018 deri në datën 30.06.2020.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. B. M., përgjegjës grupi
2. A. Gj., auditues
3. G. H., auditues
4. L. B., auditues
5. A. Z., auditues

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazën e riskut dhe materialitetit.

Gjithashtu, në zbatim të Programit të Ri-Auditimit nr. 99/1, datë 04.02.2021, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 08.02.2021 deri në datën 12.03.2021, në subjektin Bashkia Dibër, për periudhën nga 01.01.2018 deri në 31.12.2020, u krye ri-auditimi mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. H. A., *Përgjegjës Grupi*
2. V. R., *Auditues*
3. R. G., *Auditues*
4. P. S., *Ekspert i Jashtëm*
5. A. K., *Ing. Auditues*

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objekti i auditimit. Auditimi i kryer në Bashkinë Dibër është auditim financiar dhe auditim përputhshmërie. Auditimi ka pasur si objekt pasqyrat financiare, prokurimet publike, të ardhurat, buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullësia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

- Marrja e garancive nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, nëse punët publike janë realizuar mbi bazën e preventivit dhe kontratave të punimeve, mbi përputhshmërinë e zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi në mbledhjen e të ardhurave dhe planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Qëllimi i auditimit. Për pasqyrat financiare: të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Për fushën e prokurimit publik qëllimi i auditimit është të kuptohet se deri në çfarë shkalle subjekti zbaton kuadrin rregullator në fuqi, zbulimi i shkallës së devijimeve nga standardet e pranura dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitetit të menaxhimit financiar, me qëllim që për rastet individuale të identifikuar të detyrohen personat përgjegjës të mbajnë përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen

Identifikimi i çështjes. Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

A/1. Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm.

A/2. Mbi vlerësimin e auditimit të brendshëm publik.

B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.

C. Vlerësimi i raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2018-2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performances financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë.

D. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike dhe zbatimin e kontratave të punëve publike.

E. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

G. Shqyrtim ankese.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Titullarët e njësive publike, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet, sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.

Nëpunësi autorizues z. D. I., me detyrë Kryetar i Bashkisë Dibër dhe Nëpunësi Zbatues z. L. C., me detyrë drejtor ekonomik, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Dibër.

Bazuar në pikën 6 të nenit 34, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”: “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”, neni 91,

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: pika 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;

b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;

ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

Neni 65; “Administrata e njësisë administrative”, pika 1, “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori”.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Dibër, për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, hartimin e pasqyrave financiare dhe inventarizimin e pasurisë; mbi prokurimet me fonde publike dhe zbatimin e kontratave, mbajnë përgjegjësi në lidhje me mangësitë, në shkelje të dispozitave ligjore të përcaktuara nga ligjet nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër rregullat e prokurimit publikò, i ndryshuar dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore në aktivitetin financiar dhe përputhshmërisë. Problematikat dhe përgjegjësitë lidhur me to, të konstatuara gjatë procesit të auditimit, janë evidentuar në akt-konstatimet e mbajtura në Projektraport dhe Raportin përfundimtar të Auditimi.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia e audituesve të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të mund të shprehë një opinionin mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e raportimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar si dhe çështjet që lidhen me zbatimin e procedurave të prokurimit me fonde publike dhe mbi të ardhurat dhe shpenzimet. Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, sipas INTOSAI.

Këto standarde kërkojnë që ne t’i përmbahemi kërkesave etike, profesionale, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse pasqyrat financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesi vlerëson nivelin e kontrollit të brendshëm në entitet, në mënyrë që të programojë procedura auditimit që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit.

Gjatë kryerjes së auditimit, në mënyrë që të jepet një gjykim sa më profesional, objektiv dhe i pavarur, audituesit e grupit kanë zbatuar parimet e mëposhtme me karakter etik:

Parimin e integritetit

Parimin e pavarësisë

Parimin e objektivitetit

Parimin e shmangies së konfliktit të interesit

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë në lidhje me pasqyrat financiare, procedurat e prokurimit publik dhe buxhetin.

Kriteret e vlerësimit. Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë vendore që auditohet) dhe kryesisht:

Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2017 ÷Për vetëqeverisjen vendore; ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ÷Për financat e vetëqeverisjes vendore; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë si dhe ligjet e udhëzimet vjetore të Ministrisë së Financave për buxhetin; ligji nr. 147/2015 ÷Për buxhetin e vitit 2016; ligji nr. 130/2016, datë 17.12.2016 ÷Për buxhetin e shtetit të vitit 2017; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare ÷ i ndryshuar; UMF nr.8, datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publik ÷ i ndryshuar; ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ÷ i ndryshuar; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Menaxhimi i aktiveve në njësitë e sektorit publik, ÷ i ndryshuar; etj.

-Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.

Standardet e auditimit. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC.

Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Adituesve;

Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë", etj.

Manualet e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së etj.

Gjatë zhvillimit të auditimit nga grupi u patën parasysh dhe u zbatuan:

-Qasjen e auditimit mbi bazë risku (rreziku), sipas së cilës të gjithë përpjekjet dhe burimet drejtohen në fushat dhe çështjet më të rëndësishme dhe ku vlerësimi i riskut është në nivelet më të larta;

-Përdorimin e gjykimit profesional duke u bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, manualin e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë.

Gjithashtu auditimi është kryer në zbatim të:

Ligjit organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;

Rregullores së Brendshme ÷Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015;

-Rregullores ÷Mbi Procedurat e auditimit në KLSH, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së.

Metodat e auditimit (Procedurat e auditimit). Përcaktimi i procedurave të auditimit nga grupi i auditimit u bë duke pasur parasysh parimet themelore të auditimit si më poshtë:

Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Audituesit përzgjedhin ato procedura auditimi të cilat sipas gjykimit të tyre profesional janë më të përshtatshme në varësi të rrethanave (ISSAI 300, 3.4.5)

Për arsye se në bazë të vlerësimi paraprak sistemi i kontrollit të brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur, grupi i auditimit u mbështetet më shumë në procedurat thelbësore dhe

më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e kontrollit të brendshëm. Siguria e auditimit është marrë më shumë nga procedurat thelbësore, të cilat kanë qenë si vijon:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 òMbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna õjashtë normalesò, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit (akt-konstatimet, akt-verifikimet dhe letrat e punës), i cili është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur konkluzionet e auditimit. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit.

Nga subjekti i audituar kanë ardhur kundërshti lidhur me çështjet e auditimit të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit

Dokumentimi i auditimit. Është bërë mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI 1230 òDokumentimi i Auditimitò. Nga grupi i auditimit është përgatitur dokumentacioni i duhur mbi bazën e të cilit mbështeten konkluzionet e auditimit. Për këtë janë përgatitur aktet e konstatimit, projektraporti i auditimit dhe ky raport përfundimtar i auditimit. Puna e dokumentuar në këto dokumente është mbështetur mbi bazën e evidencave konkrete, të mara nga subjekti i audituar, të cilat kanë plotësuar tre cilësitë e duhura: kanë qenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme. Procedurat e ndjekura të auditimit janë përshkruar nga secili auditues në aktet e konstatimit, gjatë trajtimit të çështjes sipas ndarjes së detyrave, ku janë evidentuar edhe evidencat të cilave ju jemi referuar. Një pjesë e evidencave të cilat duhet të mbështesin konkluzionet kryesore të auditimit janë pjesë e dosjes së auditimit. Gjatë fazës së auditimit në terren grupi i auditimit ka dokumentuar në informacionet periodike gjetjet kryesore të auditimit. Për çështjet e kundërshtuara nga subjekti prej tij janë bërë kundërshti të

cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit. Gjithashtu është kryer takimi ballafaques me subjektin pranë zyrave të KLSH.

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Dibër, është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 për Vetëqeverisjen Vendore dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 për financat e vetëqeverisjes Vendore, Rregullore mbi Organizimin e Funksionimin e Bashkisë Dibër etj, akt ligjor/nënligjor të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Dibër.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Bashkia Dibër, bën pjesë në Qarkun e Dibrës.

Zona Gjeografike: Dibra kufizohet në veri me Bashkinë e Kukësit, në veri-perëndim me bashkinë Mirditë, në perëndim me bashkinë Mat, në jug-perëndim me bashkinë Klos, në jug me bashkinë Bulqizë dhe në lindje me Republikën e Maqedonisë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Peshkopisë.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re ka një popullsi prej 61,619 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 78,940 banorë. Me një sipërfaqe prej 937.88 km², bashkia e re ka densitet popullsie prej 84.16 banorësh/km² sipas Regjistrimit Civil dhe 65.70 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Kjo bashki përbëhet nga 15 njësi administrative, të cilat janë: Peshkopi, Tomin, Melan, Kastriot, Lurë, Maqellarë, Muhurr, Luzni, Selishtë, Sllovë, Kala e Dodës, Zall-Dardhë, Zall-Reç, Fushë Çidhën dhe Arras. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Dibrës dhe qarkut të Dibrës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 141 fshatra.

Profili i bashkisë: Relievi i bashkisë është përgjithësisht kodrinor dhe malor, por nuk mungon edhe ai fushor në të dyja anët e rrjedhjes së lumit të Drinit të Zi, që favorizon kështu zhvillimin e bujqësisë dhe pemëtarisë. Përgjatë 25 viteve të fundit Dibra ka pasur një migrim të brendshëm drejt Tiranës dhe Durrësit si dhe emigrim të konsiderueshëm jashtë vendit.

Bashkia e Dibrës është një nga bashkitë me territorin më të madh në rang vendi si dhe me një numër të konsiderueshëm fshatrash të shtrira në një zonë të thellë. Zona e Dibrës është njëkohësisht edhe krahina e fundit e madhe e Shqipërisë, e cila vijon të përdorë në shkallë të gjerë infrastrukturën rrugore të trashëguar nga koha e komunizmit, pa shumë përmirësime.

Projekti i Rrugës së Arbërit i cili diskutohet prej shumë vitesh është aktualisht plani i vetëm që mund të çlirojë nga izolimi bashkinë e re.

Zona e Dibrës ka përfituar gjatë viteve të fundit nga ndërtimi i rrugës nga Peshkopia deri në Kukës, gjë që ka nxjerrë nga izolimi pjesën veriore të krahinës.

Zona e Dibrës u penalizua nga ndarja e qytetit të Dibrës nga kjo krahinë, pas vendosjes së kufirit në vitin 1913 ndërsa ndërtimi i qytetit të Peshkopisë nuk arriti të kompensojë këtë humbje. Forcimi i marrëdhënieve ndërkufitare mund të ndihmojë në rikrijimin e balancave fshat-qytet.

Bashkia e Dibrës është aktualisht një nga zonat më të varfëra të Shqipërisë, ku për një pjesë të madhe të popullsisë ndihma ekonomike e shpërndarë nga qeveria është burimi i vetëm i të ardhurave. Bashkia e re do të ketë brenda territorit të saj rezervatet natyrore të Lurës, Luzni Bulacit si dhe pikën turistike të malit të Korabit. Por rezervati natyror i Lurës është shfarosur nga prerjet e paligjshme të pyjeve dhe aktualisht është e diskutueshme nëse kjo zonë duhet të vijohet të mbahet në listën e zonave të mbrojtura.

Sfidat me të cilat do të përballet pushteti vendor pas ndarjes së re.

Lidhja me infrastrukturë rrugore si dhe mirëmbajtja e kësaj infrastrukture në territorin e bashkisë së re pritet të jetë sfida më e madhe për shkak të numrit shumë të lartë të fshatrave, (141) si dhe shtrirjes shumë të gjerë gjeografike. Duke marrë parasysh se kjo bashki shtrihet në një territor shumë të varfër me bazë të paktë të ardhurash nga taksat, sfida e infrastrukturës bëhet edhe më e madhe. Ndër sfidat me të cilat do të përballet bashkia e re, që do të ndikojnë edhe në zbutjen e shifrave të punësimit veçojmë asfaltimin e rrugëve rurale që lidhin komunitet me qendrën e bashkisë, menaxhimin e mbetjeve urbane, sistemimin e kanaleve të ujërave të zeza, si dhe sistemin e furnizimit me ujë të fshatrave, ku mjaft prej tyre vuajnë ndër vite mungesën e ujit të pijshëm.

Bujqësia si e vetmja mundësi punësimi që gjeneron të ardhura është lënë totalisht në harresë, fshatra të shumta me toka mjaft prodhuese dhe me sipërfaqe të mëdha u mungojnë kanalet vaditëse. Kujtojmë me këtë rast Fushën e Maqellarës, që vuan mungesën totale të ujit vaditës. Ndërkohë një tjetër problem për fermerët mbetet edhe ai i mbështetjes së tyre me investime për zhvillimin e frutikulturës, ku Dibra është e përmendur me mollën, kumbullën, dardhën etj, duke vënë kështu në funksion edhe zhvillimin e industrisë agro-ushqimore.

Dibrës i ka munguar prej dekadash edhe nxitja apo promovimi i turizmit malor në Lurë dhe Korab, të cilat mbartin resurse turistike të veçanta dhe mund të konsiderohen burime të rëndësishme për rritjen ekonomike në të ardhmen.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve tëauditimit

A.1.Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm

U auditua funksionimi i pesë elementëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informimi dhe komunikimi, monitorimi. Në përfundim të auditimit arrihet në konkluzionin se nuk është hartuar një paketë e plotë rregullash të shkruara për të siguruar një funksionim të mirë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit, si elementi bazë dhe kryesor i kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e duhur, punonjësit kanë mangësi në njohjen e kërkesave të ligjit 10296, datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk janë hartuar programe për të siguruar ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk janë hartuar

dokumente si regjistri i rriskut, gjurma e auditimit, rregulla për ruajtjen e aktiveve, nuk ka sistem rezervë për ruajtjen e të dhënave elektronike (back-up) për njësinë etj.

Titulli Gjetjes:	i Mbi auditimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në Bashkisë Dibër
Situata:	<p><u>-Mjedisi i kontrollit</u> - Nuk është evidentuar puna e anëtarëve GMS, duke u dokumentuar takimet dhe mbledhjet për hartimin e planit strategjik. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit, për të ngritur në vazhdimësi nivelin e tyre profesional. Politika dhe praktika e burimeve njerëzore nuk garanton ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit, , Për periudhën 01.01.2018-30.06.2020, kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 150 punonjës (me detyra të ndryshme si, drejtor kabinetit, drejtor i qendrës kulturore, përgjegjës i njësisë së prokurimit, specialiste financash, etj), të cilët përpara largimit nga puna nuk kanë bërë dorëzimin e detyrës me procesverbal (dorëzimin e dosjeve shkresore, elektronike, pra të gjithë punës së krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion). Nuk janë hartuar rregulla të shkruara për veprimet që duhet të kryhen nga punonjësi gjatë marrjes dhe dorëzimit të detyrës, si dhe veprimet që kryejnë strukturat e tjera të institucionit në këtë proces (Njësia e burimeve njerëzore, Financa etj.). Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen e aktiveve, bazën e të dhënave, transmetimin e të dhënave lidhur me punën nga një punonjës te tjetri, duke krijuar vështirësi për punonjësit e rinj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 13, VKM nr. 124, datë 17.2.2016 òPër pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil, pikat 27 deri 30, Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 òKodi Punës i Republikës së Shqipërisëò i ndryshuar, neni 25 òDetyrimi i dhënies llogari dhe i kthimitò.</p> <p><u>-Menaxhimi i riskut</u>. Nga titullari në cilësinë e kordinatorit të riskut dhe menaxherët e tjerë, nuk është hartuar regjistri i riskut, si dhe nuk është bërë identifikimi, vlerësimi dhe kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë. Mungon dokumenti i gjurmës së auditimit dhe listës së proceseve të punës për veprimtaritë kryesore të njësisë publike.</p> <p>Nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 22, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010. Veprimtaria e GMS, nuk ka qenë në përputhje me kërkesat ligjore, për arsye se:GMS, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 32.</p> <p><u>-Veprimtaritë e kontrollit</u>. Nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit, mungojnë rregulla të shkruara për ruajtjen e aktiveve, si dhe sistemi rezervë (back-up) për ruajtjen e të dhënave. Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT.</p> <p>Nuk ka procedura të veçanta të shkruara, mbi sistemet IT, të cilat të përdoren në Bashkinë Dibër, dhe ti jenë bërë me dije stafit. Aktualisht nuk ka një manual të shkruar për sigurinë e IT.</p> <p><u>-Informacioni dhe komunikimi</u>. Realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të nenit 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, por nuk janë përcaktuar me shkrim llojet e raporteve, frekuenca e raportimit me shkrim te</p>

	<p>titullari nga secila drejtori/sector, etj.</p> <p><u>Monitorimi</u> sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, realizohet në mënyrë formale, duke respektuar ato kritere mbi të cilat edhe raportohet pranë Ministrisë së Financave. Nuk janë përcaktuar rregulla të qarta lidhur me ndjekjen e zbatimit të kontratave të lidhura pas kryerjes së procedurave të prokurimit. Për projektet në bujqësi, arsim, urbanistikë, infrastrukturë etj., në Rregulloren e funksionimit të brendshëm nuk janë përcaktuar detyra se kush duhet të ndjekë zbatimin e kontratave lidhur me afatet dhe cilësinë e punimeve.</p> <p>Këto raste janë shkelje e kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë i ndryshuar, Kap. III, pikat 42, 47.</p> <p>Për sa më sipër mban përgjegjësi ish titullari i AK z. M. R., Titullari aktual z. D. I. dhe Nëpunësi zbatues z. L. Ç..</p>
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 ëPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, nenet 8, 16, 22, 23, 24.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e Kodit Etik, për periudhën 01.01.2018 deri më 15.07.2020, mos identifikimi dhe menaxhimi i risqeve, mungesa e analizimit të cilësisë së funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, mos trajnimi për rritjen profesionale të stafit, ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të institucionit, lënë hapësira për ndodhjen e anomalive dhe mos informimin e titullarit për këto anomali, nuk nxjerrin qartë përgjegjësitë, etj.
Shkaku:	Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 ëPër menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave. Mosnjohje nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, me nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtori i Drejtorisë Ekonomike të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 ëPër menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kërkesat e Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj. Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.3086, datë 11.09.2020, ëMbi Projektraportin e Auditimit nga Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse të Bashkisë Dibër, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: paraqitur me shkresën nr.3086 prot., datë 11.09.2020, protokolluar në KLSH me nr.466/5, datë 18.09.2020, mbi Projekt Raportin e Auditimit nr.466/4 prot., datë 19.08.2020, nga Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse të Bashkisë Dibër:

Përsa i përket gjetjes me nr. 9 citohet se: Për periudhën 01.01.2018-30.06.2020 kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 150 punonjës, të cilët përpara largimit nga puna nuk kanë bërë dorëzimin e detyrës me procesverbal. Nuk janë hartuar rregulla të shkruara për veprimet që duhet të kryhen nga punonjësi gjatë marrjes dhe dorëzimit të detyrës si dhe veprimet që

kryejnë strukturat e tjera të institucionit në këtë proces. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr.30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika 13, Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë dhe i ndryshuar nëni 25, VKM nr.124, datë 17.02.2016 për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil, pika 27 dhe 30.

Në zbatim të dispozitave ligjore të cituara më sipër, rregulloren e miratuar për vitin 2020 nga Kryetari i Bashkisë nëni 14 për Dokumentacionin dhe pajisjet, si dhe në vendimet e liritimit dhe emërimit të titullarit të Bashkisë Dibrë përcaktohen qartë se dorëzimi ose marrja e detyrës bëhet brenda afateve të përcaktuara në vendimin e titullarit të bashkisë, me procesverbal të rregullt dhe inventarin e zyrës së materialeve që disponon sektori. Bashkëngjitur do gjeni nëni 14 të rregullores së Bashkisë Dibrë për vitin 2020.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Afati i auditimit në Bashkinë Dibrë përfshinte periudhën nga 01.01.2018-31.12.2020. Duke qenë se rregullorja e re është miratuar në vitin 2020, jo në të gjitha rastet e mësipërme është bërë dorëzimi i detyrës me procesverbal nga punonjësit dhe shembull konkret për këtë është largimi nga puna i përgjegjësit të prokurimeve z. F. K., i cili është larguar pa e lënë me procesverbal punën të pasardhësi i tij z. I. S.. Përsa më sipër, komenti juaj nuk merret parasysh.

A/2. Mbi vlerësimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm Publik

Në Bashkinë Dibrë, është organizuar dhe funksionon struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) si veprimtari vlerësuese dhe që jep siguri mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Kjo njësi, është e përbërë nga dy specialistë si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit. Përgjegjësi i Sektorit, është i pajisur me Certifikatën e Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik ndërsa 2 specialistet e tjerë nuk janë të pajisur me certifikatën e auditit të brendshëm, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik nëni 11 dhe me VKM nr.83, datë 03.02.2016 për Miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik pika 3.

Nga njësia e auditimit të brendshëm janë hartuar dhe miratuar për çdo vit në zbatim të ligjit për auditimin e brendshëm planet strategjike dhe vjetore sipas formateve të miratuara.

Për vitin 2018 janë planifikuar 6 auditime dhe janë realizuar 6 auditime (janë konstatuar 51 gjetje dhe janë lënë 51 rekomandime), të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme :

Nr.	Objektet	Niveli i vlerësimit të riskut	Llojet e auditimeve	Objekte të pa audituara mbi 2 vjet
1	Klubi i futbollit Korabi Peshkopi	I mesëm	Financiar/Përputhshmëri	jo
2	Klubi shumësportësh Korabi, Peshkopi	I mesëm	Financiar/Përputhshmëri	jo
3	Zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së	I mesëm	Financiar/Përputhshmëri	jo
4	Njësia Administrative Arras	I mesëm	Financiar/Përputhshmëri	jo
5	Njësia Administrative Melan	I mesëm	Financiar/Përputhshmëri	jo
6	Spektori i menaxhimit të konvikteve/çerdheve	I mesëm	Financiar	jo

Për vitin 2019 janë planifikuar 5 auditime dhe janë realizuar 4 auditime (janë konstatuar 14 gjetje dhe janë lënë 14 rekomandime) të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Objektet	Niveli i vlerësimit të riskut	Llojet e auditimeve	Objekte të pa audituara mbi 2 vjet
1	Drejtoria e Qendrës Kulturore, Peshkopi	I mesëm	Të përputhshmërisë	jo
2	Detyrimet e prapambetura, Drejtoria e Financës	I Lartë	Financiar/Përputhshmëri	jo
3	Kontrolli dhe inventarizimi i magazinave në Bashkinë Dibrë	I mesëm	Të përputhshmërisë	jo
4	Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH	I mesëm	Të përputhshmërisë	jo

Për vitin 2020 janë planifikuar 5 auditime dhe deri në 30 qershor janë realizuar 3 auditime (janë konstatuar 14 gjetje dhe janë lënë 14 rekomandime) të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Objektet	Niveli i vlerësimit të riskut	Llojet e auditimeve	Objekte të pa audituara mbi 2 vjet
1	Klubi i futbollit Korabi Peshkopi	I mesëm	Financiar/Përputhshmëri	jo
2	Klubi shumësportësh Korabi, Peshkopi	I mesëm	Financiar/Përputhshmëri	jo
3	Ujësjiellës Kanalizime Dibër	I Lartë	Financiar/Përputhshmëri	jo

Për vitin 2018 nga 6 auditime të planifikuara janë realizuar 6 auditime, nga ku janë konstatuar 51 gjetje dhe janë lënë 51 rekomandime me karakter organizativ.

Për vitin 2019 nga 5 auditime të planifikuara janë realizuar 4 auditime, nga ku janë konstatuar 14 gjetje dhe janë lënë 14 rekomandime me karakter organizativ.

Për vitin 2020 nga 5 auditime të planifikuara janë realizuar 3 auditime deri në datën 30.06.2020, nga ku janë konstatuar 14 gjetje dhe janë lënë 14 rekomandime me karakter organizativ.

Titulli i Gjetjes:	Mbi veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm
Situata:	<p>Është miratuar nga Titullari i Bashkisë, Plani Strategjik i subjekteve për t'u audituar për periudhën 2018, 2019 dhe 2020. Auditimet e kryera, janë evaduar me urdhër të Titullarit të Bashkisë ku janë marrë vendimet përkatëse për shkeljet e konstatuara.</p> <p>Pavarësisht sa sipër u konstatuan se nuk është bërë kontrolli i cilësisë së auditimit të kryer, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, të miratuar me Urdhër të Ministrave të Financave, nr. 100, datë 25.10.2016, Kap. II, pika 10.</p> <p>Nga ana e NJAB, Bashkia Dibër, për periudhën 01.01.2018-30.06.2020, nuk është kryer verifikimi i zbatimit të rekomandimeve me program tematik të veçantë, por është bërë verifikimi i rekomandimeve në auditimin e rradhës, në kundërshtim me Manualin e auditimit të brendshëm, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, nr.100, datë 25.10.2016. Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, pikën 4.1.13.2, 'Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve', ku përcaktohet se: <i>“Kur nuk është planifikuar angazhim auditimi në vitin në vazhdim, audituesit duhet t'i mundësojnë një raport të shkurtër titullarit të njesisë, për progresin e bërë në zbatimin e rekomandimeve të rëna dakord më parë. Në këto raste rishikimi i zbatimit të rekomandimeve mund të realizohet në auditimin e rradhës në subjektin publik si pikë e veçantë e programit të auditimit”</i>.</p> <p>NJAB nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, taksat dhe tarifatat vendore, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave, pasi nuk janë kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, në kundërshtim me kërkesat e pikës 3, të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar, neni nr. 5 E 6 të ligjit nr. 114/2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik.</p> <p>Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. S. S., me detyrë Përgjegjës i</p>

	Njesisë së Auditit të Brendshëm.
Kriteri:	Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 òPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 òPër miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò. Urdhri i Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 òPër Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò.
Ndikimi/Efekti:	Moskryerja e auditimeve në fushat me risk që ka veprimtaria e njësive vendore, sjell mosnjohjen nga auditi dhe titullari të rreziqeve të mundshme që ka në këto fusha, e për pasojë, duke mos i njohur, nuk ka as vëmendje për t'i minimizuar këto risqe e për ti monitoruar. Si përfundim titullarit nuk i jepet këshillimi i duhur nga ana e auditit të brendshëm, e cila është detyra themelore e këtij të fundit.
Shkaku:	Mungesa e kontrollit të cilësisë së auditimeve të kryera dhe moskryerja e auditimeve në fushat me risk.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Nga NJAB të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësive publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.3086, datë 11.09.2020, òMbi Projektraportin e Auditimitò nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të Bashkisë Dibër, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Përsa i përket shkronjës A/2, òMbi vlerësimin e auditimit të brendshëm publikò citohet se: Në Bashkinë Dibër është organizuar dhe funksionon struktura e Njësive të Auditimit të Brendshëm. Kjo njësi është e përbërë nga 2 specialistë si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit. Përgjegjësi është i pajisur me çertifikatën e Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik ndërsa 2 specialistët e tjerë nuk janë pajisur me çertifikatën e auditit të brendshëm, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.114/2015 òPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò dhe VKM nr.83 datë 03.02.2016 për òMiratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publikò pika 3.

Në zbatim të kërkesave të ligjit dhe VKM të sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm është e përbërë nga 3 specialistë ku përkatësisht drejtuesi i njësive është i pajisur me çertifikatë audituesi, njëri nga specialistët është emëruar në janar të 2020 në Njësine të Auditimit dhe brenda afatit 2 vjeçar do t'ia nënshtrohet detyrimisht procedurës së çertifikimit si òAuditues i brendshëmò, ndërsa specialisti tjetër edhe pse nuk është i çertifikuar mund të jetë pjesë e Njësive në përputhje me pikën 3 të VKM nr.83, datë 03.02.2016.

Qëndrimi i grupit të auditimit:Afati i auditimit në Bashkinë Dibër përfshinte periudhën nga 01.01.2018-30.06.2020. Duke qenë se Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë kësaj periudhe ka funksionuar me 1 Përgjegjës Sektori të çertifikuar dhe 2 specialistë që nuk janë të pajisur me çertifikatën e auditit të brendshëm, dhe duke qenë se nuk keni shtuar elementë të rinj, pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.

B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit

Për periudhën e auditimit buxheti vjetor fillestar, si dhe ndryshimet gjatë vitit janë miratuar me vendimet përkatëse të këshillit bashkiak (të dhënat sipas aneksit nr.1, nr.1/2 dhe nr.1/3 në fund të raportit përfundimtar të auditimit).

U audituan të gjitha investimet sipas regjistrit të prokurimeve me vlera të larta, lidhur me faktin e miratimit të tyre në këshillin bashkiak (KB). Nuk rezultuan angazhime buxhetore të pa miratuara, pra të gjitha investimet kanë marrë miratim në KB.

Buxheti përfundimtar për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 1,659,732,746 lekë dhe realizuar vlerën 1,557,903,982 lekë, ose në masën 94%. Vlerën më të ulët të realizimit e ka zëri shpenzime operative në masën 84%. Investimet janë realizuar në vlerën 258,943,967 lekë, ose në masën 92%.

Buxheti përfundimtar për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 1,641,393,958 lekë dhe realizuar vlerën 1,547,431,904 lekë, ose në masën 94%.

Vlerën më të ulët të realizimit e ka zëri shpenzime operative në vlerën 136,049,970 lekë, ose në masën 75%. Investimet janë realizuar në vlerën 151,189,047 lekë, ose në masën 97%, por krahasuar më vitin 2018 kanë vlerë më të ulët në shifra.

Për periudhën janar-qershor 2020, planifikimi buxhetit ka vlerën 985,448,850 lekë ndërsa realizimi ka vlerën 811,106,111 lekë, ose në masën 82%.

Struktura e shpenzimeve faktike për secilin vit buxhetor, sipas vlerave të aktit të rakordimit me thesarin për shpenzimet paraqitet në aneksin nr. 1/4 në fund të raportit përfundimtar të auditimit.

Titulli i Gjetjes *Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara*

Situata: **Detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2018**

Bazuar në aktin e rakordimit me degën e thesarit Dibër, më datën 31.12.2018, e detyrimet e prapambetura kanë vlerën 311,619,238 lekë, e cila sipas natyrës së detyrimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi i natyrës së detyrimit	Vlera e detyrimit më 31.12.2018
1	Detyrim për investimet	146,210,483
2	Detyrim për vendimet gjyqësore	107,879,580
3	Detyrim për mallra dhe shërbime	57,529,175
	Total	311,619,238

Lista analitike e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2018, jepen në aneksin nr.1/7 (tabela a, b dhe c), bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

Duke analizuar vlerën e detyrimeve të prapambetura të trashëguara nga viti 2017, ato të krijuara në vitin 2018, si dhe duke marrë në konsideratë që në krijimin e këtyre detyrimeve ka pasur efekt edhe kufizimi i limitit të arkës në fund të vitit (i cili shprehet me vlerën e fondeve të disponueshme në llogarinë 520) kemi panoramën në vijim:

Subjekt i	Viti 2018				Fondet e trashëguara në 31.12.2018 (Llog. 520 në bilanc)	Diferenca fonde të trashëguara (Llog. 520 në bilanc) me vlerën e detyrimit në fund të vitit
	Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2017	Shtesa te detyrimit gjatë vitit 2018	Shlyerjet gjatë periudhës 2018	Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2018		
Bashkia Dibër	224,797,270	235,780,596	148,958,628	311,619,238	39,655,705	271,963,533

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet:

Fondet e trashëguara për vitin 2018 kanë një vlerë më të vogël se detyrimet në fund të

vitet 2018, gjë që tregon se edhe po të përdreshin këto fonde brenda vitit buxhetor, përsëri ka detyrime të prapambetura të konsiderueshme.

Pra, angazhimet buxhetore të cilat janë të pa mbuluara me fonde më 31.12.2018 edhe nëse do të ishin përdorur fondet e trashëguara prej 39,655,705 lekë, janë 271,963,533 lekë.

Detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2019

Bazuar në aktin e rakordimit me degën e thesarit Dibër, vlera e detyrimeve të prapambetura për Bashkinë Dibër në datën 31.12.2019 ka vlerën 288,500,252 lekë, sipas tabelës në vijim, të ndarë sipas natyrës së detyrimit:

Nr	Emërtimi i natyrës së detyrimit	Vlera e detyrimit më 31.12.2019
1	Detyrim për investimet	125,048,518
2	Detyrim për vendimet gjyqësore	124,458,767
3	Detyrim për mallra dhe shërbime	36,497,523
4	Detyrime të prapambetura për sigurimet shoqërore, ish komunat	2,242,820
5	Detyrime të prapambetura për sigurimet shëndetsore, ish komunat	252,644
	Total	288,500,272

Burimi: Drejtoria ekonomike, Bashkia Dibër

Peshën specifike më të madhe në këto detyrime e zënë detyrimet për investime në masën 43% dhe detyrimet për zbatimin e vendimeve gjyqësore në masën 41% të vlerës totale.

Detyrimi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 2,495,464 lekë është krijuar në zbatim të akt-rakordimit nr.3444 prot., datë 02.10.2019, të hartuar midis Bashkisë Dibër dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, si dhe të shkresave nr.15964 dhe 15965 datë 06.09.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila ka të bëjë me detyrimet e prapambetura për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Drejtorinë Rajonale Tatimore Dibër për ish komunën Kala e Dodës, ish komuna Lurë dhe ish bashkia Peshkopi.

Duke analizuar vlerën e detyrimeve të prapambetura të trashëguara nga viti 2018, ato të krijuara në vitin 2019, si dhe duke marrë në konsideratë që në krijimin e këtyre detyrimeve ka pasur efekt edhe kufizimi i limitit të arkës në fund të vitit (i cili shprehet me vlerën e fondeve të disponueshme në llogarinë 520) kemi panoramën në vijim për vitin 2019:

Viti 2019						
Subjekti	Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2018	Shtesa te detyrimit gjatë vitit 2019	Shlyerjet gjatë periudhës 2019	Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2019	Fondet e trashëguara në 31.12.2019 (Llog. 520 në bilanc)	Diferenca fonde të trashëguara (Llog. 520 në bilanc) me vlerën e detyrimit në fund të vitit
Bashkia Dibër	311,619,238	152,333,897	175,452,883	288,500,252	64,780,168	223,720,084

Burimi: Drejtoria ekonomike, Bashkia Dibër

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet:

Fondet e trashëguara për vitin 2019 kanë një vlerë më të vogël se detyrimet në fund të vitit 2019, gjë që tregon se edhe po të përdreshin këto fonde brenda vitit buxhetor, përsëri ka detyrime të prapambetura të konsiderueshme.

Në datën 31.12.2019 bashkia ka pasur një detyrim të prapambetur në vlerën 288,500,252 lekë, si dhe një vlerë të fondeve të pa përdorura për shkak të kufizimit të

limitit të arkës në fundin e vitit, të cilat janë trashëguar për vitin tjetër buxhetor, në vlerën 64,780,168 lekë.

Pra, për vitin 2019, angazhimet buxhetore të cilat janë të pa mbuluara me fonde edhe nëse do të ishin përdorur fondet e trashëguara, janë 223,720,084 lekë(288,500,252 - 64,780,168).

Lista analitike e detyrimeve të prapambetura për vitin 2019 paraqitet në aneksin nr.1/9(tabela a, b), bashkëngjitur raportit të auditimit.

Bazuar në ligjin nr. 68, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", kreun XI-Vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 dhe 56, si dhe në udhëzimin e MF nr. 26, datë 27.09.2019, "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore", konstatohet se njësia vendore Bashkia Dibër ndodhet në vështirësi financiare, pasi vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta është 38% e shpenzimeve vjetore.

Për përcaktimin e vështirësisë financiare në vlerën e rakordimit me thesarin të shpenzimeve vjetore 1,550,598,537 lekë, nuk janë përfshirë:

a- llogaria 466- Mjete nën ruajtje, sepse kjo vlerë nuk përfaqëson shpenzim, por vlerën e ngurtësuar të garancisë së fondeve për kontratat e lidhura;

b- vlera e taksës së pullës, pasi nuk është shpenzim për njësinë vendore, por një vlerë e cila përfaqëson shitjet e pullave të gjendjes civile e cila derdhet në tatime;

c- ndihma ekonomike dhe pagesën e paafësisë, pasi edhe kjo vlerë nuk është shpenzim i njësisë vendore, kjo e fundit harton listat dhe administron fondet e ministrisë përkatëse, por nuk ka obligimin për sigurimin e fondeve (janë fonde të deleguara).

Në formë tabele raporti në % detyrime/shpenzimet faktike, e cila përcakton edhe shkallën e vështirësisë financiare për njësinë vendore shprehet në tabelën e mëposhtme:

Viti 2019						
Shpenzimet sipas thesarit (FSG)	Llogaria 466	Taksa e pulles	Ndihma ekonomike dhe PAK	Shpenzimet totale pa llogarinë 466, taksën e pulles dhe ndihmën ekonomike (e=a-b-c-d)	Detyrimet e prapambetura me 31.12.2019	Raporti në % detyrime/shpenzimet faktike (f/g)
a	b	c	d	e	f	g
1,550,598,537	21,441,043	3,166,454	775,179,481	750,811,559	288,500,252	38

Detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2020.

Bazuar në aktrakordin me degën e thesarit Dibër, vlera e detyrimeve të prapambetura për Bashkinë Dibër në datën 31.12.2020 ka vlerën 218,856,175 lekë, sipas tabelës në vijim:

Viti 2019						
Subjekti	Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2019	Shtesa /Pakësime te detyrimit gjatë vitit 2020	Shlyerjet gjatë periudhës 2020	Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2020	Fondet e trashëguara në 31.12.2020 (Llog. 520 në bilanc)	Diferenca fonde të trashëguara (Llog.520) me vlerën e detyrimit në fund viti
BashkiaDibër	288,500,272	167,870,100	237,514,197	218,856,175	87,736,563	131,119,612

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Dibër

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se:

-Fondet e trashëguara për vitin 2020, kanë vlerë më të vogël se detyrimet në fund të vitit 2019, gjë që tregon se edhe po të përdreshin këto fonde brenda vitit buxhetor, përsëri

detyrimet e prapambetura janë të konsiderueshme. Në datë 31.12.2020 bashkia Dibër ka pasur një detyrim të prapambetur në vlerën 218,856,175 lekë, si dhe vlerë të fondeve të pa përdorura për shkak të kufizimit të limitit të arkës në fund të vitit të trashëguara për vitin tjetër buxhetor janë në vlerë 87,736,563 lekë. ***Pra angazhimet buxhetore të cilat janë të pa mbuluara me fonde edhe nëse do të ishin përdorur fondet e trashëguara 131,119,612 lekë.***

Vlera e detyrimeve të prapambetura 218,856,175 lekë e cila sipas natyrës së detyrimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

N r.	Emërtimi i natyrës së detyrimit	Vlera e detyrimit më 31.12.2020
1	Detyrim për investimet	77,599,018
2	Detyrim për vendimet gjyqësore	108,056,591
3	Detyrim për mallra dhe shërbime	32,334,031
4	Detyrime të prapambetura për sigurimet shoqërore, ish komunitat	613,891
5	Detyrime të prapambetura për sigurimet shëndetsore, ish komunitat	252,644
Total		218,856,175

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Dibër

Në bazë të aktrakordimit nr.3444 prot, datë 02.10.2019 midis bashkisë Dibër dhe DRT Dibër, si dhe shkresat nr.15964; nr.15965, datë 06.09.2019 të MFE rezulton se, detyrimet e prapambetura për kontributet sigurime shoqërore e shëndetësore janë krijuar në DRT Dibër për kontributet e ish/komuna Kala e Dodës, ish/komuna Lurë dhe ish/bashkia Peshkopi.

Kriteri:

Shuma e shpenzimeve të përlllogaritura vjetore pa ndihmen ekonomike kanë vlerën 866,960,810 lekë; Detyrimet e prapambetura me 30.06.2020 kanë vlerën 218,856,175lekë; Raporti $242,138,293/866,960,810 \cdot 100 = 27.8\%$ Të dhëna për llogaritjen e shkallës së vështirësisë financiarë të Bashkisë Dibër jepen në aneksin 1/13/d/e, bashkangjitur raportit përfundimtar të auditimit.

Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion në llogarinë e thesarit dhe krijimi i detyrimeve të prapambetura në vlerat e mësipërme, është në kundërshtim me nenin 50 - Angazhimet buxhetore, nenin 52 -Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 öPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 öPër shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018, öPër buxhetin e vitit 2018, pikat 82-91 ö Detyrimet e prapambetura të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore, VKM 914 öPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 70.

Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 öPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë nenet 2, 3, 6, 9, 10,15,15, 27, 32, 52.

Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa öcö dhe öçö.

Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3, neni 55, 56.

Udhëzimin e Ministrisë së Financës nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Ndikimi/Efekt : Mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Shkaku: Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion

Rëndësia: E lartë

Rekomandim Njësia vendore të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura dhe të marrë masa për likuidimin e tyre.

Për këtë qëllim, Kryetari i njësisë vendore, të përgatis një plan për daljen nga situata e vështirë financiare dhe tëa dërgoj këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ky i fundit, duhet ta shqyrtoj dhe miratoj brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së tij. Një kopje e planit të miratuar nga këshilli ti dërgohet zyrtarisht Ministrisë së Financave, e cila mund të japë rekomandime konkrete për rregullimin e situatës së vështirësisë financiare. Të mos merret asnjë angazhim buxhetor pa pasur fonde në dispozicion.

Pagesat e kryera për zbatimin e vendimeve gjyqësore

Titulli i Gjetjes *Efektet negative në buxhet si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore*

Situata: Për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim për largime nga puna të punonjësve, për periudhën janar 2018-qershor 2020, Bashkia Dibër ka shpenzuar vlerën 12,915,472 lekë e cila konsiderohet **efekt financiar negativ** në buxhetin e njësisë vendore (për vitin 2018 është likuiduar vlera 2,298,136 lekë, për vitin 2019 vlera 10,617,336 lekë. Pagesat e kryera për zbatimin e vendimeve gjyqësore për largimet e pa drejta nga puna për periudhën janar 2018-qershor 2020, paraqitet në aneksin nr.1/11, në fund të raportit përfundimtar të auditimit. Gjithashtu për vendimet gjyqësore me objekte të tjera të ndryshme për dëmshpërblim dëmi, Bashkia Dibër për periudhën janar 2018-Dhjetor 2020, ka likuiduar vlerën 54,047,518 lekë (për vitin 2018 vlera 3,300,000 lekë, për vitin 2019 vlera 21,598,029 dhe për periudhën janar-qershor 2020 vlera 29,149,489 lekë. Vlera 54,047,518 lekë konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e njësisë vendore.

Si përfundim, efekti financiar negativ në buxhetin e njësisë vendore, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore, pavarësisht natyrës së tyre, ka vlerën 66,962,990lekë. Konstatohet se përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari i njësisë vendore nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62, të udhëzimit nr. 2, datë 06.02. 2012 òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, ku thuhet:

òTë gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa aktin e titullarit që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi”.

Lista e vendimeve gjyqësore për pagesat e kryera për zbatimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna dhe çështje të tjera gjyqësore për periudhën 2018-2019, paraqitet respektivisht në aneksin nr.1/11 dhe nr. 1/12, bashkëngjitur raportit përfundimtar të auditimit.

Kriteri: Pika nr.62, e udhëzimit nr. 2, datë 06.02. 2012 òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò.

Ndikimi/Efekti: Proceset gjyqësore dhe humbja e çështjes së tyre nga njësia vendore, kanë krijuar efekte negative në buxhet në vlerën 66,962,990 lekë gjithsej.

- Shkaku:** Mos zbatimi i kriterëve ligjorë në procesin e largimeve nga puna të punonjësve në vlerën 12,915,472 lekë.
- Rëndësia:** I lartë
- Rekomandime:** Titullari i njësisë vendore të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore, të nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë për humbjen e tyre dhe efektin negativ që këto vendime kanë dhënë në buxhetin e njësisë vendore. Drejtoria juridike të ndjekë proceset në të gjitha shkallët e gjyqimit, duke bërë edhe rekurs. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga sektori juridik dhe titullari të zbatohen të gjitha procedurat e nevojshme të afateve të njoftimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi. z.M. R. me detyrë ish Kryetar i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues për periudhën janar 2018-korrik 2019, z. D. I. me detyrë Kryetar aktual i Bashkisë Dibër, për periudhën gusht 2019 qershor 2020, z. L. C., me detyrë drejtor ekonomik, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

B.1. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

I. Anomalitë e konstatuara në taksat dhe tarifatat vendore, së bashku me taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Titulli Gjetjes	Mos ndjekje dhe mos arkëtim të detyrimeve për debitorët e bizneseve dhe të familjarëve për taksat dhe tarifatat vendore si dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje ndërtimi.
Situata:	<p>Nga puna e pa mjaftueshme e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër, janë krijuar debitorë, të cilët në datën 31.12.2019 kanë vlerën progresive 47,459,984 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore dhe përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> -270 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 7,427,427 lekë -15,568 familje debitorë për tokën bujqësore në vlerën 6,494,144 lekë -22,153 familje debitorë për tarifatat vendore në vlerën 26,210,566 lekë - vlera 7,327,847 lekë, e cila përbën detyrim për taksën e ndikimit në infrastrukturë: për vitin 2018 në vlerën 5,385,190 lekë për 139 taksapagues, vitin 2019 në vlerën 1,942,657 lekë për 53 taksapagues. <p>Nga vlera e mësipërme prej 47,459,984 lekë, detyrimi që i përket vetëm vitit 2019, (pra që është krijuar gjatë vitit 2019), është 20,015,289 lekë, i cili përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> -106 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël 2,997,045 lekë -7,472 familje debitorë për tokën bujqësore në vlerën 3,141,029 lekë -10,072 familje debitorë për tarifatat vendore në vlerën 11,934,558 lekë - 53 taksapagues për taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 1,942,657 lekë. <p>Vlera e borxhit në 31.12.2018 është në vlerën 25,201,306 lekë nga të cilat</p> <ul style="list-style-type: none"> -75 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 2,186,993 lekë -15,568 familje debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 3,353,115 lekë -12,081 familje debitorë për tarifatat vendore në vlerën 14,276,008 lekë; - detyrim për taksën e ndikimit në infrastrukturë për vitin 2018 në vlerën 5,385,190

	<p>lekë për 139 taksapagues</p> <p>Vlera e borxhit në 31.12.2017 në mënyrë progresive është në vlerën 23,177,839 lekë.</p> <p>Mos arkëtimi i plotë i detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përveçse është mos përmbushje e detyrimeve ligjore, sipas detyrës funksionale të punonjësve të kësaj strukture, krijon mungesa financiare në buxhet dhe për pasojë ulë nivelin e investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njësia vendore ka parashikuar në favor të komunitetit. Mungesa e të ardhurave është ndikim i drejtpërdrejtë në mosrealizimin e buxhetit në zërin e shpenzimeve për periudhën 2018-2019.</p> <p>Nga Bashkia Dibër nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore në rend shterues, për arkëtimin e debitorëve.</p> <p>*Gjatë vitit 2018 nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore me shkresën nr.4425, datë 19.10.2018 u është dërguar njoftim për likuidim të detyrimeve 40 subjekteve debitorë së bashku me kamatëvonesë.</p> <p>*Gjatë vitit 2019 nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore me shkresë nr.4435 e nr.4437, datë 25.09.2019 është dërguar urdhër bllokimi pranë bankave të nivelit të dytë, për 13 subjekte dhe kujtesa për pagesë ju është dërguar 75 subjekteve debitorë.</p> <p><i>Për mos ndjekjen e procedurave ligjore dhe nënligjore për arkëtimin e vlerës debitorëve më datën 31.12.2019 në shumën 47,459,984lekë, ngarkohen me përgjegjësi punonjësit si më poshtë:</i></p> <p>Z.B. M. me detyrë Përgjegjës Sektori nga 15.02.2018 dhe në vazhdim</p> <p>Z R. G. me detyrë Specialist i Rakordimit të Tatim-Taksave dhe Vlerave nga data 05.01.2014 dhe në vazhdim;</p> <p>Z.D. S. me detyrë Specialist i Planifikimit të të Ardhurave data 14.02.2018 dhe në vazhdim;</p> <p>Z I. M. me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore nga 27.06.2016 deri në 14.04.2020;</p> <p>Znj. B. M. me detyrë ish Inspektore e Taksave dhe Tarifave Vendore nga data 22.06.2016 deri në 15.06.2020, ndërprerë marrëdhëniet e punës.</p> <p>Z. D. T. me detyrë ish Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore nga data 03.10.2018 deri në 15.06.2020, aktualisht punonjes arkivi në Njësinë Administrative Maqellarë;</p> <p>Z. M. Z. me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore deri në datën 15.06.2020, aktualisht inspektor i taksave nëNjësinë Administrative Tomin;</p> <p>Z. L. G. me detyrë ish nspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore deri në datën 14.04.2020, aktualisht punonjes i sektorit të transportit dhe ndricimit.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.9482, datë 03.04.2006, ÷Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeë i ndryshuar, neni 23, pika 2 e nenit 27;</p> <p>Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ÷Për sistemin e taksave vendoreë të ndryshuar, VKM nr.860, datë 10.12.2014.</p> <p>Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ÷Për sistemin e taksave vendoreë, neni 4-÷Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisëë pika 2; neni 70, E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor pika 3; Neni 114-÷Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributitë, pika 1;</p> <p>-Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendoreë me ndryshime.</p> <p>-Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ÷Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëë, i ndryshuar, kreu XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të</p>

	<i>papaguara</i> ”.
Impakti:	Menaxhimi i dobët i të ardhurave ndikon në uljen e burimeve të financimit për mbulimin e shpenzimeve.
Shkaku:	Mos respektimi i kuadrit ligjor nga nëpunësi përgjegjës për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Mos respektimi e kuadrit ligjor nga personat përgjegjës.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Bashkia Dibër, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Financës, të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës 47,459,984 lekë përkatësisht: -për taksën e ndikimit në infrastrukturë të marrë masa për arkëtimin e menjëhershëm për vlerën 7,327,847 lekë, e ardhur e munguar e për buxhetin e Bashkisë. -për taksat dhe tarifatat e tjera nga biznesi i vogël dhe biznesi i madh si dhe nga debitorët familjarë, në vlerën 40,132,137 lekë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga Bashkia Dibër është paraqitur observacioni me shkresë nr.3084 prot, datë 11.09.2020 òMbi Projektraportin e Auditimitò nga z B. M., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:Ne si zyrë kemi zbatuar të gjitha procedurat sipas ligjit kemi dërguar shkresa për debitorët. Ju sqarojmë që Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore hapi i parë që kemi marrë ka qenë dërgimi i inspektorëve të terrenit në çdo fshat dhe lagje të qytetit në shtëpitë e tyre për ti vënë në dijeni për likuidimin e detyrimeve sipas faturës përkatëse.

Hapi i dytë nëpërmjet shkresave:

Shkresa Nr 1286 datë 03.04.2018 të gjithë personave debitorë .

Shkresa Nr 4561 datë 26.10.2018 Agjencisë së Kadastrës për mosdhënie të certifikatës së pronësisë pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Shkresa Nr 4437 datë 07.11.2018 të gjithë personave debitorë për likuidimin e detyrimeve .

Shkresa Nr 4219 datë 10.09.2019 Asgjësisë së Kadastrës për personat debitorë bashkëngjitur listën.

Shkresa Nr 4219/1 datë 24.10.2019 Asgjësisë së Kadastrës për vendosjen e barrës së sigurisë hipotekore.

*Për debitorët familjar në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr.01. datë 17.01.2019 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ò kemi njoftuar nëpërmjet postës me shkresë nr.3018 prot, datë 04.09.2020 njoftim vlerësimet e detyrimeve tatimore për familjarët debitor.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se observacioni Juaj nuk merret në konsideratë nga audituesit shtetëror të KLSH ó së, pasi ju nuk keni paraqitur dokumente dhe prova shkresore të reja për arkëtimin e debitorëve të bizneseve dhe të familjarëve.

II. Subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për vitet 2018, 2019 dhe 6 mujori i parë 2020.

Titulli i Gjetjes	Mos marrja e masave për kryerjen e pagesës së rinovimit të licencave për subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë.
Situata:	Sipas dokumentacionit të paraqitur nga Përgjegjësi i Sektorit të Taksave dhe

	<p>Tarifave Vendore, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Dibër dhe në Njësitë Administrative në vartësi Peshkopi, Selishtë, Sllovë, Kala e Dodës, Zall-Dardhë, Zall-Reç, Fushë-Çidhën, Arras, Luzni, Tomin, Melan, Kastriot, Lurë, Maqellarë dhe Muhurr, na u vunë në dispozicion dosje të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, ku u verifikuan për pagesat për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante.</p> <p>Për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 -31.12.2020 Bashkisë Dibër nuk ka përfshirë në paketën fiskale tarifën për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se 16 subjekte, të paraqitura sipas listës në aneksin nr.2/21 bashkëngjitur raportit përfundimtar të auditimit, (ku pasqyrohen detyrimet, arkëtimet dhe vlera e tarifës së pa likuiduar), nuk kanë paguar tarifën e rinovimit të kësaj licence, në vlerën totale prej 13,800,000 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore.</p>
Kriteri:	Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë, i ndryshuar, i ndryshuar me VKM 344, datë 19.04.2017, për arkëtimin e të ardhurave për taksën e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë kapitulli II, pika 1; germa öbö dhe pika 9,
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve, në vlerën totale prej 13,800,000 lekë.
Shkaku:	Spektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka zbatuar kërkesave ligjore për arkëtimin e kësaj tarife.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Bashkia Dibër të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e shumës 13,800,000 lekë për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Në lidhje me komentet dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Dibër është paraqitur observacioni me shkresë nr.3084 prot, datë 11.09.2020 të Mbi Projektraportin e Auditimit nga z. B. M., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Deri më sot kanë bërë pagesën dhe janë pajisur me licencë këto subjekte: Subjekti D. N. Shpk, K. D. Shpk, K. P. Shpk, Sh. Shpk, M. 96 Shpk, D. Shpk, S. G Shpk, O. E. Shpk, I. N. dhe H. 2014 Shpk

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se observacioni Juaj nuk merret në konsideratë nga audituesit shtetëror të KLSH ósë, pasi ju nuk keni paraqitur dokumente dhe prova shkresore të reja për të dokumentuar arkëtimin e vlerave për licencat e autorizimeve, nuk keni sjellë njoftim vlerësimit dhe pagesat e tyre me bankë, ose ,e arkë

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. B. M., me detyrë përgjegjës sektori nga periudha 26.11.2013 e në vazhdim, z. R. G. me detyrë specialist i rakordimeve në sektorin e taksave dhe tarifave vendore.

III. Anomalitë e konstatuara në kontratat për dhënien e aseteve me qira.

Titulli i Gjetjes Shkelje të kërkesave ligjore në hartimin e kontratave për dhënien me qira të fondit pyjor dhe kullosor

Situata: Nga Bashkia Dibër na u paraqit një pasqyrë ku ishin të evidentuara 18 subjekte që kanë marrë me qira asetet të ndryshme nga Bashkia Dibër. Këto kontrata qiraje nuk administroheshin nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse me vendim të Këshillit të Bashkisë, nr.139, datë 18.07.2018 (që vjen si bashkim në strukturë i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike dhe Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të përfshira në Rregulloren e Brendshme të Administratës së Bashkisë Dibër, të miratuar me vendim të Kryetarit të Bashkisë që mban nr.25/1, datë 03.05.2017). Në nenin 2 të këtij ndryshimi të rregullores dhe pikën 24 shprehet se kjo drejtori harton kontrata e akt-marrëveshje ku bashkia është palë gjithashtu në pikën 29 të këtij neni citohet evidenton në regjistrin e kontratave dhe akt-marrëveshjeve të të gjitha akteve kontraktuale dhe caktimin e juristit të autorizuar për të ndjekur zbatimin e tyre (çdo fund muaj).

1) Në kontratën e qirasë me nr.5428 prot, datë 17.11.2017 të lidhur nga Bashkia Dibër përfaqësuar nga kryetari z. M. R. dhe subjekti òA.ò ShPK & òB.ò ShPK, përkatësisht me NIPT L.....R dhe K.....O për dhënien në përdorim të sipërfaqes 1.0535 ha, e cila është pjesë e fondit pyjor/ kullosor Bashkia Dibër, në nenin 1 òObjekti i kontratës, pika 1.1, thuhet se òQiradhënësi i ka dhënë me qira subjektin për ndërtimin e Hec-it Borie, Lure 1, me një afat 10 vjeçar, nga data 17.11.2017-16.11.2027ò.

Sipas nenit 4, të kontratës së lidhur ndërmjet palëve është përcaktuar vlera e qirasë për vitin e parë të ndërtimit në shumën 929,160 lekë, vitin e dytë në shumën 1,799,296 lekë dhe vitet e tjera të kontratës në vlerën 12,600 lekë, e llogaritur sipas VKM nr.391, datë 2.6.2006, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 òPër përcaktimin e tarifës në sektorin e pyjeve dhe kullotaveò. Vlera e përgjithshme e kësaj kontrate është 2,715,856 lekë, e përcaktuar në raportin teknik nr.3819 prot, datë 11.08.2017: a) sipas përdorimit për linjat gjatësore në km 2,615,056 lekë dhe b) vlera e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 100,800 lekë.

Nga auditimi konstatohet se nga Bashkia Dibër nuk janë përcaktuar saktë tarifat sipas aktit nënligjor të VKM nr.391, datë 02.06.2006 òPër përcaktimin e tarifës në sektorin e pyjeve dhe kullotaveò të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010, sepse hartuesit e kësaj kontrate kanë zbatuar tarifat me afat kohor për një vit dhe jo sipas afatit të kontratës që është e përcaktuar për 10 vjet.

Nga përlllogaritjet e kryera për periudhën e viteve 2018, 2019 dhe janar-qershor 2020, rezulton se:

-trungishte (linjë elektrike)	1.528km*175000 lekë*3vite =	802,200 lekë
-trungishte (tubacion)	3.399km*175000 lekë *3 vite =	1,784,475 lekë
-cungishte (linjë elektrike)	5.127km*145000lekë *3 vite =	2,230,245 lekë
-shkurre (linjë elektrike)	0.294km*145000 lekë *3vite =	127,890 lekë
-kullotë (linjë elektrike)	0,498km*145000 lekë *3 vite =	216,630 lekë
-djerr (linjë elektrike)	0.401km*110000 lekë *3 vite =	132,330 lekë
-inproduktive (linjë elektrike)	1.542km*110000 lekë*3 vite =	508,860 lekë

5,802,630 lekë (pa

llogaritur dhe vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 100,800 lekë).

Nga ana e subjektit është arkëtuar vlera 2,615,056 lekë pa llogaritur dhe vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 100,800 lekë. Vlera e qirasë në kontratë është vjetore.

Mbështetur në faktin se detyrimi kontraktual ka vlerën 5,802,630 lekë, si dhe në faktin se qiramarrësi nga ky detyrim ka paguar vlerën 2,615,056 lekë, rezulton se

qiramarrësi A.öShPK & ðB.ö ShPK, është debitor për vlerën **3,074,174 lekë, dëm ekonomik** përbuxhetin e njësisë vendore (5,802,630-2,615,056).

2. Në kontratën e qirasë me nr.275 prot, datë 05.03.2015, lidhur ndërmjet palëve Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Dibër, përfaqësuar nga Drejtori z.A. D dhe subjekti H. L. ShPK, me NIPT L.....H, me objekt dhënien në përdorim sipërfaqen 0.1416 ha, e cila është pjesë e fondit pyjor/ kullësor ekonomia pyjore ðZall Dardhë-Arrmollëo, në nenin 3 është përcaktuar: ðAfat i kontratës lidhet për një afat 10 vjeçar nga data 05.03.2015-04.03.2025. Nga auditimi rezultoi se vlera e qirasë është 68,260 lekë, e llogaritur sipas VKM nr.391, datë 2.6.2006 ðPër përcaktimin e tarifës në sektorin e pyjeve dhe kullotaveo të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010, vlerë e cila do të paguhet vitin e parë, ndërsa për vitet e tjera pagesa është zero lekë.

Në raportin teknik është përcaktuar në vlerën 1,044,328 lekë për vitin e parë, (ndërsa për vitet e tjera do të likuidohet vetëm tarifa prej 357,848 lekë) dhe me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor në vlerën 68,260 lekë për vitin e parë, ndërsa për vitet e tjera zero lekë.

Nga auditimi rezulton se nga ana e Bashkisë Dibër nuk është vepruar sipas tarifave të përcaktuara në VKM nr.391, datë 2.6.2006 ðPër përcaktimin e tarifës në sektorin e pyjeve dhe kullotaveo, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010. Hartuesit e kësaj kontrate kanë zbatuar tarifën për një vit dhe jo sipas kontratës që është e përcaktuar për 10 vjet. Nga auditimi i përllogaritjeve me tarifën në fakt që duhet të paguhet rezultojnë sa vijon:

për periudhën e auditimit 2018, 2019 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2020 për këtë kontratë qiraje.

-trungishte (tub dervacioni)	0.1560 km*175000*3vite =	81,900 lekë
-cungishte (kanal dervacioni)	1.1360 km*145000*3 vite =	494,160 lekë
-cungishte (tub dervacioni)	3.4160km*145000*3 vite =	1,485,960 lekë
-cungishte (rrugë auto)	1.1360km*50000 *3vite =	170,400 lekë
-kullotë (tub dervacioni)	0.3540km*145000*3 vite =	153,990 lekë
		2,386,410 lekë pa

vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 137,328 lekë.

Detyrimi në vite duhet të jetë 795,470 lekë në vit dhe jo sipas kontratës 357,848 lekë ndaj subjektit H. L. ShPK me NIPT L.....H.

Nga mos llogaritja e saktë në bazë të tarifave të mësipërme, subjekti H. L. ShPK është debitor vlerën **2,386,410 lekë, dëm ekonomik** për buxhetin e njësisë vendore.

3. Në kontratën e qirasë me nr.5108 prot, datë 31.10.2017, lidhur ndërmjet palëve Bashkia Dibër, përfaqësuar nga kryetari z.M. R. dhe subjekti ðL. E.ö ShPK me NIPT L.....Q, për dhënien në përdorim të sipërfaqes 0.1162 ha, e cila është pjesë e fondit pyjor/ kullësor ekonomia pyjore ðZall Dardhë-Arrmollëo, në nenin 3 është përcaktuar se afati i kontratës lidhet për një afat 10 vjeçar nga data 2017-.2027. Vlera e qirasë në vite është 144,855 lekë e llogaritur sipas VKM nr.391, datë 2.6.2006 ðPër përcaktimin e tarifës në sektorin e pyjeve dhe kullotaveo të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

Në raportin teknik është përcaktuar në vlerën 215,205 lekë për vitin e parë, ndërsa për vitet e tjera qiraja do të në shumën 144,855 lekë.

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Dibër nuk ka vepruar sipas tarifave të përcaktuara në VKM nr.391, datë 2.6.2006 ðPër përcaktimin e tarifës në sektorin e pyjeve dhe kullotaveo, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010. Hartuesit e kësaj kontrate kanë zbatuar tarifën për një vit dhe jo sipas kontratës, në të cilën është e përcaktuar për 10 vjet. Nga audituesi u llogaritën tarifën për periudhën e auditimit

2018, 2019 dhe vitin 2020 për këtë kontratë qiraje, si vijon:

-cungishte (kanal dervacioni)	0.039 km*145 000*3vite	= 16,965 lekë
-cungishte (tubacion)	0.96km*145 000*3vite	=417,600 lekë
-cungishte (linjë elektrike)	0.365km* 145 000*3vite	= <u>158,775 lekë</u>
		593,340 lekë pa vlerën

e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 1000 lekë.

Detyrimi i subjektit òL. E.ò ShPK, në vit duhet të jetë 197,780 lekë dhe jo sipas kontratës 144,855 lekë.

Subjekti nga momenti i lidhjes së kontratës me bashkinë Dibër ka arkëtuar vlerën 504,915 lekë (viti I 215,205 +viti II 144,855+ viti III 144,855 = 504,915 lekë). Nga mos llogaritja e saktë në bazë të tarifave të mësipërme, subjekti òL. E.ò ShPK rezulton debitor në vlerën **88,425 lekë, dëm ekonomik** për buxhetin e njësisë vendore (593,340-504,915lekë).

Për veprimet e mësipërme mban përgjegjësi znj. K. L. specialiste e kadastrës, z.V. T., përgjegjës i strukturës së pyjeve dhe kullotave, z.S. T., me detyrë ish Drejtor i Bujqësore dhe ish Kryetari i Bashkisë z.M. R..

4.Në kontratën e qirasë lidhur më datën 24.04.2015, ndërmjet palëve ish komuna Arras, përfaqësuar nga kryetari z.S. T., dhe qiradhënësit subjekti òH. S.ò ShPK, me NIPT L.....T me objekt dhënien me qira të sipërfaqes 2.7086 ha, afati 10 vjet. Vlera e qirasë për vitin e parë 687,950 lekë dhe vitet e tjera 91,450 lekë. Me këtë subjekt është lidhur dhe një kontratë qiraje tjetër me komunën Lurë përfaqësuar nga ish kryetari z. H. G., për dhënien me qira të sipërfaqes prej 4.4856 ha, e cila është pjesë e fondit pyjor/ kullosor ish komuna Lurë. Në nenin 3 është përcaktuar se afati i kontratës lidhet për një afat 10 vjeçar, nga data 30.03.2015-2025. Vlera e qirasë për vitin e parë është përcaktuar 2,555,228 lekë dhe vitet e tjera 1,180,195 lekë, e llogaritur sipas VKM nr.391, datë 2.6.2006 òPër përcaktimin e tarifës në sektorin e pyjeve dhe kullotaveò të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

Nga auditimi u konstatua se në këto kontrata nuk është vepruar sipas tarifave të përcaktuara në VKM nr.391, datë 2.6.2006 òPër përcaktimin e tarifës në sektorin e pyjeve dhe kullotaveò, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010. Për të dyja kontratat është përcaktuar në një raport teknik për ish komunën Lurë në vlerën 2,555,228 lekë për vitin e parë, ndërsa për vitet e tjera do të likuidohet tarifa prej 1,180,195 lekë, për komunën Arras në vlerën 687,950 lekë për vitin e parë, ndërsa për vitet e tjera do të likuidohet tarifa prej 91,450 lekë.

Nga audituesi u llogaritën tarifat për periudhën e auditimit

-Trungishte (kanal)	1.9850 km*175 000 lekë/vit	= 347 375 lekë
-Trungishte (tubacion)	0.78 km* 175 000 lekë/vit	= 136 500 lekë
-Trungishte (rrugë aksesi)	3.173 km * 70 000lekë/vit	= 2 211 000 lekë
-Trungishte (rrugë auto)	2.765 km *70 000lekë/vit	= 193 550 lekë
-Trungishte (vend depozitimi)	0.2 ha*250 000 lekë/vit	= 50 000 lekë
-Cungishte (tubacion)	3.76 km*145 000 lekë/vit	= 545,200 lekë
-Cungishte (rrugë aksesi)	1.409 km*50 000 lekë/vit	= 70 450 lekë
-Cungishte (vend depozitimi)	0.18 ha*250 000 lekë/vit	= 45 000 lekë
-Inprodukte (kanal)	1 km*110 000 lekë/vit	= 110 000 lekë
-Inprodukte (tubacion)	0.265 km*110 000lekë/vit	= 29 150 lekë
-Inprodukte (tubacion)	0.085 km*150 000 lekë/vit	= 12 750 lekë
- Inprodukte (rrugë auto)	1.18 km *25 000 lekë/vit	= 29 500 lekë
-Djerr (tubacion)	0.15 km*110 000 lekë/vit	= 16 500 lekë
-Djerr (rrugë auto)	0.15 km* 30 000 lekë/vit	= 4 500 lekë
-shkurre (rrugë aksesi)	0.486 km* 3500 lekë/vit	= 17 010 lekë

1,829,595 lekë pa vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 1,244,383 lekë.

Nga auditimi konstatohet se detyrimi në vite i subjektit òH. S.ò, ShPK duhet të jetë 1,839,195 lekë në vit dhe jo sipas kontratës 1,271,645 lekë, së bashku për komunën Lurë dhe komunën Arras (1,839,195-1,271,645 lekë =557,950 lekë detyrim në vit) Nga përlllogaritja jo e saktë nga hartuesit e kontratave të qirave, në bazë të VKM nr.1064, datë 22.12.2010, subjektit i linden detyrime për periudhën e auditimit për tarifatat në vlerën **2,945,495 lekë**, dëm ekonomik ndaj bashkisë.

Të dhënat në formë tabele për vlerën e mësipërme të detyrimit jepen në aneksin nr. nr.2/22 bashkëngjitur raportit të auditimit.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

z. M. R., ish/Kryetari i Bashkisë në Bashkinë Dibër.

znj. K. L. Specialiste e Kadastrës (Pyjeve),

z.V. T., Përgjegjës i Strukturës së Pyjeve dhe Kullotave,

z.S. T., ish Drejtor i Bujqësisë, ndërprerë marrëdhëniet e punës.

Kriteri:

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- Ligjit 9385 datë 04.05.2005 òPër pyjet dhe shërbimin pyjorë të ndryshuar

-VKM nr.391 datë 21.06.2006 òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotaveò ndryshuar

- VKM nr 1064 datë 22.12.2010 òPër disa ndryshime në vendimin nr. 391 datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotaveò pika 2 lidhja 2/6 òPër nxjerrje prodhim dhe depozitim materialesh inerte direkt nga sipërfaqjaò,

- VKM nr.54 datë 05.02.2014 òPër përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò i ndryshuar,

-Urdhër Nr.131, datë 10.07.2018 dhe vendimin.139, datë 18.07.2018 të kryetarit

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash për njësinë vendore

Shkaku: Mos respektimi e kuadrit ligjor nga personat përgjegjës

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim Bashkia Dibër për kontratat e lidhura ndërmjet operatorëve në fushën e energjisë (HEC-eve) të rishikojë llogaritjen e detyrimeve dhe të marrë të gjitha masat (administrative dhe gjyqësore) për vjeljen e detyrimit gjë që ka sjell dëm ekonomik në vlerën 8,494,504 lekë, sipas aneksit nr.2/22 në fund të raportit të auditimit.

Për sa më sipër janë paraqitur kundërshti nga z. V. T. dhe K. K., nëpërmjet shkresës nr.61prot, datë 08.09.2020, ku në mënyrë të përmbledhur thuhet:

1- Pretendim i subjektit: Dëmi ekonomik i llogaritur nga ana juaj për subjektin "A. & B." ShPK nuk qëndron. Tubacionet që shtrihen nën tokë tarifohen vetëm për një vit.

Në lidhje me subjektin H. L. ne kemi zbatuar tarifatat për një vit dhe jo sipas kontratës që është përcaktuar për 10 vjet. Një pretendim i tillë është pjesërisht i vërtetë. Vlera prej 2.386.410 lekë dhe vlera e re e llogaritur duhet të jetë 1.721.850 lekë pasi këto tarifa janë paguar nga subjekti si tarifë vjetore.

Në lidhje me subjektin "L. E.", tarifa të tilla si ajo cungishte(kanal derivacioni) 0.039 km*145,000=5655 lekë dhe cungishte (tubacion.) 0.96 km*145000 =139,200 lekë janë vendosur për gjithë kohëzgjatjes së kontratës, ndërsa zëri tjetër cungishte (linjë elektrike) është tarifuar si tarifë njëvjeçare.

Subjekti "H." ShPK llogaritjet e tarifave sipas zërave përkatës dhe janë njëlloj me përjashtim të zërit cungishte tubacion nën tokë që ju e keni llogaritur për gjithë kohëzgjatjen e kontratës, për të cilën ne kemi qëndrimin tonë të njohur që tubacionet e shtrira në tokë tarifohen vetëm për vitin e parë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet dhe dokumentet e paraqitura nga ana juaj, audituesit e KLSH-së dalin në përfundim se pretendimet tuaja nuk do të merren në konsideratë, nuk janë zbatuar dhe llogaritur saktë VKM nr. 1064 datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 391 datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" pika 2 lidhja 11.

2-Pretendim i subjektit: Për sa më sipër me shkresën nr.3085 prot, datë 11.09.2020 janë paraqitur kundërshti nga zj. E. L., ku në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Për kontratën e qirasë me nr.275 prot, datë 05.03.20105 ndërmjet palëve Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Dibër dhe subjektit "H. L." dhe për kontratën e qirasë më datën 24.04.2015, ndërmjet palëve komuna Arras dhe subjektit "H. S.", janë kontrata të lidhura nga ish komunat dhe nuk jam unë ajo që kam lidhur këto kontrata, pasi marrëdhëniet e punës time fillojnë me këtë institucion më vitin 2016 dhe konkretisht me vendimin nr.71, datë 07.04.2016.

Për dy kontratat e tjera, për kontratën e qirasë me nr.5428 prot, datë 17.11.2017, si dhe kontratën me nr.5108 prot, datë 31.10.2017 unë kam mbajtur pozicionin e specialistes juriste pranë Drejtorisë Juridike.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet dhe dokumentet e paraqitura nga ana juaj, audituesit e KLSH-së dalin në përfundim se pretendimet tuaja do të merren në konsideratë.

IV.Detyrimet e subjekteve që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit publik dhe kanë kryer punë publike në Bashkinë Dibër.

Titulli i Gjetjes Mos llogaritje e taksave për subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit publik në Bashkinë Dibër

Situata: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Dibër nuk ka llogaritur dhe arkëtuar detyrime për taksat dhe tarifave vendore, për subjektet të cilat janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit, për punë publike dhe si rezultat kanë zhvilluar aktivitet në teritorin e njësisë vendore. Për periudhën e auditimit u konstatua se janë nëntë subjekte të tilla, në cilësinë e kontraktorit dhe nga mos llogaritjet e detyrimeve të mësipërme, është shkaktuar e ardhur e munguar në vlerën 290,990 lekë. Lista e subjekteve dhe detyrimet e tyre, paraqiten në aneksin nr.2/23, bashkëngjitur raportit të auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:

z. B. M. me detyrë Përgjegjës i Taksave dhe Tarifave Vendore.

Kriteri: Neni 43 pika 1/1 e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, kontraktori përpara fillimit të punimeve duhet të aplikojë në QKB për hapjen e vendit të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshëm nga selia (sipas vendndodhjes të objektit të kontratës). Për mos hapjen e vendit të ushtrimit të veprimtarisë këto subjekte janë në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, kreut VII, neni 35, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit KM nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 43/1.

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar,

2) Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e

Shqipërisë i ndryshuar, neni 43 pika 1/1.

2) Vendimi i Këshillit të Bashkisë Dibër, nr.107, datë 20.12..2017 dhe nr.138, datë 24.12.2018 për miratimin e paketës fiskale.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve në bashki

Shkaku: Nga mos funksionimin i detyrave dhe kompetencat përkatëse dhe në mos zbatimin e ligjit, për arkëtimin e kësaj tarife nga ana e kësaj drejtorie.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Sektori i taksave dhe tarifave vendore të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për ngarkimin me detyrime të subjekteve të mësipërme dhe arkëtimin e vlerës prej 290,990 lekë. Në vijimësi të bëjë llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifavat vendore sipas paketës fiskale për të gjitha subjektet që zhvillojnë aktivitet në teritorin e njësisë vendore si rezultat i pjesëmarrjes dhe shpalljes fitues në procedurat e prokurimit publik

Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga subjekti, paraqitur me shkresën nr.3084 prot, datë 11.09.2020 nga ana e z. B. M., ku në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendim i subjektit: *Ne si Zyrë e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk kemi qenë në dijeni nga sektori i prokurimeve, nuk jemi informuar për subjektet fituese, po ashtu edhe subjektet fituese nuk kanë aplikuar në QKB për hapjen e aktivitetit me nipt sekondar që ne ti ngarkonim me detyrime për periudhën e punimeve. Pas konstatimit nga ana juaj llogaritëm detyrimet për kohën e kryerjes së punimeve në bazë të ligjit për taksat dhe tarifavat vendore dhe VKB duke plotësuar faturën për arkëtim dhe dërguar subjekteve përkatëse. Dërgimit të faturave kanë bërë pagesën disa subjekte në vlerën 101.920 lekë.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Në lidhje me komentet dhe dokumentet e paraqitura nga ana juaj, audituesit e KLSH-së dalin në përfundim se pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë. Është detyrim ligjor nga ana e sektorit që ju drejtoni për regjistrimin e çdo subjekti që ushtron aktivitet në Bashkinë Dibër, në zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1 “Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm.*

V. Problematika e konstatuara në llogaritjen dhe pagesën e detyrimeve, për subjektet që zhvillojnë aktivitet nxjerrje minerali.

Titulli i Gjetjes	Mbi mos lidhjen e kontratave të qirave me subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e nxjerrjes së mineraleve, nga marrja me qira e fondit pyjor e kullësor.
Situata:	Nga auditimi i kryer për procedurat e dhënies me qira të objekteve pronë e bashkisë dhe e ndërmarrjeve shtetërore në varësi, ose nën juridiksionin e bashkisë, u auditua dokumentacioni për periudhën 2018, 2019 dhe 6 muajt e parë të vitit 2020, në lidhje me dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullësore dhe inproduktive, nga ku konstatohet se nga Bashkia Dibër nuk ka kontrata të lidhura me subjektet të cilat janë miratuar me leje nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë për dhënien me qira për sipërfaqet pyjore dhe kullësore që administrohen nga kjo bashki. Subjekte të pajisur me leje minerare por që nuk janë lidhur kontrata qiraje nga njësi vendore, bazuar në dokumentacionin e audituar:

	<p>1-Subjekti òH.òShPK, i cili sipas lejes minerare ka një sipërfaqe prej 0.5 ha dhe bazuar në llogaritjet që përcakton kuadri rregullator në fuqi duhet të kishte paguar vlerën 550,000 lekë;</p> <p>2- Subjekti òP.òShPK, i cili sipas lejes minerare ka një sipërfaqe prej 216.5 ha dhe bazuar në llogaritjet që përcakton kuadri rregullator në fuqi duhet të kishte paguar vlerën 238,700,000 lekë.</p> <p>Këto llogaritje janë bërë nga grupi i auditimit vetëm për periudhën e auditimit. Më hollësisht, të dhëna për këto dy subjekte, si sipërfaqja, tarifata, vlerat që duhet të ishin llogaritur për çdo vit nga njësitë vendore, jepen në aneksin.. nr.2/23.1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.</p> <p>Grupi i auditimit të KLSH, në kushtet e pamundësisë së dokumentacionit për këto subjekte që ushtrojnë aktivitetet në asetet e Bashkisë Dibër dhe që nuk janë të pajisur me kontrata qiraje dhe asnjë dokumentacion shtesë, ju drejtuam Kryetarit të Bashkisë me kërkesë më datën 08.07.2020 dhe e protokolluar me nr.1861/2, datë 08.07.2020, për ngritjen e një komisioni për verifikimin dhe matjen në vend të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga këto subjekte, që janë të pajisura me leje minerale aktive nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë. Më datën 08.07.2020 doli urdhi me nr.260 prot., për ngritjen e një komisioni për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.</p> <p>Nga ana e komisionit nuk na u vu në dispozicion asnjë shkresë e protokolluar nga zyra e protokollit, nga materiali i përgatitur nga ana e tyre, gjë që ka sjell pengesë në punën tonë dhe njëkohësisht kanë thyer dhe urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Dibër.</p> <p>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:</p> <p>z. V. T. me detyrë përgjegjës i sektorit të pyjeve, z. K. E. me detyrë specialist pyjesh z. I. G. me detyrë specialist pyjesh znj.K. L. me detyrë specialist pyjesh</p>
Kriteri:	Referuar pikës 2; lidhjes nr.2, pika 6/1 dhe pika 9/4 të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave, i ndryshuar, me VKM 1064 datë 22.12.2010 "Për Përcaktimin e Tarifave në Sektorin e Pyjeve dhe të Kullotave", Vendimit nr.25/1, datë 03.05.2017 òPër miratimin e rregullores mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së bashkisë dhe njësitë administrative në 100 sektorin e pyjeve dhe kullotave dhe vendimit nr.124, datë 20.12.2019, të paketës fiskale fq.24-25 òTarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave, të VKM nr.391, datë 21.06.2006 me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 "Për Përcaktimin e Tarifave në Sektorin e Pyjeve dhe të Kullotave",
Impakti:	Mungesë të ardhurash për njësinë vendore
Shkaku:	Mos respektimi e kuadrit ligjor nga personat përgjegjës.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Bashkia Dibër, të marrë masa për lidhjen e kontratave për dhënie me qira për sipërfaqet pyjore dhe kullimore që administrohen nga kjo bashki, me subjektet të cilat janë pajisur me leje nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë.

Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga z. M. D., paraqitur me shkresën nr.2629 prot, datë 29.07.2020, ku në mënyrë të përmbledhur thuhet:

1) Pretendim i subjektit:

Në urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.260 prot, datë 08.07.2020, jemi ngarkuar me detyrë verifikimin në terren dhe matjen në vend të sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet që janë pajisur me leje minerale nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë: subjektet “P.” shpk dhe “H.” shpk me sipërfaqe 216.5 ha dhe 0.5 ha por që nuk kanë kontratë qiraje. Nga ana jonë si komision u bë e mundur lidhja me subjektet dhe nga ana e tyre nuk na u vu në dispozicion asnjë informacion shkresor apo verbal sipas afateve të vena në dispozicion nga grupi i punës. Në këto kushte komisioni verifikoi në terren galeritë përkatëse dhe bëri matjet faktike të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

1. “P.” shpk me sipërfaqe të shfrytëzueshme $S=1255m^2$

2. Subjekti “H.” shpk me sipërfaqe të shfrytëzueshme $S=0.05km^2$

Unë M. D. me detyrë specialist i planifikimit të territorit sipas vendimit nr.144, datë 21.05.2020 jam emëruar provizor në këtë detyrë dhe nuk mund të mbaj përgjegjësi për dëmin për një periudhë që nuk kam qenë në detyrë pranë bashkisë Dibër.

2) Pretendim i subjektit: Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga V. T., K. E., I. G. dhe K. K., paraqitur me shkresën me nr.2671 prot, datë 03.08.2020, protokolluar në KLSH me nr.466/3, datë 06.08.2020, ku në mënyrë të përmbledhur thuhet: Pranë Bashkisë Dibër dhe sektorit të pyjeve dhe të kullotave në varësi të saj nuk është regjistruar në asnjë kohë asnjë kërkesë nga ndonjë subjekt për marrjen në përdorim apo heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve pyjore/kullosore për ushtrim aktiviteti mineral dhe nuk është lidhur asnjë kontratë. Për sa më sipër sapo kemi konstatuar për subjektin P. për ushtrim të paligjshëm të aktivitetit në fondin pyjor/kullosor është bërë denoncim nga ana jonë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut Dibër.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa i përket observacionit të z.M. D. dhe komisionit të verifikimit të sipërfaqeve të shfrytëzueshme në terren për lejet minerare, nga grupi i audituesve shtetërorë të KLSH-së merret në konsideratë për sa i përket masave disiplinore për faktin se grupi i punës i ngritur sipas kërkesës së grupit të auditimit të KLSH nr.1861/2, datë 08.07.2020 dhe urdhrin të Kryetarit të Bashkisë Dibër nr.260, datë 08.07.2020, për ngritjen e grupit të punës dhe verifikimin në vend të sipërfaqeve që këto subjekte shfrytëzojnë. Sqarojmë se dokumentacioni që shoqëron këtë procedurë, nuk është bindës për grupin e auditimit, pasi skicat nuk janë për të gjitha subjektet në lidhje me sipërfaqen e shfrytëzueshme dhe më kryesorja nga grupi nuk është analizuar në aktet e mbajtura se sa është sipërfaqja që ato kanë marrë nga MEI, sa kanë në shfrytëzim deri në datën e mbajtjes së këtyre akteve dhe sa mbeten për periudhën e mëvonshme deri në datën e përfundimit të lejes së marrë nga MEI. Në përfundim argumentet e paraqitura nuk sqarojnë situatën dhe mbetet detyrë për Kryetarin e Bashkisë për vijimin e punës për verifikimin deri në fund të këtij procesi.

3) Pretendim i subjektit: Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga z.V. T., K. E., I. G. dhe K. K., paraqitur me shkresën me nr.61prot, datë 08.09.2020, ku në mënyrë të përmbledhur thuhet: Ne mendojmë që në llogaritjen e vlerës financiare nuk mund ti referohemi sipërfaqes prej 217 ha pasi kjo sipërfaqe përfaqëson sipërfaqen e fondit pyjor që subjekti ka fituar të drejtën e shfrytëzimit në të cilën do të bëjë kërkimet, zbulimet dhe prodhim mineral nëpërmjet galerive nëntokësore të cilat nuk mund të tariforen pasi nuk sjellin pasoja apo dëmtimet të fondit pyjor. Bazuar në këtë logjikë sipërfaqja e dhënë në përdorim do të ishte dukshëm më e vogël dhe llogaritur jo sipas pikës 6, që është 440.000 lekë/ha/vit e cila bën fjalë vetëm për kategorinë e përdorimit të tokës pyjore sipërfaqe inproduktive nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte direkt nga sipërfaqja karrierë por sipas pikës 9 të lidhjes nr.2 “Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektsh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe”.

Nisur nga rastet të ngjashme të kësaj natyre sipërfaqja e nevojshme për një aktivitet të tillë luhatet nga 1 deri në 2ha apo edhe më pak 0.5 ha subjekti H., që llogaritur sipas tarifave

të pikës 9 të lidhjes 2 vlera financiare vjetore për lidhjen e një kontrate të tillë është afërsisht 2ha x78,000lekë/ha/vit =156 000lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet dhe dokumentet e paraqitura nga ana juaj, audituesit e KLSH-së dalin në përfundim se pretendimet tuaja nuk do të merren në konsideratë, në këtë rast kemi të bëjmë me shfrytëzim dhe jo me operacione të kërkim zbulimit gjeologjike e minerale. Duhet të kishit përcaktuar dhe kontrolluar në lejen e shfrytëzimit sipërfaqen e shfrytëzueshme e rrugë kalimet. Është detyrë e sektorit të pyjeve e kullotave për subjektet që ushtrojnë aktivitetet në territorin bashkisë tuaj në fondin pyjor dhe kullor dhe duhet të ishin objekt i ndëshkimit të ligjit për veprimtari jo ligjore, për dëmtimet të fondit pyjor

Në lidhje me pretendimet dhe dokumentet e paraqitura nga inxhinierët e pyjeve të Bashkisë Dibër, audituesit e KLSH-së dalin në përfundim se pretendimet nuk do të merren në konsideratë, pasi janë të pa argumentuara, subjekte që janë pajisur me leje nga MEI nuk kanë lidhur kontrata me Bashkinë Dibër dhe janë në kundërshtim të zbatimit të VKM 1064, datë 22.12.2010 "Për Përcaktimin e Tarifave në Sektorin e Pyjeve dhe të Kullotave".

VI. Mos marrja e masave për arkëtimin e gjobave të aplikuara nga IMTV dhe Policia Bashkiake Bashkia Dibër

Titulli Mos arkëtim i të gjitha gjobave të vendosura nga IMTV dhe policia bashkiake
Gjetjes Dibër
Situata: Nga Bashkia Dibër nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e gjobave të vendosura nga policia bashkiake dhe inspektorati i mbrojtjes së teritorit (IMT). Për periudhën janar 2018 ó Dhjetor 2020, nga policia bashkiake janë vendosur 116 gjoba me vlerë 171,000 lekë, por janë arkëtuar vetëm 25,000 lekë, pa arkëtuar vlera **146,000 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Dibër (për vitin 2018 vlera 19,000 lekë, për vitin 2019 vlera 23,000 lekë, për vitin 2020 vlera 104,000 lekë). Gjobat e vendosura nga policia bashkiake janë të pa kontabilizuara.

Përshkrimi	Periudha 2018				Periudha 2019				Periudha 2020			
	N r	Vlera	Arkëtuar	difern	N r	Vlera	Arkëtuar	difern	N r	Vlera	Arkëtuar	difern
Parkgabim	25	25,000	6,000	19,000	30	30,000	7,000	23,000	45	41,500	0	41,500
H publik	0	0	0	0	0	0	0	0	23	74,500	12,000	62,500
	25	25,000	6,000	19,000	23	30,000	7,000	23,000	68	116,000	12,000	104,000

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Drejtoria e Policisë Bashkiake.

Në kundërshtim me detyrën funksionale, në sektorin e IMTV, pas aplikimit të gjobës ndaj kundravajtësit, akti të gjobës nga inspektorët e këtij sektori nuk është dorëzuar në financë, duke mos bërë të mundur që kjo e fundit të bëjë rregjistrimin/kontabilizimin e gjobave të vendosura, mos njohje e gjendjes së gjobave të aplikuara, gjendjes së gjobave të paarkëtuara, mos njohje e gjendjes nga sektori juridik për ndjekjen e çështjeve të arkëtimin sipas procedurave ligjore në gjykatë, mos njohjen e gjendjes nga titullari i institucionit.

Nga IMT janë vendosur gjithsej 30 gjoba, por 23 prej tyre në vlerën **1,350,000 lekë** nuk janë arkëtuar, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Dibër (për vitin 2018 vlera 1,050,000 lekë, për vitin 2019 vlera 250,000 lekë, për vitin 2020 vlera 50,000 lekë)

Për vitin 2018 gjoba nga IMTV të pa arkëtuar e pa kontabilizuar 1,050,000 lekë

Për vitin 2019 gjoba nga IMTV të pa arkëtuar e pa kontabilizuar 250.000 lekë

Për vitin 2020 gjashtë mujori i parë gjoba nga IMTV të pa arkëtuar e pa kontabilizuar 50,000 lekë.

Sipas viteve vlera e gjobave të pa arkëtuara nga Policia Bashkiake:

Viti 2018 vlera e pa arkëtuar është 19,000 lekë.
Viti 2019 vlera e pa arkëtuar është 23,000 lekë.
Viti 2020, vlera e pa arkëtuar është 104,000 lekë.

Për mos dorëzimin në financë të akteve tëgjobave të vendosura nga IMTV ngarkohen me përgjegjësi:

Z. E. X., me detyrë, Kryeinspektor i IMTV nga periudha 11.04.2018 e në vazhdim.

Z. J. O., me detyrë inspektor i IMTV nga periudha 27.06.2016 e në vazhdim

Z. F. R., me detyrë inspektor i IMTV nga periudha 17.08.2016 e në vazhdim

Z. B. B., me detyrë inspektor i IMTV nga periudha 23.04.2018 e në vazhdim.

Edhe pse vlera e vlera e gjobave të pa arkëtuara të policisë bashkiake është e ulët (146,000 lekë), grupi i auditimit sjell në vëmendje të kësaj strukture se menjëherë pas aplikimit të gjobës, kopjen origjinale të saj ta dorëzojë në financë për arsye të kontabilizimit të saj (kjo vlen edhe për IMTV).

Për mos dorëzimin në financë të akteve të gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake ngarkohen me përgjegjësi:

z. I. K. me detyrë ish/kryeinspektor i policisë bashkiake me detyrë nga data 07.03.2018-29.05.2019.

z. M. M. me detyrë inspektor nga data 05.08.2019 dhe i komanduar si kryeinspektor.

- Kriteri:**
- 1).Ligji nr.9780, datë 16.07.2007 òPër Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeò, i ndryshuar,
 - 2).Ligji nr.107/2014, datë 31.07.2014 òPër Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritò, i ndryshuar,
 - 3).Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin e punimeve në ndërtim", i ndryshuar,
 - 4).VKM nr. 894, datë 4.11.2015 òPër unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendoreò;
 - 5).Udhëzimi i KM nr. 2,datë 13.05.2005ò Për zbatimin e punimeve të ndërtimitò;
 - 6).Udhëzim i KM nr. 3, datë 15.02.2001 òPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar me Udhëzimin e KM nr.1, datë 16.6.2011;
 - 7).Ligji nr. 8224, datë 15.5.1997 òPër Organizimin dhe Funksonimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunësò i azhurnuar me: ligjin nr.8335, datë 23.04.1998

Ndikimi/ Mungesë të ardhurash në buxhet

Efkti:

Shkaku: Mos respektimi e kuadrit ligjorë nga peronat përgjegjës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: Bashkia Dibër, IMTV në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e gjobave të vendosura prej saj në vlerën 1,350,000 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër.
Policia bashkiake të marrë masa për arkëtimin e plotë të gjobave të vendosura prej saj në vlerën prej 105,000 lekë ndaj individëve dhe subjekteve të cilët kanë vepruar në kundërshtimin me ligjin nr. 8224, datë 15.5.1997 òPër Organizimin dhe Funksonimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunësò i azhurnuar me ligjin nr.8335, datë 23.04.1998

Lista analitike e gjobave të policisë bashkiake dhe IMTV të pa arkëtuara për vitin 2018, 2019 dhe 2020, paraqitet në aneksin nr. 2/26, 2/27 dhe 2/28, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga z. J. O., F. R. dhe B. B., paraqitur me shkresën nr.2667 prot, datë 03.08.2020, ku në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendim i subjektit: Në asnjë moment neni 5 i ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007 për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit, nuk ngarkon me përgjegjësinë e vjeljes së gjobave specialistët e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Dibër.

Grupi i auditimit na ka ngarkuar me përgjegjësi në kundërshtim me nenin 13 të ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit. Bazuar në rregulloren e brendshme dhe nenin 13 të këtij ligji kryeinspektori i inspektoratit ngarkohet për veprimet e mëtejshme. Ky i fundit ka detyrim ligjor që të nënshkruaj aktin administrativ si dhe të përcjell vendimin për ekzekutimin pranë drejtorisë së financës së bashkisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: 1.Në lidhje me komentet dhe dokumentet e paraqitura nga ana juaj, audituesit e KLSH-së dalin në përfundim se pretendimet tuaja nuk do të merren në konsideratë, dhe nuk është detyrë e specialistit të planifikimit të të ardhurave/rakordimit të vjelje gjobat e IMTV, por ndjek ritmikën e arkëtimit dhe ekzekutimin e vjeljes së gjobave të vendosura nga organet e caktuara neni 60 dhe neni 1 bën regjistrimin në ditarë të veprimeve të bankës së thesarit për të ardhurat e arkëtuara sipas rregullores së brendshme të Bashkisë Dibër nr.139, datë 18.07.2018. Nga ana juaj duhet të kontabiloheshin gjobat në financë dhe njëkohësisht duhet ti dërgoni dhe pranë sektorit juridik për veprime të mëtejshme juridike nëse përbëjnë vepër penale në bazë Ligjit. Nr.107/2014, datë 31.07.2014 për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, i ndryshuar, Neni 52.

Pretendim i subjektit: Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga subjekti i audituar, për mos arkëtimin e gjobave të vendosura prej IMTV, Paraqitur me shkresën me nr.3148 prot, datë 16.09.2020 nga ana e z. E. X., ku thuhet:

Përsa i takon të ardhurave të munguara në buxhetin e bashkisë Dibër sektori i IMTV varet nga ekzekutimet e Përmbaruesit Gjyqësor për vjeljen e gjobave të vendosura për periudhën e auditimit dhe për këtë arsye rezultojnë të pa mbledhura 23 raste në vlerën 1,350,000 lekë për të cilën do të ndiqen të gjitha hapat ligjore për vjeljen e tyre.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet dhe dokumentet e paraqitura nga ana juaj, audituesit e KLSH-së dalin në përfundim se pretendimet tuaja nuk do të merren në konsideratë, pasi ju nuk keni ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore për arkëtimin, dërgimin në zyrën e financës për kontabilizimin nga kjo e fundit, pra ju nuk keni bashkëpunuar me drejtorinë e financës dhe zyrën juridike për hapa të mëtejshëm ligjorë për vjeljen e tyre.

C. Vlerësimi i raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2018-2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performances financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë

Për të dy vitet 2018 dhe 2019 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Pasqyrat financiare;

Lista e inventarit të aktiveve;

Dokumentacioni lidhur me kryerjen e inventarizimit vjetor;
Evidenca përmbledhëse të fundvitit mbi gjendjen e debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore.
Evidencat analitike mbi gjendjen e debitorëve të tjerë, si dhe evidencat analitike mbi gjendjen e kreditorëve.

Aktet e rakordimi me degën e thesarit Dibër për të ardhurat dhe shpenzimet;

Dokumentacioni mbi transaksionet bankare të kryera (lidhjet e bankës).

Ditarët e bankës, ditari i magazinës, libri i magazinës, fletëhyrjet dhe fletëdaljet e magazinës.

Pasqyrat financiare për vitin 2018 dhe 2019 janë hartuar nga ish përgjegjësja e financës znj. V. K..

Për të dy vitet ushtrimore 2018 dhe 2019, dy formatet kryesore: Pasqyra e pozicionit financiar dhe Pasqyra e Performances Financiare, janë paraqitur në anekset nr.7, nr.8, nr.9 dhe nr.10 të Projektraportit të Auditimit.

Për evidentimin kontabël të aktivitetit ekonomik dhe financiar, në këtë bashki, është organizuar dhe funksionon struktura e Drejtorisë Ekonomike e përbërë nga punonjësit sipas aneksit nr.3 në fund të raportit përfundimtar të auditimit.

Për vitin 2019, janë hartuar pasqyrat financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore Bashkia Dibër, të cilat janë paraqitur në degën e thesarit Dibër, në datën 11.04.2020, jashtë afateve ligjore (të cilat janë brenda 31.03.2020).

Për vitin 2018, janë hartuar pasqyrat financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore Bashkia Dibër, të cilat janë paraqitur në degën e thesarit Dibër, në datën 26.04.2019, jashtë afateve ligjore.

I. Aktivet Afat shkurtra

Titulli i Gjetjes Komisioni i inventarizimit nuk është shprehur për gjendjen e magazinës për llogarinë e aktiveve afatshkurtra 312 Materiale dhe 327 Inventar i imët

Situata: Llog. 31 6Materiale, në bilancin e vitit 2019 ka vlerën 16,238,839 lekë.

Komisioni i inventarizimit të vitit 2019 nuk është shprehur për gjendjen e magazinës më 31.12.2019, por janë hartuar akte rakordimi mujore dhe vjetore midis specialistit të magazinës, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës. Në aktin e rakordimit vjetor vlera e llogarisë 312, ka të njëjtën vlerë me atë të bilancit, 16,238,839 lekë.

Në fund të vitit 2018 kjo llogari ka vlerën 12,207,532 lekë. Edhe në vitin 2018 komisioni i inventarizimit nuk është shprehur për gjendjen e magazinës më 31.12.2018, por janë hartuar akte rakordimi mujore dhe vjetore midis specialistit të magazinës, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës. Në aktin e rakordimit vjetor vlera e llogarisë 312, ka të njëjtën vlerë me atë të bilancit, 12,207,532 lekë.

- Llog.32 -Inventar i imët, në bilancin e vitit 2019 ka vlerën 7,474,330 lekë.

Komisioni i inventarizimit të vitit 2019 nuk është shprehur për gjendjen e magazinës më 31.12.2019, por janë hartuar akte rakordimi mujore dhe vjetore midis specialistit të magazinës, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës. Në aktin e rakordimit vjetor vlera e llogarisë 32, ka vlerën 7,474,330 lekë, të njëjtën vlerë me atë të bilancit.

Për vitin 2018 Llogaria 32 në pasqyrat financiare ka vlerën 23,043,849 lekë.

Komisioni i inventarizimit të vitit 2018 nuk është shprehur për gjendjen e magazinës më 31.12.2019, por janë hartuar akte rakordimi mujore dhe vjetore midis specialistit të magazinës, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës. Në aktin e rakordimit vjetor vlera e llogarisë 32, ka të njëjtën vlerë me atë të bilancit, 23,043,849 lekë.

Kriteri: Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publicö, Rubrika IV, -Sstemi i kontrollit periodik te aktiveve, pika 85.

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e inventarizimit të magazinës nga komisioni nuk jep siguri për gjendjen e aktiveve, pavarësisht se janë kryer akte rakordimi midis strukturave të drejtorisë ekonomike.

Shkaku: Mos zbatim i detyrës funksionale nga komisioni i inventarizimit

Rëndësia: E mesme

Titulli i Gjetjes Paraqitje jo e saktë e vlerës së llogarisë 35- Mallra në pasqyrat financiare të vitit 2019

Situata: Llogaria 35- Mallra në 31.12.2019 ka vlerën 10,107,240 lekë dhe përbëhet nga lëvizja e letrave me vlerë e cila është e përfshirë në llogarinë 35 òMallraö. Në këtë llogari janë futur: pulla të gjendjes civile, bileta tregu, vërtetime të ndihmës ekonomike etj vërtetime të kësaj natyre.

Në datën 31.12.2019 sipas aktit të rakordimit të mbajtur nga punonjësit e mësipërm rezulton se vlera e këtyre aktiveve të llogarisë 35 òMallraö është 10,223,607 lekë, me një diferencë nga vlera e nxjerre në bilanc prej 116,367 lekë. Pra në bilanc kjo llogari është paraqitur në vlerën 10,107,240 lekë, ose 116,367 lekë më pak nga gjendja reale e aktiveve të kësaj llogarie.

Nga auditimi i ditarit të lëvizjeve të letrave me vlerë, të mbajtur nga specialistja e financës, konstatohet se në vitin 2020, është bërë çelja në ditar sipas vlerës reale 10,223,607 lekë dhe jo sipas vlerës së bilancit.

Për vitin 2018, bazuar në aktin e rakordimit midis drejtorit ekonomik dhe specialistes së të ardhurave znj. L. B., më 31.12.2018 kjo llogari ka qenë në vlerën 7,757,940 lekë.

Në pasqyrat financiare të vitit 2018 është paraqitet e njëjta vlerë si në aktin e rakordimit.

Për saktësinë e llogarisë 31, 32 dhe 35 u auditua ditari i magazinës, libri i magazinës, si dhe u bënë sondazhe me përzgjedhje për fletëhyrjet dhe fletë daljet e magazinës. Daljet nga magazina janë të shoqëruara me urdhër dalje, me kërkesë për mallin, fletëdaljet janë të firmosura nga përgjegjësi material dhe marrësi në dorëzim.

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2.

Ndikimi/Efekti: Mos paraqitje e saktë e vlerës së llogarisë 35- Mallra në pasqyrat financiare

Shkaku: Mos zbatim i kërkesave ligjore për pasqyrat financiare

Rëndësia: E ulët

Titulli i Gjetjes Mos kontabilizim i plotë i vlerës së debitorëve dhe mos paraqitje e saktë e kësaj vlere në pasqyrat financiare.

Situata: **Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”** në pasqyrat financiare të vitit 2019, ka vlerën **86,504,128** lekë. Kjo llogari përfaqëson të drejtat për debitorë për 378 subjekte debitorë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në debi të saj janë debitorët për tatim taksat lokale në shumën 8,619,354 lekë, si dhe diferencë për 73,085,749 lekë janë debitori i lënë nga KLSH, 1,670,300 lekë janë debitorë në kopshte dhe çerdhe dhe 3,129,063 lekë janë debitor të letrave me vlerë, lista analitike e të cilëve jepet ne aneksin nr. 3/1 në fund të raportit përfundimtar të auditimit. Vlera e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore për vitin 2019 prej 8,619,354 lekë, nuk shpreh vlerën reale të këtyre detyrimeve, pasi nga sektori i taksave dhe tarifave vendore në datën 31.12.2019 raportohet një vlerë prej **47,459,984 lekë** nga taksapaguesit privat dhe

familjar.

Për vitin 2018 **Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”** ka vlerën 81,246,155 lekë. Ka të njëjtën përbërje analitike si në vitin 2019, por krahasuar me vitin 2019 kjo llogari është 5,258,011 lekë më të ulët, e cila përfaqëson detyrimet e lëna nga raporti i KLSH, për arsye se kjo vlerë është kontabilizuar në vitin 2019.

Si për vitin 2019 dhe për vitin 2018 kjo llogari ka listën e saj analitike, por nuk rakordon me vlerat e taksave dhe tarifave vendore

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2.

Ndikimi/Efekti: Mos kontabilizimi i debitorëve krijon premise për humbje të gjurmës së detyrimit dhe nuk jep informacion të saktë në pasqyrat financiare për përdoruesit e tyre.

Shkaku: Mos zbatim i kërkesave ligjore lidhur me kontabilitetin dhe pasqyrat financiare

Rëndësia: I lartë

Rekomandim Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me sektorin e taksave dhe tarifave vendore të marrë masa për kontabilizimin e vlerës së plotë të debitorëve ndaj njësisë vendore.

II. Aktivet Afatgjata

Titulli i Gjetjes Mos paraqitje e saktë e vlerës së llogarisë 202 dhe kërkimeve dhe llogarisë 203 dhe koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashmeve në pasqyrat financiare të vitit 2019

Situata: Llogaria 202 dhe kërkimeve, në pasqyrat financiare të vitit 2018 ka vlerën **42,028,503 lekë**, ndërsa në pasqyrat financiare të vitit 2019 ka vlerën 35,724,228 lekë. Diferenca prej 6,304,275 lekë vjen për arsye të llogaritjes së amortizimit gjatë vitit 2019 për këto aktive, vlerë kjo që është pasqyruar në tabelën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (formati 7), pjesë e pasqyrave financiare të vitit 2019. Edhe pse gjatë vitit 2019 janë kryer investime për të cilat ka projekte përkatëse, për këtë vit nuk ka shtesa të vlerës së kësaj llogarie, sipas tabelës së mëposhtme:

Emertimi i projektit	OE Dhurues	Viti kur është kryer investimi	Data e dhurimit sipas projektit	Dokumentimi me të cilin është bere akti	Vlera e projektit sipas dhuruesit	Kontabilizuar ose jo vlera e projektit
Sistemi asfaltim lagjes Llixha-Banje, NjA Peshkopi, Bashkia Dibër	T. shpk & E. shpk	2019	Nuk ka datë	nuk ka dokument	12 185 494	jo
Sistemi asfaltim i rruges se Fshatit Melan, NjA Melan, Bashkia Diber	Z. M.	2019	Nuk ka datë	nuk ka	26 302 828	jo
ëNdërtim i Shkolles 9-vjeçare, Fshati Kërçisht, Bashkia Dibër, 2019	Z. M.	2019	Nuk ka datë	nuk ka	53 462 599	jo
Shuma					91,950,921	

Për vitin 2019, për tre investime, projektet nga njësia vendore në vlerën totale 91,950,921 lekë, nuk janë siguruar nëpërmjet zhvillimit të procedurës së prokurimit publik, por nëpërmjet dhurimeve nga shoqëri private, për të cilat nuk është hartuar dokumentacion (akt dhurimi etj.), midis njësisë vendore dhe hartuesit të projektit.

Gjithashtu nuk është hartuar kontratë midis tyre , në të cilën duhet të përcaktoheshin të drejtat dhe detyrimet kontraktuale, përgjegjësitë e projektuesit për projektin e dhuruar. **Nga njësia vendore vlera e mësipërme e tre projekteve prej 91,950,921 lekë, nuk është e kontabilizuar as në llogarinë e projektit as në llogarinë e investimit, në rastin kur ky ka përfunduar.**

Në këtë llogari në mënyrë të gabuar me rregullat e kontabilitetit, përfshihet edhe vlera e 61 projekteve dhe dy supervizimeve në vlerën totale 41,379,137 lekë, që i përkasin periudhës përpara vitit 2018 (viti 2009 e në vazhdim). Investimet me të cilat lidhen projektet dhe supervizimet e mësipërme kanë qënë të përfunduara përpara datës 31.12.2019 (shumisa shumë kohë përpara vitit 2019), dhe për këtë arsye **vlera 41,379,137 lekë nuk duhet të ishte pjesë e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”**, por duhet të ishte bërë pjesë e vlerës së objektit me të cilin lidhet projekti, menjëherë pas përfundimit dhe marrjes së tij në dorëzim. Edhe pse gjatë vitit 2019 janë kryer investime për të cilat ka projekte përkatëse, për këtë vit nuk ka shtesa të vlerës së kësaj llogarie. Projektet të cilat janë marrë pa pagesë nga njësia vendore nuk janë vlerësuar me komision nga njësia vendore dhe për to nuk ka akt dhurimi apo dokument tjetër midis njësisë vendore dhe subjektit hartues i projektit.

Lista e projekteve të llogarisë 202 òStudime dhe kërkimeò, paraqitet në aneksin nr.3/2 në fund të raportit përfundimtar të auditimit.

Llogaria 203 “Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashmeò në 31.12.2019 ka vlerën neto 12,207,842, ndërsa për vitin 2018 ka vlerën neto 14,362,167 lekë. Kjo llogari për vitin 2019 është ulur me vlerën 2,154,325 lekë, për arsye të amortizimit të akumuluar në vlerën 2,154,325 lekë (amortizimi është llogaritur drejt, në vlerën 15%, në përputhje me Udhëzimin Nr. 8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò).

Shtesat në vitin 2019 janë 0 lekë.

Konstatohet se në këtë llogari bëjnë pjesë 14 projektet që janë hartuara nga firmat private për investimet që janë kryer në Bashkinë Dibër. Nga 14 projektet e mësipërme 9 prej tyre, në vlerën 6,503,594 lekë ju përkasin investimeve të cilat kanë përfunduar përpara datës 31.12.2019, por vlera e këtyre projekteve nuk është bashkuar me vlerën e investimeve.

Lista e 14 projekteve në vlerën 14,362,167 lekë, të llogarisë 203 òKoncesione, Patenta, Licenca e të ngjashmeò, në përbërje të së cilës janë edhe nëntë projektet me vlerë 6,503,594 lekë , paraqitet në aneksin nr.3/3 në fund të raportit përfundimtar të auditimit.

Kriteri:	Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, nenin 7, 9, 10, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 òPër përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabëlò, Kap. II.
Ndikimi/Efekti:	Pasqyrat financiare për dy llogaritë e mësipërme nuk pasqyrojnë vlerën e duhur duke mos dhenë informacion të saktë për përdoruesit e tyre.
Shkaku:	Mos zbatim i kërkesave ligjore lidhur me kontabilitetin dhe pasqyrat financiare
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim	Drejtoria ekonomike të bëjë sistemimin e llogarisë 202 òStudime dhe kërkimeò, si dhe të llogarisë 203 òKoncesione, Patenta, Licenca e të ngjashmeò.

Titulli i Gjetjes Mos kryerje e procesit të inventarizimit për aktivet e trupëzuara të llogarive: 210 -Toka, troje, terrene, 211 òPyje kullota plantacione, 212 -Ndërtesa e Konstruksione, 213 -Rrugë, rrjete, vepra ujore, si dhe mos llogaritje e saktë e normës së amortizimit për llogarinë 214 -Instalime teknike, makineri e pajisje.

Situata: **Llog. 210 -Toka, troje, terrene,** për vitin 2019 dhe 2018 ka vlerën 28,394,404 lekë, pa ndryshime nga viti i mëparshëm dhe përbëhet vetëm nga dy asete:

Nr.	Emertimi	Llog.ekonomike	Vlera
1	Shpronësim Trualli Shkolla e Mesme + Konvikti	2010000	27,500,000
2	Shpronësim rruge për tek gjimnazi i ri	2010000	894,404
Totali			28,394,404

Në këtë llogari nuk janë përfshirë tokat, trojet dhe terrenet që njësia vendore ka në fakt si pasuri të saj, duke përfshirë edhe ish komunat, të cilat janë transferuar me VKM të posaçme në këtë njësi vendore. Njësia vendore nuk ka një listë përfundimtare të pronave në formën e regjistrit të aktiveve, sipas kërkesave të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò. Për mos kontabilizimin e të gjithë pasurisë për toka, troje, terrene kjo llogari nuk pasqyron vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore.

Komisioni i inventarizimit nuk është shprehur për këtë vlerë, pra nuk ka kryer inventarizim të këtyre aseteve.

-Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione” për vitin 2019 dhe 2018 ka vlerën 1,268,000 lekë, pa ndryshime nga viti i mëparshëm dhe përbëhet vetëm nga aktivi me emërtimin òfidanë dekorativò.

Nr.	Emërtimi	NJA	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Fidana dekorativ	Peshkopi	copë	180	1,500	270,000
2	Fidana dekorativ	Peshkopi	copë	200	2,000	400,000
3	Fidana dekorativ	Peshkopi	copë	200	2,000	400,000
4	Fidana dekorativ vjeshte	Peshkopi	copë	40	2,000	80,000
5	Fidana dekorativ Bline	Peshkopi	copë	30	2,000	60,000
6	Fidana dekorativ Panje	Peshkopi	copë	20	2,000	40,000
7	Fidana dekorativ Gledicje	Peshkopi	copë	10	1,800	18,000
TOTALI						1,268,000

Në këtë llogari nuk janë përfshirë pyje kullota plantacione që njësia vendore ka në fakt si pasuri të saj, duke përfshirë edhe ish komunat, të cilat kanë kaluar në pronësi të njësisë vendore me VKM nr 433, dt.08.06.2016 òPër transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në Administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkiveò, sipërfaqet pyjore dhe kullosore, sipas listës së inventarit, që transferohen në pronësi të Bashkisë Dibër, janë sipas shtojcës 6, bashkëlidhur këtij vendimi, e cila përmban listën e

inventaritet që fillon me numrin rendor 1 (një) deri 2 327 (dy mijë e treqind e njëzet e shtatë).

Në bazë të këtij vendimi Bashkia Dibër ka në pronësi të saj një sipërfaqe totale prej **36662** ha nga të cilët 25351 ha janë pyje; 5412 ha kullota, 534 ha sipërfaqe me bimësi pyjore, 3417 ha sipërfaqe inproduktive, 1889 ha sipërfaqe djerr dhe 57 ha sipërfaqe ujore.

Komisioni i inventarizimit nuk është shprehur për inventarizim të këtyre asetëve.

Llog. 212 -Ndërtesa e Konstruksione, për vitin 2019 ka vlerën 949,002,810 lekë, ndërsa për vitin 2018 ka vlerën 980,198,159 lekë. Për vitin 2019 ka një zvogëlim të kësaj llogarie me një vlerë prej 31,195,349 lekë, e cila vjen për shkak të amortizimit në vlerën 49,937,652 lekë dhe shtesave (bruto) në vlerën 18,742,303. Për vitin 2018 dhe 2019 është përdorur norma e amortizimit 1%, sipas tabelës së mëposhtme, në kundërshtim me kërkesat e pikës nr.36 të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*:

Sipas bilancit

Viti	Vlera në celje	Amortizimi vjetor i celjes	Shtesa gjatë vitit 2019	Amortizimi vjetor i shtesave	Amortizimi i akumuluar	C fi
2019	980,198,159	9,801,981	18,742,303	187,423	49,937,652	9.

Pa marrë parasysh normën e gabuar të amortizimit, llogaritjet e amortizimit vjetor (shuma e amortizimit për vlerën e celjes plus shuma e amortizimit për shtesat gjatë vitit), janë bërë të gabuara, pasi nuk duhet të ishte vlera 49,937,652 lekë, por vlera 9,989,404 lekë. (9,801,981+187,4230). Në këtë mënyrë vlera neto në 31.12.2019 duhet të ishte e ndryshme nga vlera që pasqyrohet në bilanc, kjo edhe për shkak të normës 5% të amortizimit dhe jo të normës 1%.

Viti 2019

Viti	Vlera në celje	Amortizimi vjetor i celjes	Shtesa gjatë vitit 2019	Amortizimi vjetor i shtesave	Amortizimi i akumuluar	C fi
2019	980,198,159	9,801,981	18,742,303	187,423	49,937,652	9.

Viti 2018

Viti	Kosto historike	Amortizimi i akumuluar	Tepërica neto	Shtesa gjatë vitit	Kosto historike total	Amortizimi i akumuluar
2018	1,334,170,722	343,768,958	990,401,764	3,169,800	993,571,564	13,373,405

Vlera e mësipërme e llogarisë 212 për vitin 2019 përbëhet nga 211 objekte sipas listës analitike që administrojnë drejtoria e financës.

Komisioni i inventarizimit nuk është shprehur për këtë vlerë, pra nuk ka kryer inventarizim të këtyre asetëve.

Nuk ka rregjistër të aktiveve për këtë llogari.

Llog. 213 -Rrugë, rrjete, vepra ujore, për vitin 2019 ka vlerën neto 3,311,844,643 lekë, ndërsa për vitin 2018 ka vlerën neto 3,234,280,705 lekë. Për vitin 2019 kjo llogari është rritur me vlerën 77,563,938 lekë. Sipas listës analitike të mëposhtme, kjo llogari për vitin 2019 është rritur me vlerën bruto 108,450,488 lekë, ndërsa sipas pasqyrave financiare është pasqyruar vlera bruto rritëse 111,005,701 lekë. Kjo llogari është e analizuar sipas 386 objekteve sipas listës analitike që administrojnë drejtoria ekonomike.

Viti 2019

	Vlera në celje	Shtesa gjatë vitit 2019	Vlera para amortizimit	Amortizimi	Vlera neto më 31.12.2019
	3,234,280,705	111,005,701	3,345,286,406	33,441,763	3,311,844,643

Për të dy vitet 2018 dhe 2019 është përdorur norma e amortizimit 1%

Viti 2018

	Vlera në celje 2018	Shtesa gjatë vitit 2018	Vlera para amortizimit	Amortizimi	Vlera neto më 31.12.2018
	3,030,571,027	240,132,110	3,270,703,137	36,422,432	3,234,280,705

Komisioni i inventarizimit nuk është shprehur për këtë vlerë, pra nuk ka kryer inventarizim të këtyre aseteve.

Nuk ka regjistër të aktiveve për këtë llogari.

Për vitin 2018 - Llog. 213 -Rrugë, rrjete, vepra ujore ka vlerën neto 3,234,280,705 e cila është e analizuar sipas 386 objekteve sipas listës analitike që administron drejtoria ekonomike.

Për vitin 2017 vlera e kësaj llogarie është 3,511,387,393 lekë. Në vitin 2018 ka një zvogëlim të kësaj llogarie me vlerën 277,106,688 lekë për shkak të vlerës së amortizimit.

Viti 2018: vlerat janë të sakta për këtë llogari.

Komisioni i inventarizimit nuk është shprehur për këtë vlerë, pra nuk ka kryer inventarizim të këtyre aseteve për të dy vitet.

Llog. 214 -Instalime teknike, makineri e pajisje, për vitin 2019 ka vlerën neto 89,740,024 lekë, ndërsa për vitin 2018 kjo llogari ka vlerën neto 90,349,462 lekë Viti 2019

	Vlera në celje	Shtesa gjatë vitit 2019	Vlera para amortizimit	Amortizimi mi akumuluar	Amortizimi vjetor	Amortizimi total	Vlera neto më 31.12.2019
	90,349,462	296,997	90,646,459	903,495	2,970	906,435	89,740,024

Ndryshimet midis vitit 2018 dhe 2018 janë si rezultat i vlerës së amortizimit (është përdorur norma 1% si dhe shtesave në vlerën 296,997 lekë (bruto).

Viti 2018

	Vlera në celje (neto)	Amortizimi akumuluar	Teprica neto në 31.12.2018
	98,971,939	8,622,477	90,349,462

Për vitin 2018 dhe 2019 është përdorur norma e amortizimit 1%, sipas tabelës, në kundërshtim me kërkesat e pikës nr.36 të UMF nr. 8 datë 9.03.2018.

Kriteri:

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, VKM nr. 248, datë 10.04.1998 òPër miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001, UMF nr. 14, datë 28.12.2006 òPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë i ndryshuar, UMF nr. 8 datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme

Ndikimi/Efekti: Mungesa e regjistrimit të aktiveve për aktivet afatgjata të trupëzuara, si dhe mos kryerja e procesit të inventarizimit, bënë që njësia vendore të mos ketë njohje të plotë mbi numrin dhe stausin e këtyre aseteve.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjor në fuqi lidhur me procesin e inventarizimit dhe hartimit të

rregjistrit të aktiveve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Të hartohet rregjistri i aseteve dhe të kryhet inventarizimi i tyre për llogaritë e mësipërme.

Llog. 218 –Inventar ekonomik për vitin 2019 ka vlerën neto 133,553,869 lekë, ndërsa për vitin 2018 kjo llogari ka vlerën neto 36,839,405 lekë. Për vitin 2019 kjo llogari është rritur në vlerën 96,714,464 lekë. Është përdorur norma 3% e amortizimit.

Viti 2019 sipas bilancit

4,037,051

Viti	Vlera neto në celje (31.12.2018)	Amortizimi vjetor i celjes	Shtesa gjatë vitit 2019	Amortizimi vjetor i shtesave	Amortizimi vjetor total	Gjendja në fund
2019	36,839,405	1,105,182	100,751,515	3,022,545	4,037,051	133,553,869

Si duhej

Viti	Vlera neto në celje (31.12.2018)	Amortizimi vjetor i celjes	Shtesa gjatë vitit 2019	Amortizimi vjetor i shtesave	Amortizimi vjetor total	Gjendja në fund
2019	36,839,405	1,105,182	100,751,515	3,022,545	4,127,728	133,463,193

Bazuar në të dhënat e pasqyruara në pasqyrat financiare, vlera neto më 31.12.2019 duhet të jetë 133,463,193 lekë dhe jo 133,553,869 lekë, sa pasqyrohet në bilanc. Ka një shtesë në bilanc në vlerën 90,676 lekë e pa argumentuar.

Njësia vendore administron listat analitike të kësaj llogarie.

Nuk ka paksime të kësaj llogarie as për vitin 2018 dhe as për vitin 2019.

- *Llogaria 230 “Aktive afatgjata jo materiale*ö, në pasqyrat financiare të vitit 2019 ka vlerën 11,223,596 lekë, ndërsa në vitin 2018 ka vlerën 10,366,453 lekë. Nga subjekti nuk u paraqitën lista analitike për të argumentuar vlerën e kësaj llogarie në bilan për të dy vitet.

- *Llogaria 231 “Aktive afatgjata materiale*ö, në pasqyrat financiare të vitit 2019 ka vlerën 215,232,725 lekë, ndërsa në vitin 2018 ka vlerën 208,696,494 lekë. Nga subjekti nuk u paraqitën lista analitike për të argumentuar vlerën e kësaj llogarie në bilan për të dy vitet.

Llogaria 4342 -Te tjera operacione me shtetin debitor (të drejtat e njësisë vendore), në pasqyrat financiare të vitit 2018, ka vlerën 228,379,043 lekë, me një zvogëlim prej 80,966,090 lekë, krahasuar me vitin 2017. Vlera e kësaj llogarie përbëhet **por nuk është e njëjtë** me shumën e llogarisë 401-408 öFurnitorë e llogari të lidhura me toö, në vlerën 47,000 lekë, llogarisë 42 öPersoneli e llogari të lidhura me to/ Detyrime ndaj personelitö, në vlerën 38,392,630 lekë, llogarisë 431 öDetyrime ndaj Shtetit për tatim-taksaö, në vlerën 4,006,888 lekë, llogarisë 435 öSigurime shoqëroreö, në vlerën 11,712,099 lekë, llogarisë 436 öSigurime shëndetësoreö, në vlerën 1,097,480 lekë, llogaria 467 Kreditorë të ndryshëmö, në vlerën 311, 619, 238 lekë. Vlera totale e 6 llogarive të mësipërme pasive është 366,875,335 lekë, e cila nuk është e njëjtë me llogarinë ökundërpartitö 4342 Te tjera operacione me shtetin debitor në aktiv të bilancit. Diferenca midis këtyre llogarive për vitin 2018 është 138,496,292 lekë, me e madhe në pasiv, e pa pasqyruar në aktivin e bilancit.

Llogaria 486 –“Shpenzime te periudhave te ardhshme”, në pasqyrat financiare të vitit 2019 ka vlerën **288,500,272 lekë**. Kjo vlerë përfaqson vlerën e detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve, të cilat janë të pafinancuara nga njësia vendore për shkak të mungesës së fondeve dhe përbëhen nga detyrimet sipas të dhënave të tabelës së mëposhtme:

Kjo llogari është paraqitur në përputhje me kërkesat e UMF nr.8, datë 9.3.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pika 42.

Vlera e detyrimeve të prapambetura në pasqyrat financiare rakordon me vlerën e listës së detyrimeve të prapambetura të rakorduar midis njësisë vendore dhe degës së thesarit Dibër.

Llogaria 486 – “Shpenzime te periudhave te ardhshme”, në pasqyrat financiare të vitit 2018 ka vlerën **311,619,238 lekë**. Kjo vlerë përfaqëson vlerën e detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve, të cilat janë të pafinancuara nga njësia vendore për shkak të mungesës së fondeve dhe korespondon me vlerën e detyrimeve të prapambetura sipas rakordimit me degën e thesarit.

Inventarizimi vjetor i aktiveve

Për inventarizimin vjetor të aktiveve për vitin 2019, ka dalë urdhri nr.210, datë 02.10.2019 i titullarit të Bashkisë Dibër për ngritjen e komisionit të inventarizimit fizik për vitin 2019, me përbërje si më poshtë:

Adminsitatori i Njësisë Administrative, kryetar komisioni

Punonjësi i njësisë Administrative, anëtar

Drejtori i institucionit në territorin e NJA, anëtar

Për inventarizimin vjetor të aktiveve për vitin 2019, ka dalë urdhri nr.266, datë 20.11.2019 i titullarit të Bashkisë Dibër për ngritjen e komisionit të inventarizimit fizik për vitin 2019, me përbërje si më poshtë:

Drejtori i Drejtorisë, kryetar komisioni

Specialist i drejtorisë, anëtar

Specialist i inventarëve në Bashkinë Dibër, anëtar

Urdhrat e titullarit duhet të përmbajnë emra konkret dhe jo vetëm detyrën funksionale të punonjësit që caktohet në komisionin e inventarizimit.

Bazuar në fletët e inventarizimit të aktiveve të firmosura nga komisioni i inventarizimit dhe përgjegjësi material, nga komisioni nuk janë konstatuar mangësi aktivesh gjatë këtij procesi. Nuk janë nxjerrë aktive jashtë përdorimit për vitin 2019 por nga ana e titullarit të institucionit është ngritur urdhri me nr.40 datë 24.01.2020 për krijimin e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të pajisjeve kompjuterike, për të gjitha pajisjet kompjuterike që kanë sjellë në inventarët e vitit 2018 dhe fizikisht sipas urdhrit nr.140 datë 26.07.2018, me llogarinë ekonomike 02186000, ku nga ana e komisionit janë propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit inventarë në vlerën 3,506,442 lekë sipas raporteve të vlerësimit dhe proces-verbalet të konstatimit jashtë përdorimit në institucione të ndryshme në përbërje të bashkisë, të nënshkruar nga komisioni i ngritur me urdhër të kryetarit të Bashkisë nr. 140, datë 26.07.2018 për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të njësisë për vitin 2018, të cilat janë miratuar me vendim të këshillit bashkiak Dibër nr.180 datë 26.12.2019, konfirmim të institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër me nr.31/1 prot. datë 08.01.2020.

Inventarët e miratuar për nxjerrje jashtë përdorimit, në shumën totale për 13,567,640 lekë sipas llogarive përkatëse, janë si më poshtë vijon:

Llogaria 215 për vlerën 10,061,198 lekë,

Llogaria 218 për vlerën 3,506,442 lekë,

Inventarët e propozuar dhe të miratuar për dalje jashtë përdorimi nuk e kanë përfunduar procesin e plotë sipas Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30 datë 27.12.2011 për

menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, duke mos ngritur urdhrat për përfundimin e procesit përfundimtar të daljes jashtë përdorimit, për të cilën ng

Për anomali të e konstatuara në pasqyrat financiare ngarkohen me përgjegjësi zni. V. K. me detyrë përgjegjëse e financës, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare.

Testimi i llogarive kreditor 2019.

Për saktësinë e plotësisë së llogarive kreditor, u testuan pagesat nga banka në tremujorin e dytë të vitit 2020, për të verifikuar nëse janë kontabilizuar si detyrime të gjitha detyrimet (faturat) e prera në periudhën deri më datën 31.12.2019 por të paguara në vitin 2020. Konkretisht nga verifikimi rezultoi si vijon:

-Me urdhër shpenzimit nr. 348 datë 13.05.2020 është paguar subjekti òS.ò sh.p.k në shumën 8,769,037 lekë për punime të kryera, nga të cilat 5% garanci punimesh në vlerën 461,528 lekë. Bashkëngjitur është fatura tatimore nr. 10, datë 31.10.2019, me numër serial 77959460 për vlerën 19,230,565 lekë referuar situacionit të shpenzimeve.

Situacioni datë 31.10.2019 për vlerën 19,230,565 lekë mbi: òSistemim asfaltim i rrugës së fshatit Melan, Bashkia Dibër, viti 2019. Prokurim me procedurë të hapur. Akti i marjes në dorëzim të objektit datë 28.02.2020. Akti i kolaudimit është më datë 28.02.2020. ***Detyrimi është pasqyruar në llogaritë kreditor.***

-Me urdhër shpenzimit nr. 349 datë 13.05.2020 është paguar subjekti òR.ò sh.p.k në shumën 1,445,394 lekë për punime të kryera. Bashkëngjitur është fatura tatimore nr. 02, datë 01.04.2019, me numër serial 74524502 për vlerën 1,445,394 lekë referuar situacionit të shpenzimeve.

Situacioni datë 01.06.2017 për vlerën 1,445,394 lekë mbi: òRikonstruksion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse Nja Maqellarë, Melan, Muhurr, Tomin, Bashkia Dibër. Prokurim me procedurë të hapur. Akti i marjes në dorëzim të objektit datë 30.12.2017. Akti i kolaudimit është më 01.06.2017. ***Detyrimi është pasqyruar në llogaritë kreditor.***

-Me urdhër shpenzimit nr. 416 datë 18.05.2020 është paguar subjekti òE.ò sh.p.k në shumën 2,850,000 lekë për punime të kryera, nga të cilat 5% garanci punimesh në vlerën 150,000 lekë. Bashkëngjitur është fatura tatimore nr. 84, datë 10.10.2018, me numër serial 64436584 për vlerën 5,849,225 lekë referuar situacionit të shpenzimeve.

Situacioni përfundimtar datë 10.10.2018 për vlerën 3,000,000 lekë mbi: òPunime, mirëmbajtje, ndërtim dhe rehabilitim të kanaleve ujitëse në Bashkinë Dibër. Prokurim me procedurë të hapur. Akti i marjes në dorëzim të objektit datë 27.11.2018. Akti i kolaudimit është më 12.09.2018. ***Detyrimi është pasqyruar në llogaritë kreditor.***

-Me urdhër shpenzimit nr. 352 datë 13.05.2020 është paguar subjekti òS. V.ò, me nipt-L.....U në shumën 4,952,000 lekë për òBlerje dru zjarri për nevojat e Bashkisë Dibër për vitin 2019. Bashkëngjitur është fatura tatimore nr. 07, datë 08.11.2019 për vlerën 8,952,000 lekë referuar situacionit të shpenzimeve që ka kaluar në vlerën 4,952,000 lekë.

Prokurim me vlerë të hapur. Akti i marjes në dorëzim të objektit datë 06.11.2019. ***Detyrimi është pasqyruar në llogaritë kreditor.***

-Me urdhër shpenzimit nr. 418 datë 20.05.2020 është paguar subjekti òR. sh.p.kò, me nipt-J.....D në shumën 853,333lekë për òHidroizolimi i tarracave te objekteve arsimore dhe social-kulturore, viti 2018. Bashkëngjitur është fatura tatimore nr. 05, datë 01.04.2019 për vlerën 853,333 lekë referuar situacionit të shpenzimeve që ka kaluar në vlerën 853,333 lekë.

Prokurim me vlerë të vogël. Akti i marjes në dorëzim të objektit datë 01.04.2019. ***Detyrimi është pasqyruar në llogaritë kreditor.***

Llogaritë e Pasivit dhe Paqyra e Cash Floë

Titulli i Gjetjes

Anomali në llogaritë e pasivit të bilancit, si dhe në pasqyrën Cash Floë

Situata:

a- Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vitin 2019ka vlerën 167,254,617 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie paraqitur nga drejtoria ekonomike kjo llogari përbëhet nga e detyrimet e njësisë vendore për 78 subjekte në vlerën 42,206,100 lekë. Pra kjo llogari në pasqyrat financiare duhet të kishte vlerën 42,206,100 lekë. Vlera prej 125,048,418 lekë është paraqitur tepër në këtë llogari. Nuk ka dokumentacion mbështetës për të justifikuar vlerën 125,048,418 lekë. Për sa më sipër kjo llogari nuk pasqyron saktë vlerën e detyrimeve që njësia vendore kandaj furnitorëve.

Më hollësisht të dhënat për detyrimet e njësisë vendore për 78 subjekte në vlerën 42,206,100 lekë, paraqiten në aneksin nr.3/5 në fund të raportit përfundimtar të auditimit.

b-Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtjeë në pasqyrat financiare të vitit 2019 është për vlerën kontabël 34,394,184 lekë, por nga auditimi konstatohet se sipas listës analitike që administron drejtoria ekonomike, kjo llogari është e analizuar sipas objekteve për 38 raste me vlerën 23,474,067 lekë. Sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Dibër (*Më hollësisht të dhënat sipas Pasqyrës bashkëngjitur*), vlera e dhënë nga ana e tyre sipas FSG nuk korrespondon me gjendjen analitike të bilancit. Kjo diferencë e pa analizuar është në vlerën 10,920,117 lekë e cila nuk ka një analizë të llogarisë 466 përpara vitit 2015 për ish komunitat, të cilave ju përket kjo vlerë sipas pretendimit të drejtorisë së financës së njësisë vendore. Sipas aktit të rakordimit me thesarin kjo vlerë është 34,394,184 lekë, por pa analizë për diferencën e cila nga njësia vendore verbalisht raportohet se janë rregjistrime në thesar nga ish komunitat.

Sipas listës analitike që administron drejtoria ekonomike, llogaria 466 *ōKreditorë për mjete në ruajtjeë*, ka vlerën 23,474,067 lekë për 38 raste, por bazuar në afatin një vjeçar të garancisë së punimeve, vlera prej 13,013,172 lekë për 33 nga rastet e mësipërme, ka plotësuar dhe tejkaluar afatin një vjeçar dhe duhet të ishte likuiduar, ose duhet të ishte përfituar nga njësia vendore nëse detyrimet kontraktuale nuk janë zbatuar nga kontraktori.

Kjo vlerë i përket periudhës 2015-2019, me përjashtim të garancisë së punimeve për një investim i cili i përket vitit 2012, në vlerën 3,269,266 lekë.

Nga njësia vendore nuk janë marrë masa për zbatimin e detyrimeve kontraktuale, për llogarinë 466 *ōKreditorë për mjetet në ruajtjeë* (garanci punimesh në masën 5% të vlerës së investimit), në kundërshtim me UMF nr. 8 datë 9.03.2018 *ōPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeë*, si dhe kushtet e kontratës të lidhur midis palëve.

Lista që administron njësia vendore për llog. 466 *ōKreditorë për mjete në ruajtjeë*, në vlerën 23,474,067 lekë për 38 raste, paraqitet në aneksin nr.3/6 në fund të raportit përfundimtar të auditimit.

c- Paqyra e Cash Floë

Për vitin 2019, shpenzimet faktike sipas FSG (aktit të rakordimit me thesarin), kanë vlerën 1,550,598,537 lekë. Nga auditimi i formatit nr. 3 (Cash Floë) të pasqyrave financiare rezulton se në bilanc është paraqitur vlera 1,557,722,987 lekë, i cila nuk rakordon me vlerën e thesarit dhe i përket vlerës së planifikuar të

shpenzimeve faktike dhe jo vlerës së shpenzuar realisht gjatë vitit 2019. Gjithashtu në këtë pasqyrë është vendosur formalisht vetëm vlera totale, pa plotësuar vlerat për shpenzimet e tjera përbërëse të totalit, duke mos shpjeguar se nga cilat shpenzime përbëhet vlera totale e shpenzimeve faktike.

Pasqyrat financiare të vitit 2019, në formatin nr. 3 (Cash Floë), pasqyrojnë një vlerë prej 7,124,450 lekë më shume se vlera e shpenzimet faktike e rakorduar me thesarin.

E njëjta situatë paraqitet edhe për vitin 2018: vlera e shpenzimeve faktike për vitin 2018 sipas aktit të rakordimit me thesarin (FSG është 1,561,455,981 lekë, ndërsa vlera e pasqyruar në formatin nr. 3 (Cash Floë) të pasqyrave financiare ka vlerën 1,530,052,003, me një diferencë prej 31,403,978 lekë më pak se faktiku.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. V. K. me detyrë përgjegjëse e financës, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare.

Kriteri:	Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, VKM nr. 248, datë 10.04.1998 òPër miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësisve që varen prej tyreò, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001, UMF nr. 14, datë 28.12.2006 òPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorò i ndryshuar, UMF nr. 8 datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò
Ndikimi/Efekti:	Pasqyrat financiare nuk japin informacion të saktë për përdoruesit e tyre.
Shkaku:	Mos zbatim i kuadrit ligjor në fuqi lidhur me hartimin e pasqyrave financiare
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Të sistemohet llogaritë: 401-408 òFurnitorë e llogari të lidhura me toò, 466 òKreditorë për mjetet në ruajtjeò, si dhe të dhënat në pasqyrën Cash Floë

D.1. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike

Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nga AK Bashkia Dibër është hartuar regjistri i parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2018, 2019 dhe 2020, i cili është raportuar në APP në sistemin elektronik si dhe në degën e thesarit. Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë më parë kërkesat nga secili sektor përfitues i mallit, punës apo shërbimit të planifikuar. Janë bërë konsultime me komunitetin për përparësinë e investimeve. Vlerat dhe objektet e prokurimeve janë të parashikuara në buxhetin vjetor dhe të miratuara me vendimet përkatëse të këshillit bashkiak.

Nuk ka shpenzime shumë vjeçare. Për sa më sipër u krahasuan vlerat e regjistrit të prokurimeve me vlerat e miratuara në buxhet për secilin prokurim. Gjithashtu u verifikua kohëzgjatja e secilit investim. Urdhrat e prokurimit janë vulosur në thesar, përpara fillimit të procedurës së prokurimit. U verifikua lista e investimeve të kryera dhe konstatohet se nuk ka angazhime buxhetore të pa miratuara në këshillin bashkiak.

Regjistri i realizimit të prokurimeve reflekton sakte prokurimet e kryera gjatë vitit.

Për vitin 2018 janë zhvilluar 20 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 74,532,288 lekë, me vlerë të shpalljes së fituesit 70,559,058 lekë, diferencë midis tyre prej 2,362,141 lekë. Për këtë vit, së bashku me zbatimin e kontratave të punimeve janë

audituar 6 procedura prokurimi në vlerën e fondit limit 40,010,234 lekë dhe vlerën e shpalljes së fituesit 38,809,890 lekë.

Procedurat e audituara përbëjnë 30% të numrit të procedurave të zhvilluara, ose 55% të vlerës së kontratave të lidhura për vitin 2018 për punë, mall dhe shërbim.

Nga procedurat e audituara pesë prej tyre i përkasin zhvillimit të procedurës, ndërsa një i përket zbatimit të kontratave të punimeve, në vlerën e kontratës prej 5,464,088 lekë.

Për vitin 2019 janë zhvilluar 19 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 136 921434 lekë, me vlerë të shpalljes së fituesit 121,344,107 lekë, diferencë midis tyre prej 15 577 327 lekë. Për këtë vit, së bashku me zbatimin e kontratave të punimeve janë audituar 8 procedura prokurimi në vlerën e fondit limit 119,278,268 lekë dhe vlerën e shpalljes së fituesit 105,107,217 lekë.

Procedurat e audituara përbëjnë 42% të numrit të procedurave të zhvilluara, ose 87% të vlerës së kontratave të lidhura për vitin 2019 për punë, mall dhe shërbim.

Nga procedurat e audituara të gjitha i përkasin zhvillimit të procedurës, po ashtu në dy prej tyre është audituar edhe zbatimi i kontratës të punimeve, në vlerën e kontratës prej 25,247,693 lekë.

Për vitin 2020 janë zhvilluar 6 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 237,792, 340 lekë, me vlerë të shpalljes së fituesit 233,821,573 lekë, diferencë midis tyre prej 3,970,766 lekë. Për këtë vit janë audituar 3 procedura prokurimi në vlerën e fondit limit 225,825,399 lekë dhe vlerë të shpalljes së fituesit 222,600,517 lekë.

Procedurat e audituara përbëjnë 50% të numrit të procedurave të zhvilluara, ose 95% të vlerës së kontratave të lidhura për vitin 2020 për punë, mall dhe shërbim.

Nga procedurat e audituara për vitin 2020, të gjitha i përkasin zhvillimit të procedurës, nuk ka zbatim të kontratave të punimeve të audituara për këtë vit.

Përmbledhje për të gjithë periudhën e audituar. Referuar të dhënave të regjistrimit të realizimit të prokurimeve dhe SEP për periudhën objekt auditimi, nga data 01.01.2018 deri në datën 30.06.2020, konstatohet se janë zhvilluar 45 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 449,246,062 lekë, me vlerë të shpalljes së fituesit 425,724,738 lekë, diferencë midis tyre prej 21,910,235 lekë. Procedura të llojit tender i hapur 7 procedura, procedura të llojit kërkesë për propozim 37 dhe 1 procedurë me negociim pa shpallje paraprake.

Nga 45 procedura prokurimi të zhvilluara, së bashku me zbatimin e kontratave të punimeve janë audituar 17 procedura, me vlerën e fondit limit 385,113,901 lekë, me vlerë të shpalljes së fituesit 366,517,624 lekë. Kjo do të thotë se në aspektin numerik janë audituar (edhe zbatimi) 38% e procedurave të zhvilluara, ose 86% të vlerës së fondeve për të cilat është lidhur kontratë ($366,517,624/425,724,738 * 100$).

Përsa i përket vetëm zhvillimit të procedurës së prokurimit publik, për të gjithë periudhën 01.01.2018 deri më 30.06.2020, janë audituar 16 procedura, me vlerë të fondit limit 353,040,298 lekë, me vlerë të shpalljes së fituesit 341,269,931 lekë, në aspektin numerik 36% e procedurave të zhvilluara, ose 80% të vlerës së fondeve për të cilat është lidhur kontratë.

Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik nga grupi i auditimit janë konstatuar anomali si në hartimin e kritereve të veçanta të DST, ashtu edhe në vlerësimin e ofertave. Këto anomali janë grupuar sipas natyrës së tyre të cilat gjejnë pasqyrim në trajtimin e mëposhtëm.

I. Mos argumentim i kritereve të veçanta të DST.

Për periudhën e auditimit janar 2018-Dhjetor 2019, u konstatua se në pesë procedura prokurimi (dy prej të cilave janë zhvilluar në vitin 2018 dhe tre në vitin 2019), nga njësia e prokurimit nuk është bërë në mënyrë të plotë argumentimi i kritereve të veçanta të vendosura në DST. Të dhëna për procedurat si vijon:

Titulli i Gjetjes Për periudhën e auditimit janar 2018-qershor 2020, u konstatua se në shtatë procedura prokurimi (dy prej të cilave janë zhvilluar në vitin 2018, tre në vitin 2019 dhe dy në vitin 2020), nga njësia e prokurimit nuk është bërë në mënyrë të plotë argumentimi i kritereve të veçanta të vendosura në DST.

Situata:

1. Procedura e prokurimit me objekt “Punime ndërtimi, rehabilitim, rikonstruksion, mirëmbajtje e rezervuarëve dhe kanaleve ujitëse, Bashkia Diber”, me vlerë të fondit limit 9,992,079 lekë, zhvilluar në datën 23.05.2018.

Argumentimi i FL, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivave është bërë bazuar mbi Urdhrin nr. 11, datë 21.03.2018 nga komisioni i përbërë: R. Z., F. M. dhe O. R.. Nga auditimi me zgjedhje i disa zërave të preventivit konstatohet se çmimi i përcaktuar nga AK përputhet me çmimin sipas manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit për vitin 2015, sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015.

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, ÷Zhvillimi i procedurave, pika 2, ÷Hartimi i dokumenteve të tenderit, në të cilën përcaktohet se: ÷Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato.

Nga auditimi rezulton se, në te gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

”Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP: z. F. K. me detyrë ish-përgjegjës sektori i prokurimeve, znj. I. S. me detyrë specialiste prokurimesh, z.N. S. me detyrë specialist i administrimit te regjistrimit.

2. Procedura e prokurimit me objekt “Rehabilitim i Ambienteve te jashtme te Shkollës se Mesme Maqellare, me vlerë të fondit limit 3,538,477 lekë, zhvilluar në datën 31.10.2018.

Preventivi është hartuar nga ing. E. S.. Nga auditimi me zgjedhje i disa zërave të preventivit konstatohet se çmimi i përcaktuar nga AK përputhet me çmimin sipas manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit për vitin 2015, sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015.

Hartuesi i preventivit rezulton dhe anëtar i KVO gjë e cila bie ndesh me kërkesat e VKM nr. 914, dt 29.12.2014 ÷Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të Ndryshuar, neni 58 ku përcaktohet se: *Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.*

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK z. M. R..

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me

Kreu V, ÷Zhvillimi i procedurave, pika 2, ÷Hartimi i dokumenteve të tenderit, në të cilën përcaktohet se: ÷Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato.

Nga auditimi rezultoi se, në të gjitha kriteret e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre por janë mjaftuar vetëm me vendosjen e nenit 26 të VKM nr. 914 si referencë ligjore pa dhënë argumentime teknike mbi përzgjedhjen e atyre kriteret siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP: z. F. K. me detyrë ish-përgjegjës sektori i prokurimeve, znj. I. S. me detyrë specialiste prokurimesh, z.N. S. me detyrë specialist i administrimit të regjistrimit.

3. Procedura e prokurimit me objekt “Ndërtim i Shkollës 9-vjeçare, Fshati Kërçisht, Bashkia Dibër, 2019”, me vlerë të fondit limit 44,552,166 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 02.12.2019.

Nga titullari i AK Z. D. I., ka dalë urdhri i prokurimit nr. 36/4, datë 23.09.2019, me nr. 36/11 prot, në të cilin është përcaktuar njësia e prokurimit e përbërë nga z.F. K., me detyrë përgjegjës sektori të prokurimeve (personi përgjegjës për prokurimin, sipas nenit 57 të VKM 914), me arsim të lartë juridik, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 13.03.2019, me urdhrin nr. 92, datë 19.03.2019, znj. I. S., me detyrë specialiste e prokurimeve, me arsim të lartë juridik, z. A. C., me detyrë përgjegjës i sektori të mbrojtjes së mjedisit, me arsim të lartë inxhinier mjedisi.

Në dosjen e tenderit ndodhet dokumenti me lëndë: Mbi ndarjen e detyrave, i datës 23.09.2020, me nr.36/15 prot., të hartuar nga titullari i AK, z. D. I.. Në këtë dokument janë përcaktuar nga titullari detyrat e secilit anëtar të njësisë së prokurimit, konkretisht detyra e përgatitjes së kriteret të kualifikimit është përcaktuar për z. F. K.. Mbështetur në këtë urdhër dhe në ndarjen e detyrave, anomalitë e mëposhtme, të konstatuara në hartimin e kriteret të DST janë përgjegjësi e z. F. K., pasi dy anëtarët e tjerë janë ngarkuar me detyra të tjera të cilat nuk kanë lidhje me formulimin e kriteret të DST.

- Nga auditimi i procesverbalit të për argumentimin e kriteret të DST, konstatohet se kriteret e vendosura nuk janë argumentuar. Argumentimi i dhënë në këtë procesverbal ka thjeshtë të përmendur bazën ligjore e cila i jep të drejtën AK të kërkojë dokumentacion lidhur me aftësitë ekonomike, profesionale, teknike etj, por secili kriter që është vendosur në DST nga AK duhet të argumentohet, përse kërkohet një certifikatë e caktuar, me cilin zë të punimeve ka lidhje, përse kërkohet një makineri e caktuar dhe me një kapacitet të caktuar (dhe jo më të vogël, apo më të madh), me cilin zë të punimeve ka lidhje, apo çfarë argumenti ka numri i makinerive me afatin e kryerjes së punimeve. Pra të gjitha kriteret nuk janë të shoqëruara me argumente të tilla, lidhur me natyrën dhe vlerën e objektit të prokurimit konkret, elementët e preventivit, kohëzgjatjen kontratës, etj.

Në pikën 2.2.4 të kriteret të veçanta të DST është kërkuar numri mesatar i punonjësve prej 52, por ky numër është i pa argumentuar. Gjithashtu nuk është argumentuar as profesioni i kërkuar për punonjësit. Numri i punonjësve dhe profesioni i tyre, duhet të argumentohet bazuar në elementët e preventivit, natyrën e proceseve të punës, kohëzgjatjen e punimeve etj.

Po në këtë pikë është kërkuar ÷Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Janar 2019 ó deri në datën e zhvillimit të tenderit. Afati deri në datën e zhvillimit të tenderit, është kërkuar

për të gjitha kriteret e vendosura në DST është i pa mundur për tu plotësuar nga OE. Ky afat mund të përcaktohet deri në muajin e mbyllur përpara zhvillimit të tenderit.

- Në pikën 2.2.7 të kriterëve të veçanta të DST është kërkuar: operatori ekonomik ofertues duhet të ketë ne pronësi apo me kontrate qiraje të specifikuar për objektin e prokurimit pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (janë listuar makineritë e kërkuara). Në këtë pikë, përveçse mjetet e kërkuara nuk kanë argumentim një për një (ku kërkesa për secilin mjet duhet të lidhet me zërin konkret të preventivit).

Është kërkuar edhe një rimorkiator, për të cilin bazuar në preventivin e objektit të prokurimit, gjykojmë nuk ka arsye për kërkesën e një mjeti të tillë.

- Në pikën 2.2.3 të kriterëve të veçanta të DST është kërkuar Certifikata ISO: OHSAS 18001-2007 dhe certifikata PAS 99:2012 dhe ISO 45001-2018 të cilat kanë të njëjtin përshkrim, pra funksion, qëllim, por në DST janë bërë përshkrime të gabuara, sikur të jenë certifikata të ndryshme.

Përshkrimi i këtyre certifikatave:

• Prodhim dhe tregtimi inerteve dhe produkteve bituminoze (asfalte) për ndërtim.

Ndërtim restaurim dhe mirëmbaje e veprave civile dhe industriale (rrugë, ura, kanalizime, ujësjellës dhe punime elektrike).

Në pikën 2.2.9 të kriterëve të veçanta të DST është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratat si me poshtë:

Autoriteti Kontraktor do të pranojë dhe certifikatat ISO, sipas standardit SSH/EN, SSH/ISO, pa bërë shpjegime, pa qenë i qartë nëse këto certifikata do të zëvendësojnë mungesën e ndonjë certifikate të mësipërme apo janë shtesë në kriteret e vendosura.

Po në këtë rubrikë është vendosur kriteri se: • Pajisjet objekt prokurimi që ofron operatori ekonomik janë në përputhje me direktivën 2014/68/EU për enët në presion ose ekuivalente, kriteri i cili është shtuar me ndryshimin e kriterëve të DST dhe është i pa argumentuar shtesa e këtij kriteri, se për çfarë arsye është vendosur.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z.F. K., me detyrë përgjegjës sektorit të prokurimeve, i cili është personi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të DST, bazuar në ndarjen e detyrave, datë 23.09.2020, me nr. 36/15 prot., të hartuar nga titullari i AK.

4-Procedura e prokurimit me objekt “Sistemim asfaltim i lagjes Llixha-Banje, NjA Peshkopi, Bashkia Dibër”, me vlerë të fondit limit 21,919,024 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.04.2019.

Hartimi i kriterëve të DST

Në dosje ndodhet dokumenti me nr.7/6 prot, datë 15.03.2019 : • Mbi ndarjen e detyrave, i cili është nxjerrë nga titullari i AK z. M. R.. Në këtë dokument detyra e hartimit të kriterëve të kualifikimit i është ngarkuar z. F. K..

Në datën 15.03.2019 është mbajtur procesverbal për argumentimin e kriterëve të vendosura në DST, por nga auditimi konstatohet se kriteret e kapacitetit teknik, si kërkesa për licencat profesionale, numri i punonjësve dhe profesioni i tyre, kërkesa për certifikatat ISO, numri i makinerive dhe paisjeve, nuk kanë argumentime konkrete të cilat duhet të lidhen dhe shpjegohen gjatë argumentimit, jo vetëm me bazën ligjore në fuqi që i jep të drejtën AK për të vendosur këto kriteret, por me argumentime që lidhen me zërat konkret të tenderit sipas preventivit, me afatin e punimeve etj specifika të tenderit.

Mos argumentimi i kriterëve ngarkon me përgjegjësi z. F. K., si personi i ngarkuar për

hartimin e kriterëve të DST.

5-Procedura e prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri për nevojat e Bashkisë Dibër për vitin shkollor 2019-2020”, me vlerë të fondit limit 11,250,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.06.2019.

Në dosje ndodhet dokumenti me nr.37/5 prot, datë 29.05.2019 oMbi ndarjen e detyrave, i cili është nxjerrë nga titullari i AK z. M. R.. Në këtë dokument detyra e hartimit të kriterëve të kualifikimit i është ngarkuar z. F. K..

Nuk është mbajtur procesverbal për argumentimin e kriterëve të vendosura në DST në kundërshtim me nenin 61 të VKM 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publiko pika nr.2.

Mos argumentimi i kriterëve ngarkon me përgjegjësi z. F. K., si personi i ngarkuar për hartimin e kriterëve të DST.

Për sa më sipër, për kriteret e vendosura në DST në kundërshtim me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mban përgjegjësi njësia e prokurimit, e cila është hartuese e tyre.

Kriteri:	VKM 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publiko, Neni 26- Kontrata për punë publike, pika a, pika 5, pika 6, neni 61 pika nr.1. nr.2
Ndikimi/Efekti:	Mos argumentimi i kriterëve është mos zbatim i kërkesave ligjore për hartimin e kriterëve të DST, nuk jep siguri nëse kriteret e vendosura janë ato të duhura, pasi si nevoja për numrin e punonjësve, numrin e makinerive, llojin dhe kapacitetin e tyre, nuk janë të mbështetura me argumente dhe llogaritje konkrete, sipas zërave të preventivit, afatit të punimeve, volumeve të tyre etj.
Shkaku:	Mos zbatim i kërkesave ligjore në hartimin e kriterëve të DST
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim	Në hartimin e kriterëve të DST, njësia e prokurimit të jap argumente për secilin kriter dhe këto argumente të bëhen pjesë e procesverbalit që mbahet prej saj. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin, afatin e punimeve, etj.

II. Në pesë procedura të prokurimit publik (pesë të zhvilluara gjatë vitit 2018), nga KVO janë kualifikuar operatorë ekonomikë (OE), të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, duke i propozuar titullarit të AK për shpalljen fitues të këtyre OE. Në të gjitha këto raste tenderi duhet të anulohet dhe mos kryerja e këtij veprimi ka çuar në kualifikim dhe shpallje fitues OE në mënyrë të pa drejtë, duke sjell përdorim të fondeve publike në kushtet e paligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik.

Në vijim trajtimi konkret i pesë rasteve:

Titulli i gjetjes Në gjashtë raste janë kualifikuar OE, në kushtet kur nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST. Tenderi duhet të anulohet.
1-Tenderi me objekt: “Punime ndërtimi, rehabilitim, rikonstrukcion, mirëmbajtje e rezervuarëve dhe kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër, me fond limit 9,992,079 lekë, zhvilluar më 23.05.2018.

Situata:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Punime ndërtimi, rehabilitim, rikonstrukcion, mirëmbajtje e rezervuarëve dhe kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 11/1, datë 28.03.2018 (prot nr. 11/2).	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 11/1, datë 28.03.2018	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 11/2, datë 28.03.2018, ndryshuar me Urdhër nr. 11/2/1

2. Lloji i Procedurës - “E hapurë”	z. F. K. znj. I. S. z. N. S.	datë 21.05.2018 z. E. S., Kryetar z. I. S., anëtar z. E. M., anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSH) 9,992,079 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE òE.ò me ofertë 9,678,650 Lekë me kontratë të lidhur nr 11/11 date 18.06.2018 me afat 25 ditë, amenduar me kontratën nr. 11/ë datë 27.06.2018	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 313,429 Lekë
8. Data e hapjes së tenderit Datë 23.05.2018	9. Burimi Financimit Buxheti bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK- sòka APP-òsòka KPP-sòka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----, datë -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr. ----, dt. -----

Me procesverbal nr. 1, datë 21.05.2018 është bërë hapja e procedurës në të cilën konstatohet se ka marrë pjesë e OE, sipas pasqyrës:

<i>Nr.</i>	<i>Operatorët pjesëmarrës</i>	<i>Oferta paraqitur</i>	<i>Vlerësimi i KVO</i>
1.	E.	9,678,650	Kualifikohet
2.	S. shpk	9,472,962	S'kualifikohet

Sipas këtij procesverbal nga 2 operatorët pjesëmarrës, plotëson kërkesat e DST vetëm njëri prej tyre, ku në fund fitues është shpallur shoqëria òE.ò me ofertë ekonomike 9,678,650 lekë pa TVSH.

Në dosjen e tenderit ndodhet Raporti Përmbledhës nr. 11/8 prot., i hartuar me datë 04.06.2018, ku është pasqyruar zhvillimi i procedurës së prokurimit.

Miratimi i procedurës së prokurimit dhe i fituesit është bërë me shkresën nr. 11/9 prot., datë 04.06.2018 të titullarit të Autoritetit Kontraktor, ku është shpallur fitues shoqëria òE.ò me ofertë ekonomike 9,678,650 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 11/10 prot., datë 04.06.2018 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit.

Kontrata me operatorin ekonomik të shpallur fitues është lidhur me nr. 11/11 prot., datë 18.06.2018 amenduar me kontratën nr. 11/ë prot., datë 27.06.2018 me vlerë 11,614,380 lekë me TVSH, me afat 25 ditë kalendarike nga lidhja e kontratës.

Skualifikimi i OE “S.ò ShPK është bërë pasi:

OE “S.ò ShPK, sipas DST Shtojca 11, nuk plotëson kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, konkretisht: Pika 2.3/6 , Pika 2.3/24 ,Pika 2.3/17 , Pika 2.3/12. Skualifikim i drejtë.

Nga verifikimi në dosje dhe sistemin APP, konstatohet se OE òE.ò nuk plotëson kriteret e DST, si vijon:

a-Shoqëria òE.ò, nuk plotëson kriterin 2.2.2 sipas DST pasi nuk ka paraqitur akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar për vitin 2017.

b-Shoqëria òE.ò ka mangësi në makineritë e kërkuara sipas DST dhe më konkretisht: -mungojnë ekskavator me goma, mjetet e deklaruar rezultojnë të paregjistruara dhe të pashoqëruara me leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik, dhe policë sigurimi në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Rrugor të Republikës së

Shqipërisë, Neni 1.

-mungon 1 kamionçine pasi mjeti me targë AA...DH i ka skaduar certifikata e kontrollit teknik më datë 11.10.2017.

-mungon autobot copë 2, ka ngarkuar në sistem autobot copë 1 me targë DI...A, sipas kontratës së qerasë së lidhur, por ky mjet nuk figuron në shtojcën nr. 8 mbi disponimin e makinerive, si rrjedhojë nuk merret në konsideratë.

Si përfundim nga KVO nuk duhet të ishte bërë kualifikimi i OE ðE.ö ShPK me vlerë të ofertës ekonomike 9,678,650 lekë dhe nuk duhet të kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte **anuluar tenderin**.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: z. E. S. kryetar, me detyrë ish-përgjegjës, Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Studim Projektimit, z.I. S. anëtar, specialist prokurimesh dhe z.E. M. anëtar, me detyrë specialist prokurimesh.

Për sa më sipër është bërë kundërshti nga anëtarët e KVO, nëpërmjet adresës elektronike zyrtare si dhe me shkresën nr. 3142 prot., datë 16.09.2020 protokolluar në KLSH me nr. 466/5 datë 18.09.2020, ku thuhet:

Pretendim i subjektit:

Opertori ekonomik "E." ShPK nuk ka pasur detyrimin ligjor që të ketë pasqyruar pasqyrën financiare për vitin 2017 pasi nuk plotëson 2 pika të ligjit të sipërcituar. Sepse totali i aktiveve në bilacin e vitit 2017 nuk e kalon shumë 50 (pesëdhjetë milion) lekë, dhe subjekti në fjalë nuk ka të punësuar mesatarisht 30 persona, duke u bazuar dhe në shumën totale që ka paguar për sigurime shëndetësore dhe shoqërore për të punësuarit që ka në bilacin e këtij viti që përkon në vlerën 233.910 (dyqind e tridhjetë e tre e nëntëqind e dhjetë) lekë.

Duke pasur dhe një ekspert të fushës në komisionin e vlerësimit të ofertave Z.E. S. vlerësoi për këtë procedurë prokurimi të paraqitura nga operatori ekonomik janë të mjaftueshme për realizimin e këtyre punimeve, dhe për mjetin autobot me targë DI...A me qenë se i gjithë dokumentacioni përkatës është në përputhje me kërkesat e DST dhe bashkëngjitur ka dhe kontratën e qerasë, operatori ekonomik e ka vënë në dispozicion për realizimin e këtyre punimeve.

Theksojmë që duke pasur parasysh procedurën e prokurimit në fjalë që është jetike për vaditjen e tokave bujqësore që përkon dhe me datën 18.06.2018 që është lidhur kontrata, që është tepër vonë për vaditjen e tokave bujqësore në territorin e Bashkisë Dibër duke pasur parasysh dhe ligjin Nr. 9643, DATË 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 53 pika 4. Ku citohet : Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Në observacionin e paraqitur ju nuk paraqisni prova dhe fakte të reja për sa dërguar në observacionet e akt konstatimeve të cilat janë trajtuar në Projekt raportin e auditimit. Për këtë arsye kundërshtitë tuaja nuk merren parasysh.*

2- Tenderi me objekt: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale, Bashkia Dibër, 2018", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale,

<i>Bashkia Diber, 2018</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 46/1, datë 26.09.2018 (prot nr. 46/2).	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 46/1, datë 26.09.2018 z. F. K. znj. I. S. z. N. S.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 46/2, datë 28.09.2018, z. I. S., Kryetar z. E. S., anëtar z. E. M., anëtar
2. Lloji i Procedurës - “Kërkesë për propozimë		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 5,833,333 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE òS.ò me ofertë 5,789,313 Lekë me kontratë të lidhur nr 46/14 date 19.12.2018 me afat 20 ditë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 44,020 Lekë
8. Data e hapjes së tenderit Datë 02.11.2018	9. Burimi Financimit Buxheti bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK- sòka APP-òsòka KPP-sòka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----, datë ----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr. ----, dt. -----

Me procesverbal nr. 3, datë 02.11.2018 është bërë hapja e procedurës në të cilën konstatohet se ka marrë pjesë OE, sipas pasqyrës:

<i>Nr.</i>	<i>Operatorët pjesëmarrës</i>	<i>Oferta paraqitur</i>	<i>Vlerësimi i KVO</i>
1.	S. shpk	5,789,313	Kualifikohet/shpallur fitues

Sipas këtij procesverbali nga operatori pjesëmarrës, plotëson kërkesat e DST, ku në fund fitues është shpallur shoqëria òS.ò me ofertë ekonomike 5,789,313 lekë pa TVSH.

Në dosjen e tenderit ndodhet Raporti Përmbledhës nr. 46/10 prot., i hartuar me datën 11.2018, ku është pasqyruar zhvillimi i procedurës së prokurimit.

Miratimi i procedurës së prokurimit dhe i fituesit është bërë me shkresën nr. 46/11 prot., datë 14.11.2018 të titullarit të Autoritetit Kontraktor, ku është shpallur fitues shoqëria òS.ò ShPK me ofertë ekonomike 5,789,313 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 46/12 prot., datë 12.11.2018 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit.

Kontrata me operatorin ekonomik të shpallur fitues është lidhur me nr. 46/14 prot., datë 19.12.2018 me vlerë 6,947,175 lekë me TVSH, me afat 75 ditë kalendarike nga lidhja e kontratës.

-Shqyrtimi i ofertave:

Nga verifikimi në dosje dhe sistemin APP, konstatohet se OE òS.ò nuk plotëson kriteret e DST, si vijon:

a-Shoqëria òS.ò, nuk plotëson kriterin 2.3.5 sipas DST (kriteri për mjekun), pasi OE ka paraqitur kontratën e lidhur më datë 01.02.2018 me z. E. P. me profesion mjek për të cilin nuk ka paraqitur cv dhe ndërkohë nuk figuron në listapagesën e fundit të paraqitur nga shoqëria.

b-Shoqëria òS.ò nuk plotëson kriteret 2.3.9 dhe 2.3.10 për të cilat nuk ka paraqitur respektivisht, analizë për çmimet për çdo zë preventivi sidhe nuk është paraqitur grafiku i punimeve i firmosur dhe vulosur nga administratori, kërkesa këto sipas

DST.

Si përfundim nga KVO nuk duhet të ishte bërë kualifikimi i OE òS.ò shpk dhe nuk duhet t'ia kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte **anuluar tenderin.**

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: z. E. S., me detyrë ish-përgjegjës, Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Studim Projektimit, z.I. S. specialist prokurimesh dhe z.E. M. me detyrë specialist prokurimesh.

Për sa më sipër është bërë kundërshti nga anëtari i KVO, nëpërmjet adresës elektronike zyrtare me shkresën nr. 3142 prot., datë 16.09.2020 protokolluar në KLSH me nr. 466/5 datë 18.09.2020, ku thuhet:

Pretendim i subjektit:

Operatori ekonomik ka paraqitur kontrate pune me z.E. P. por në dokumentet standarde të tenderit nuk është citur nga ana e njësisë së prokurimit që personi në fjalë të përfshihet në listëpagesë, sipas DST: 2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë në përbërje të stafit Një Mjek në përputhje me VKM nr. 742, datë 06.11.2003, i ndryshuar.

Për këtë duhet të paraqesë kontratën e punës, diplomën, CV dhe licencën përkatëse, duke pasur dhe parasysh kodin civil të Republikës së Shqipërisë, të drejtat dhe detyrimet lindin mes palëve me nënshkrimin e kontratës, do të thotë që detyrimin ligjor për operatorin ekonomik që ta fusë në listëpagesë. Nga ana jonë është bërë vlerësimi vetëm duke u bazuar në DST, dolëm në këtë konkluzion duke u bazuar dhe në vendimet e K.P.P, dhe në rekomandimeve e A.P.P, si psh. Sjellim në vëmendje të AK se në përcaktimin e këtij kriteri duhet të mbajë në konsideratë Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Për sa më sipër, rekomandojmë të rivlerësoni kriterin për disponimin e mjekut të përgjithshëm vetëm nëpërmjet kontratës individuale të punës dhe figurimin në listëpagesa duke mbajtur në konsideratë aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Dhe për pikën e dytë për këtë prokurim nuk jam dakord sepse operatori ekonomik në fjalë pa paraqitur formularin e ofertës në total, pastaj bashkëngjitur ka dhe preventivin e punimeve zë për zë ku përfshihet dhe periudha kohore që do të realizojë punën që përkon 2.5 muaj, siç është vendosur dhe nga njësia e prokurimit në DST, gjë e cila u vlerësua dhe nga ana jonë që nuk mund të bënim anulimin e procedurës për shkak dhe të situatës dimërore në periudhën që është zhvilluar procedura e prokurimi duke u bazuar dhe në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53 pika 4. Ku citohet: Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur.

Nga ana e njësisë së prokurimit nuk është cituar në DST që mjeku të figurojë në listëpagesa.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e anëtarëve të KVO është paraqitur i njëjti arsyetim lidhur me mangësitë e konstatuara siç është trajtuar në Projekt raportin e auditimit.
Për arsye se nuk keni fakte dhe prova të reja kundërshtitë tuaja nuk merren parasysh.

3. Tenderi me objekt: “Rehabilitim i Ambienteve te jashtme te Shkollës se Mesme Maqellare”, viti 2018, me këto të dhëna:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Rehabilitim i Ambienteve te jashtme te Shkollës se Mesme Maqellare”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 43/5, datë 15.10.2018 (prot nr. 43/11).	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 43/5, datë 15.10.2018 z. F. K. znj. I. S. z. N. S.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 43/6, datë 15.10.2018, z. I. S., Kryetar z. E. S., anëtar z. E. M., anëtar
2. Lloji i Procedurës - “Kërkesë për propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 3,538,477 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE òD. N.ò sh.p.k ò me ofertë 3,365,623 Lekë me kontratë të lidhur nr 43/21 date12.11.2018 me afat 25 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 172,854 Lekë
8. Data e hapjes së tenderit Datë 31.10.2018	9. Burimi Financimit Agjencia Zviceriane për zhvillimin edhe bashkëpunimin	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK- ka APP-òska KPP-òska	12. Përgjigje Ankesës nga AK ska	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr. ----, dt. -----

Me hapjen e ofertave konstatohet se ka marrë pjesë e OE, sipas pasqyrës:

Nr.	Operatorët pjesëmarrës	Oferta paraqitur	Vlerësimi i KVO
1.	D. N. sh.p.k	3,365,623	Kualifikohet/fituesi
2.	S. shpk	3,583,477	Kualifikohet
3.	2 shpk	2,334,940	S’kualifikohet

Me shkresën nr. 4559 prot., datë 26.10.2018 është kërkuar nga ana e AK sqarim për ofertën e paraqitur nga OE ò2 shpkò pasi ka rezultuar ofertë anomalisht e ulët. me shkresën nr. 122 prot., datë 31.10.2018 OE ka paraqitur argumentet e tij lidhur me ofertën e bërë ku ka bashkëlidhur dhe analizën teknike të çmimeve të përdorura me shkresën nr. 43/16 datë 31.10.2018 AK i ka kthyer përgjigje OE ku është vendosur refuzimi i ofertës pasi shpjegimet e dhëna nga OE nuk janë bindëse.

KVO ka mbajtur procesverbalin nr. 3 datë 31.10.2018 ku ka vendosur renditjen e OE pjesëmarrës në tender dhe skualifikimin e OE ò2ò ShPK si ofertë anomalisht e ulët.

OE ka paraqitur formularin e ankesës sipas shtojcës nr. 21 datë 06.11.2018, protokolluar në Bashkinë Dibër me nr. 4757 prot., datë 07.11.2018 ku ka shprehur ankesën lidhur me vlerësimin e bërë nga KVO mbi këtë operator.

Me shkresën e datës 07.11.2018 protokolluar në Bashkinë Dibër me nr. 4757/1 prot.,

datë 07.11.2018 OE 2ö ShPK kërkon të tërhiqet ankesa e bërë për procedurën e Rehabilitimit të Ambienteve të jashtme të Shkollës së Mesme Maqellarëo.

Në dosjen e tenderit ndodhet Raporti Përmbledhës nr. 43/17 prot., i hartuar me datë 08.11.2018, ku është pasqyruar zhvillimi i procedurës së prokurimit.

Me shkresën nr. 43/19 prot., datë 08.11.2018 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit.

Kontrata me operatorin ekonomik të shpallur fitues është lidhur me nr. 43/20 prot., datë 12.11.2018 me vlerë 4,038,748 lekë me TVSH, me afat 25 ditë kalendarike nga lidhja e kontratës.

-Shqyrtimi i ofertave:

Nga verifikimi në dosje dhe sistemin APP, konstatohet se OE òD. N.ò i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues nuk plotëson kriteret e DST, si vijon:

a-Shoqëria òD. N.ò, nuk plotëson kriterin 2.3.3 sipas DST për:

1 Hekurkthyes, pasi në dokumentacionin e ngarkuar ka paraqitur për 2 kriteret, manovrator dhe hekurkthyes të njëjtin person z. N. D. me 2 licenza të ndryshme.

2 (dy) Punëtor të përgjithshëm me Kontrate pune, dhe Certificate sigurimi teknik, pasi ka paraqitur si punëtor z. E. F. i cili nuk ndodhet në listpagesën e fundit ajo e muajit Gusht 2018.

b- Shoqëria òD. N.ò, nuk plotëson kriterin 2.3.5 sipas DST dhe më konkretisht:

-shoqëria ka paraqitur z. B. K. si mjek pranë shoqërisë i cili nuk ndodhet në listpagesën e paraqitur.

c- Shoqëria òD. N.ò, nuk plotëson kriterin 2.3.9 sipas DST dhe më konkretisht:

shoqëria ka paraqitur 3 certifikime sipas kërkesave të DST, ISO 9001:2008 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë), ISO 14001:2004 (për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit) dhe OHSAS 18001:2007 (për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë) të cilat kanë si datë skadence dt. 15.09.2018, datë e cila është para zhvillimit të procedurës. Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE òD. N.ò ShPK, dhe duhet të kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të OE òS.òSHPK.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: z.I. S. kryetar, me detyrë specialist prokurimesh, z. E. S. anëtar, ish-përgjegjës, Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Studim Projektimit dhe z.E. M. anëtar, me detyrë specialist prokurimesh.

Për sa më sipër është bërë kundërshtimi nga anëtarët e KVO, nëpërmjet adresës elektronike zyrtare dhe me shkresën nr. 3142 prot., datë 16.09.2020 protokolluar në KLSH me nr. 466/5 datë 18.09.2020, ku thuhet:

Pretendim i subjektit:

1-Operatori ekonomik ka paraqitur z.N. D. si manovrator dhe si hekurkthyes, është marrë parasysh nga ana jonë duke u konsultuar dhe nga specialisti fushës në komisionin e vlerësimit të ofertave, që hekurkthyesi ka një sasi të vogël në preventiv F.V hekur, menduam që ky person mund të kryejë që të dyja punët duke pasur dhe parasysh që ambienti që do të kryhen punimet është me hapësirë të vogël, dhe nuk mund të punojnë shumë persona në një kohë.

2-Operatori ekonomik D. N. ka paraqitur në listëpagesë një numër të konsiderueshëm punonjësish dhe ku dhe nga ana e njësisë së prokurimit është kërkuar që të disponojë 2 punëtor me kontratë pune dhe IQT, duke mos konkretizuar një profesion të caktuar, menduam që ta kualifikonim këtë operator.

3-Operatori ekonomik ka paraqitur një mjek Z.B. K., ku citohet në DST : Operatori Ekonomik duhet të ketë në përbërje të stafit Një Mjek në përpunime me

VKM nr. 742, datë 06.11.2003, i ndryshuar.

Për këtë duhet të parqesë kontratën e punës, diplomën, CV dhe licencën përkatëse, duke pasur dhe parasysh kodin civil të Republikës së Shqipërisë, të drejtat dhe detyrimet lindin mes palëve me nënshkrimin e kontratës, do të thotë që detyrimin ligjor për operatorin ekonomik që ta fusë në listëpagesë. Nga ana jonë është bërë vlerësimi vetëm duke u bazuar në DST, dolëm në këtë konkluzion duke u bazuar dhe në vendimet e K.P.P, dhe në rekomandimeve e A.P.P, si psh. Sjellim në vëmendje të AK se në përcaktimin e këtij kriteri duhet të mbajë në konsideratë Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, **apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë**, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Për sa më sipër, rekomandojmë të rivlerësoni kriterin për disponimin e mjekut të përgjithshëm vetëm nëpërmjet kontratës individuale të punës dhe figurimin në listëpagesa duke mbajtur në konsideratë aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Nga ana e njësisë së prokurimit nuk është cituar në DST që mjeku të figurojë në listëpagesa.

4- Për sa i përket ISO-ve në pikën 2.3.9 të dst, është marë në konsideratë nga ana jonë sepse AK Bashkia Dibër ka zhvilluar po të njëjtën procedurë 2 herë radhazi, dhe operatori ekonomik në fjalë D. N., ishte pjesë e procedurës së parë dhe certifikata Iso ishin të vlefshme për atë periudhë kohore, dhe si rezultat komisioni i vlerësimit të ofertave mendoj që ISOT që u kishte mbaruar afati të meren në konsideratë, duke u bazuar dhe ne ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53 pika 4. Ku citohet : Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur.

Duke pasur parasysh dhe fondi për realizimin e punimeve ishte i deleguar dhe jo i buxhetit të Bashkisë Dibër përkonte dhe me afatin e fundit së tërheqjes së fondit nga finacuesit dhe për rjedhje nuk do ishte i mundur të bëhej ai investim.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me problematikat e konstatuara dhe me kundërshtitë e paraqitura si për akt-konstatimin dhe për Projekt Raportin, lidhur me këtë procedurë, si përfundim ju bëjmë me dije se lidhur me kundërshtimet:

1.Lidhur me faktin se KVO ka gjykuar se i njëjti person mund të kryej 2 procese pune kjo gjë nuk mund të merret në konsideratë pasi nëse gjykohej si e tillë duhet të ishin bërë përcaktimet në DST dhe të mos penalizoheshin në pjesëmarrje operatorë të tjerë gjithashtu janë 2 dëshmi krejt të ndryshme dhe lidhen me procese të ndryshme realizimi punimesh.

2.Lidhur me disponibilitetin e 2 punëtorëve me kontratë merret në konsideratë observacioni juaj.

3. Lidhur me prezencën e mjekut të shoqërisë në listpagesë siç dhe trajtuar më sipër në këtë material ky observacion nuk merret në konsideratë.

4.Lidhur me ISO-t e paraqitura të cilat janë të skaduara ju bëjmë me dije se KVO

duhet të bëj vlerësimet sipas çdo procedura dhe jo lidhur me procedurat e mëparshme dhe fakti se ISO-t janë me datë të skaduar në momentin e hapjes së ofertave duhet të konsideroheshin si kriter i paplotësuar nga ana e KVO-së. Për arsytet sa më sipër, ky observacion merret pjesërisht në konsideratë.

4. Tenderi me objekt: “Blerje artikuj ushqimorë për nevojat e kopshteve dhe çerdheve të Bashkisë Dibër për vitin 2018”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje Artikuj Ushqimorë për nevojat Kopshteve dhe Çerdheve të Bashkisë Dibër për vitin 2018”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 2/1, datë 09.03.2018 (prot nr. 2/2).	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 2/1, datë 09.03.2018 z. F. K. znj. I. S. z. N. S.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 2/3, datë 09.03.2018, znj. V. K., Kryetare znj. L. M., anëtare znj. Z. G., anëtare
2. Lloji i Procedurës - “Kërkesë për propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 4,462,805 Lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE òJ.sh.p,k ò me ofertë 4,135,676 Lekë me kontratë të lidhur nr 2/ë date 07.05.2018 me afat 12 muaj	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 327,129 Lekë
8. Data e hapjes së tenderit Datë 05.04.2018	9. Burimi Financimit Buxheti bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 1 OE b) skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK- sòka APPòsòka KPP-sòka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----, datë -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr. -----, dt. -----

Zhvillimi procedurës: Me procesverbal nr. 3, datë 05.04.2018 është bërë hapja e procedurës në të cilën konstatohet se ka marrë pjesë 1 OE, sipas pasqyrës:

Nr.	Operatorët pjesëmarrës	Oferta paraqitur	Vlerësimi i KVO
1.	J.shpk	4,135,676	Kualifikohet/shpallur fitues

Sipas këtij procesverbali nga operatori pjesëmarrës, plotëson kërkesat e DST, ku në fund fitues është shpallur shoqëria òJ.ò me ofertë ekonomike 4,ë5,676 lekë pa TVSH.

Në dosjen e tenderit ndodhet Raporti Përmbledhës nr. 02/9 prot., i hartuar me datë 05.04.2018, ku është pasqyruar zhvillimi i procedurës së prokurimit.

Miratimi i procedurës së prokurimit dhe i fituesit është bërë me shkresën nr. 02/10 prot., datë 05.04.2018 të titullarit të Autoritetit Kontraktor, ku është shpallur fitues shoqëria òJ.ò me ofertë ekonomike 4,135,676 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 02/11 prot., datë 13.04.2018 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit.

Kontrata me operatorin ekonomik të shpallur fitues është lidhur me nr. 02/13 prot., datë 07.05.2018 me vlerë 4,962,811 lekë me TVSH, me afat 12 muaj nga lidhja e kontratës.

-Shqyrtimi i ofertave:

Nga verifikimi në dosje dhe sistemin APP, konstatohet se OE òJ.ò nuk plotëson kriteret e DST, si vijon:

a-Shoqëria òJ.ò, nuk plotëson kriterin 2.2 sipas DST pasi OE nuk ka paraqitur kopje të certifikuar të bilanceve për vitet 2015-2016 por ka paraqitur vetëm raportet e audituesit të pavarur për të dy vitet.

b-Shoqëria òJ.ò nuk plotëson kriterin 2.3.a për vërtetimin e lëshuar nga institucionet për kontrata e mëparshme të realizuara pasi Vërtetimi i paraqitur nuk përmban data, shumat dhe sasishtë e shërbimit të realizuar siç kërkohet në DST.

c-Lidhur me kriterin 2.3.c ku kërkohet :ò...Operatori ekonomik duhet te jete i licencuar nga QKB, kategoria II.1.A.1 ó òProdhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëzò, ose të paraqesë kontratë noteriale me objekt furnizimin e mallrave objekt prokurimi me një subjekt i cili është i licencuar nga QKB kategoria II.1.A.1ò OE ka paraqitur vetëm lejen e subjektit Z. C. dhe asnjë dokumentacion tjetër shoqërues siç janë kërkesat e DST.

d-Lidhur me kriterin 2.3.e ku kërkohet certifikatë ISO 9001:2015, OE nuk ka paraqitur në SEP asnjë dokument për të vërtetuar pajisjen me këtë lloj certifikate.

Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE òJ.ò shpk, dhe nuk duhet tò kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte **anulluar tenderin**.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: znj. V. K., me detyrë ish-përgjegjëse financës, znj. L. M. specialiste arsimit dhe znj. Z. G., anëtare me detyrë përgjegjëse sektori i Arsimit, Kulturës dhe Turizmit.

Në adresën zyrtare të postës elektronike kanë ardhur 2 observacione lidhur me Akt Konstatimin nr. 15 nga 2 anëtarët e KVO-së, përkatësisht znj. Z. G. dhe znj. L. M.

Pretendim i subjektit -

*1.Nga ana e znj. Z. G. si anëtare e KVO për procedurën objekt prokurimi “Blerje Artikuj Ushqimorë për nevojat Kopshteve dhe Çerdheve të Bashkisë Dibër për vitin 2018” në adresën zyrtare të e-mail ka ardhur 1 (një) observacion lidhur me konstatimet e bëra nga grupi i auditimit për procedurën më sipër. Më konkretisht znj. G. ngre pretendimin se dokumentet e ndodhura në dosjen e auditimit nuk janë të firmosura prej saj, pasi nuk kam pranuar të jetë pjesë e KVO, sepse nuk ishte eksperte e fushës dhe procedura kishte të bëjë me ushqimin e fëmijëve të moshës 0-7 vjeç dhe ndikon në jetën dhe shëndetin e tyre, por z. F. K.- Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve **ka falsifikuar firmën pa lejen e saj në dokumentet:***

1. Vendim Nr. 1, Datë 5.04.2018 “ MBI VLERËSIMIN E OFERTAVE ”

2. Raport përmbledhës për procedurat e tenderit me objekt “Blerje artikuj ushqimorë për nevojat e çerdheve dhe kopshteve të Bashkisë Dibër për vitin 2018” me Nr 02/9 prot, Datë 05.04.2018.

Gjithashtu në observacionin tuaj shpreheni se nuk është informuar se është anëtare e KVO.

2.Nga ana e znj. L. M. në observacionin dërguar shprehet se:

-Unë nuk jam informuar se jam anëtare e KVO për procedurën e prokurimit publik:

“Blerje Artikuj Ushqimorë për nevojat e Kopshteve dhe Çerdheve të Bashkisë Dibër për vitin 2018”. (Nuk jam vënë në dijeni për anëtarësinë)

-Nuk jam trajnuar për të ndjekur procedurë konkurimi dhe nuk kam patur adresë për t’u futur në sistem për të ndjekur veprimet.

-Objekti i tenderit ka qenë blerje artikuj ushqimorë me karakter Teknolog ushqimor ndërkohë që asnjëri nga anëtarët e KVO-së nuk ishte ekspert i fushës sipas objektit të tenderit.

-OE “ J.” ishte i vetmi operator që kish aplikuar dhe me përzgjedhjen e tij nuk është se i kemi shkaktuar dëm ekonomik shtetit duke shpërdoruar detyrën

Qëndrim i grupit të auditimit: *Lidhur me “Të drejtën e informimit” në bazë të ligjit nr. 119/2014 nga ana e grupit të auditimit, duke konsideruar situatën e pandemisë dhe problematikat e shumta e rrjedhura prej saj, u konsiderua e mjaftueshme marrja kontakt me kryetaren e KVO znj. V. K. të cilës ju është bërë me dije se cilat kanë qenë mangësitë e konstatuara në këtë procedurë prokurimi për të cilat gjatë intervistës së kryer nuk paraqiti observacione lidhur me mangësitë e dokumentacionit të OE të shpallur fitues.*

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga znj. Z. G. lidhur me falsifikimin e dokumenteve të ndodhur në dosjen e auditimit dhe disa nga faktet e paraqitura në emailin e dërguar, nga ana e grupit të auditimit kjo problematikë do të raportohet në instancat e tjera drejtuese të institucionit të cilat do shprehin mendimin e tyre lidhur me këtë çështje. Duke konsideruar faktin se Ju nuk keni shprehur kundërshtime lidhur me konstatimet e grupit të auditimit, pretendimet tuaja merren parasysh lidhur me faktet e reja të vëna në dispozicion deri në momentin e shprehjes nga instancat e tjera të KLSH-së për përgjegjësitë tuaja në këtë procedurë prokurimi.

Lidhur me Observacionin e paraqitur nga znj. L. M. vihet re se nuk janë paraqitur argumenta lidhur me mangësitë e konstatuara nga grupi i auditimit, por janë dhënë deklarata mbi mos informimin e të qënurit anëtare e KVO për këtë procedurë, deklarata të cilat do të merren parasysh dhe trajtohen së bashku me informacionin e paraqitur nga anëtarja tjetër e KVO.

5. Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje dru zjarri per nevojat e Institucioneve Arsimore, Bashkia Diber”, me këto të dhëna:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje dru zjarri per nevojat e Institucioneve Arsimore, Bashkia Diber”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 36/1, datë 02.07.2018 (prot nr. 36/2).	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 36/1, datë 02.07.2018 z. F. K. znj. I. S. z. N. S.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 2/3, datë 09.03.2018, z. R. K., Kryetar z. I. S., anëtar z. E. M., anëtar
2. Lloji i Procedurës -“E hapurö		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 10,500,000 Lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE 6S. V. 6 me ofertë 10,376,540 Lekë me kontratë të lidhur nr 36/10 date 06.09.2018 me afat 12 muaj	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 123,460 Lekë
8. Data e hapjes së tenderit Datë 06.08.2018	9. Burimi Financimit Buxheti bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 1 OE b) skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK- soka APPósoka KPP-soka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----, datë -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr. ----, dt. -----

-Zhvillimi procedurës: Me procesverbal nr. 3, datë 06.08.2018 është bërë hapja e procedurës në të cilën konstatohet se ka marrë pjesë 1 OE, sipas pasqyrës:

Nr.	Operatorët pjesëmarrës	Oferta paraqitur ^e	Vlerësimi i KVO
1.	S. V.	10,376,540	Kualifikohet/shpallur fitues

Sipas këtij procesverbali nga operatori pjesëmarrës, plotëson kërkesat e DST, ku në fund fitues është shpallur shoqëria òS. V.ò me ofertë ekonomike 10,376,540 lekë pa TVSH.

Në dosjen e tenderit ndodhet Raporti Përmbledhës nr. 36/6 prot., i hartuar me datë 06.08.2018, ku është pasqyruar zhvillimi i procedurës së prokurimit.

Miratimi i procedurës së prokurimit dhe i fituesit është bërë me shkresën nr. 36/7 prot., datë 06.08.2018 të titullarit të Autoritetit Kontraktor, ku është shpallur fitues shoqëria òS. V.ò me ofertë ekonomike 10,376,540 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 36/8 prot., datë 06.08.2018 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit.

Kontrata me operatorin ekonomik të shpallur fitues është lidhur me nr. 36/10 prot., datë 06.10.2018 me vlerë 12,451,848 lekë me TVSH, me afat 12 muaj nga lidhja e kontratës.

-Shqyrtimi i ofertave:

Nga verifikimi në dosje dhe sistemin APP, konstatohet si vijon:

-Parregullsi në lidhje me kualifikimin e OE dhe më konkretisht, në vërtetimin e paraqitur nga shoqëria ,e nr. 169 prot., datë 15.05.2018 thuhet se përveç vlerës prej 1,929,822 lekë e cila është në proces gjyqësor, vlera prej 130,697 lekë është në proces ankimimi pranë OSHEE-së, pra subjekti figuron debitor për detyrimet e energjisë elektrike. Veprimet e KVO janë në kundërshtim me nenin 27 pika 5,c e VKM 914 datë 29.12.2014 (e përditësuar) ku thuhet se:

òMos shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. KVO duhet të kishte skualifikuar OE dhe të kishte **anulluar tenderin.**

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë:z.R. K. kryetar, me detyrë specialist prokurimesh, z.I. S. anëtar, me detyrë specialist prokurimesh dhe z.E. M. anëtar, me detyrë specialist prokurimesh.

Për sa më sipër është bërë kundërshti nga anëtarët KVO, nëpërmjet adresës elektronike zyrtare dhe me shkresën nr. 3142 prot., datë 16.09.2020 protokolluar në KLSH me nr. 466/5 datë 18.09.2020, ku thuhet:

Pretendim i subjektit:

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi të kualifikojë operatorin ekonomik duke u bazuar dhe në LPP neni 53 pika 4, Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur. Duke pasur dhe parasysh se në territorin e Bashkisë Dibër nuk ka një subjekt tjerët që meret me tregtim të druve të zjarrit, dhe në këtë procedurë prokurimi mungon dhe konkurrenca, vendosëm që të kualifikonim OE në fjalë, theksojmë se në qoftë se procedura e prokurimit do të shkonte në anulim, nuk do mund merte AK Bashkia Dibër këtë mall që është mjaft i domosdoshëm për

ngrohjen e fëmijëve në institucionet arsimore duke marrë parasysh dhe klimën në qytetin e Peshkopisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Ju nuk paraqisni fakte apo argumenta bindës lidhur me konstatimin e bërë nga grupi i auditimit dhe si rrjedhojë observaconi Juaj nuk merret në konsideratë.*

Kriteri:

Veprimet e mësipërme për pesë procedura, janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, nenet 24,46 dhe 53 ò, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

Impakti për gjashtë procedurat e mësipërme, sipas radhës së përshkrimit:

1- KVO nuk duhet të kishte bërë kualifikimin e OE òE.ò shpk dhe nuk duhet t'ò kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte **anuluar tenderin.**

Moskryerja e këtij veprimi ka çuar në kualifikim dhe shpallje fitues të operatorit ekonomik në mënyrë të pa drejtë, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, duke sjell përdorim të fondeve publike në kushtet e paligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik në shumën prej 9,678,650 lekë pa TVSH, e cila është vlera e kontratës së lidhur.

2-KVO nuk duhet të kishte bërë kualifikimin e OE òS.ò ShPK dhe nuk duhet t'ò kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte **anuluar tenderin.**

Moskryerja e këtij veprimi ka çuar në kualifikim dhe shpallje fitues të operatorit ekonomik në mënyrë të pa drejtë, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, duke sjell përdorim të fondeve publike në kushtet e paligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik në shumën prej 5,789,313 lekë pa TVSH, e cila është vlera e kontratës së lidhur.

Impakti:

3-KVO nuk duhet të kishte bërë kualifikimin e OE òD. N.ò ShPK dhe nuk duhet t'ò kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij, por të OE òS.ò ShPK.

Moskryerja e këtij veprimi ka çuar në kualifikim dhe shpallje fitues të operatorit ekonomik në mënyrë të pa drejtë, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, duke sjell përdorim të fondeve publike në kushtet e paligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik në shumën prej **3,365,623** lekë pa TVSH, e cila është vlera e kontratës së lidhur.

4-KVO nuk duhet të kishte bërë kualifikimin e OE òJ.ò ShPK, dhe nuk duhet t'ò kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte **anuluar tenderin.**

Moskryerja e këtij veprimi ka çuar në kualifikim dhe shpallje fitues të operatorit ekonomik në mënyrë të pa drejtë, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, duke sjell përdorim të fondeve publike në kushtet e paligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik në shumën prej **4,135,676** lekë pa TVSH, e cila është vlera e kontratës së lidhur.

5-KVO nuk duhet të kishte bërë kualifikimin e OE òS. V.ò, person fizik dhe nuk duhet t'ò kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte **anuluar tenderin.** Moskryerja e këtij veprimi ka çuar në kualifikim dhe shpallje fitues të operatorit ekonomik në mënyrë të pa drejtë, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, duke sjell përdorim të fondeve publike në kushtet e

paligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik në shumën prej 10,376,540lekë pa TVSH, e cila është vlera e kontratës së lidhur.

Shkaku: Nga mos vlerësim i drejtë nga ana e KVO të dokumentave të paraqitura nga OE.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim Të ndërpriten praktikatat e kualifikimit të OE në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të vendosura në DST.

III. Përfundim i punimeve jashtë afatit të përcaktuar në kontratë

Titulli i Gjetjes Në 2procedura prokurimi, një prej të cilave zhvilluar në vitin 2018, me objekt “*Punime ndërtimi, rehabilitim, rikonstruksion, mirëmbajtje e rezervuarëve dhe kanaleve ujitëse, Bashkia Dibërë, dhe një e zhvilluar në vitin 2019 me objekt “Rikonstruksioni dhe mirëmbajtje të kanaleve ujitëse, NjA, Bashkia Dibërë, është konstatuar përfundimi i punimeve jashtë afatit të përcaktuar në kontratë.*

Situata **1- Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Punime ndërtimi, rehabilitim, rikonstruksion, mirëmbajtje e rezervuarëve dhe kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër”, viti 2018.**

1. Urdhër Prokurimi nr. 11/1, datë 28.03.2018 (prot nr. 11/2).	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 11/1, datë 28.03.2018 z. F. K. znj. I. S. z. N. S.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 11/2, datë 28.03.2018, ndryshuar me Urdhër nr. 11/2/1 datë 21.05.2018 z. E. S., Kryetar z. I. S., anëtar z. E. M., anëtar
2. Lloji i Procedurës -“E hapurë		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 9,992,079 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE òE.ò me ofertë 9,678,650 Lekë me kontratë të lidhur nr 11/11 date18.06.2018 me afat 25 ditë, amenduar me kontratën nr. 11/13 datë 27.06.2018	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 313,429 Lekë
8. Data e hapjes së tenderit Datë 23.05.2018	9. Burimi Financimit Buxheti bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK- sòka APPòsòka KPP-sòka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----, datë ----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr. ----, dt. -----

Në zbatimin e kushteve të kontratës nr. 11/13, datë 27.06.2018, në lidhje me zbatimin në afat të tij, brenda 25 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës (nga data 27.06.2018 ó 22.07.2018). Referuar dokumentacionit në dosjen e auditimit (njoftim për mbylljen e punimeve datë 12.09.2018 sipas shkresës së protokolluar në Bashkinë Dibër me nr. 3819 prot., datë 12.09.2018), konstatohet se punimet kanë përfunduar me datë 12.09.2018 ose 50 ditë vonësë. Në dosjen e audituar nuk ndodhet asnjë dokumentacion shtesë të mbajtur midis AK dhe OE òE.òlidhur me kohëzgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve.

Për mos përfundimin e punimeve në afat, ndaj shoqërisë òE.ò ShPK nuk janë përlllogaritur penalitetet në zbatim të nenti 6, pika 4, të kontratës datë 27.06.2018, konkretisht: (11,614,380 x 4/1000 x 50 ditë vonësë) = 2,322,876 lekë, e cila

konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Dibër dhe ngarkon me përgjegjësi shoqëria òE.ò ShPK për shpërblim dëmi.

<p>Për sa më sipër është bërë kundërshti nga OE me shkresën nr. 08.9 prot., datë 09.08.2020, ku thuhet:</p> <p>Pretendim i subjektit: Situacioni pjesor nr. 1 bashkë me faturën tatimore nr. 9, datë 21.07.2018 janë paraqitur për likuidim brenda afatit kohor sipas kontratës, sqarojmë se situacioni pjesor nr. 1 i datës 19.07.2018 është hartuar me 30 % më pak volume sesa fakti, pasi deri më datë 19.07.2018 dhe sipas ditarit të objektit dhe njoftimit të rifillimit të punimeve dhe përfundimit të punimeve diferenca nga kontrata është 5 ditë, mos raportimi i plotë i situacionit nr. 1 në masën 80 % është kushtëzuar si pasojë e mungesës së fondeve nga AK të cilat na janë likuiduar brenda 3 viteve, rrjedhimisht edhe llogaritja edhe llogaritja e penaliteteve në qoftë se ato qëndrojnë duhet të ishte bërë për diferencën e punimeve të papërfunduara në masën 20% të vlerës së totalit të objektit. Bashkëlidhur dokumentacioni përkatës.</p> <p>Qëndrimi i grupit të auditimit:</p> <p>Në lidhje me pretendimet tuaja dhe dokumentacioni e paraqitur merren në konsideratë komentet dhe dokumentet shoqëruese, të cilat i lihen përdetyrë Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të realizojë një analizë dhe verifikim të veçante, mbështetur në dokumentacionin financiar të bankës dhe mbi zbatimin e kontratave të cituara në projekt raport. Nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Dibër, të marren masa për realizimin e kësaj detyre, me paraqitjen e planit të punës për zbatimin e rekomandimeve. Grupi i auditimit ka marrë në konsideratë faktin që nga Bashkia Dibër ka patur financime të ulëta mbi kontrata publike. Në raportin përfundimtar kamatëvonesat do të konsiderohen si efekte negative financiare në kundërshtim me parimet e eficensës, ekonomikitetit dhe efektivitetit, deri në analizimet financiare nga drejtoria e auditit të brendshëm</p>		
--	--	--

2- Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni dhe mirëmbajtje të kanaleve ujitëse, NjA, Bashkia Dibër, zhvilluar në vitin 2019.

a..ò		
<p>1.Urdhër Prokurimi nr.16/1 dt 29.03.2019</p>	<p>3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1.F. K. 2.I. S. 3.N. S.</p>	<p>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër 16/2 dt 29.03.2019 1. E. S. 2. E. M. 3. I. S.</p>
<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: òKërkesë për propozimò</p>	<p>5.Fondi Limit (pa tvsh) 8,750,000 lekë pa tvsh</p>	<p>6.Oferta fituese: B.O.E 2 & K. ME Vlere 6,282,407 lekë pa TVSH.</p>
<p>7.Diferenca me fondin limit 2,467,593 lekë (pa tvsh)</p>	<p>8. Data e hapjes së tenderit: 10.06.2019</p>	<p>9.Burimi Financimit: Buxheti Bashkisë</p>
<p>10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender: 4 OE b)Sòkualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 3 OE</p>	<p>11.Ankimime AK: Po</p>	<p>12. Përgjigje ankesës nga AK Po</p>
<p>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP Po Vendim KPP (mbi kriteret e DST)</p>		

Nga ana e AK pas shpalljes së BOE fitues është lidhur kontrata për realizimin e

punimeve me nr. 16/13 prot., datë 05.07.2019 me vlerë totale 7,538,888 lekë me TVSH, ku në nenin 3 Afatet e punimeve është përcaktuar se afati i kryerjes së punimeve do të jetë **25 ditë**. Në zbatimin e kushteve të kontratës në lidhje me zbatimin në afat të tij, brenda 25 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës punimet duhet të ishin përfunduar brenda datës 30.07.2019. Nga ana e AK me shkresën nr. 207 prot., datë 18.08.2019 bazuar mbi kërkesën e ardhur nga sipërmarrësi i punimeve të SHPK është vendosur shtyrja e afatit të punimeve deri në datë 10.09.2019. Referuar dokumentacionit në dosjen e auditimit (njoftim për përfundimin e punimeve datë 07.10.2019), konstatohet se punimet kanë përfunduar me datë 07.10.2019 ose **27 ditë vonesë** nga data 10.09.2019.

Për mos përfundimin e punimeve në afat, ndaj SHPK nuk janë përlogaritur penaltetet në zbatim të nenti 6, pika 4, të kontratës datë 05.07.2018, konkretisht: $(7,538,888 \times 4/1000 \times 27 \text{ ditë vonesë}) = \mathbf{814,200 \text{ lekë}}$, e cila konsiderohet **dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Dibër dhe ngarkon me përgjegjësi shoqërore “2”, si përfaqësuese e BOE, për shpërblim dëmi.**

Në adresën zyrtare të postës elektronike si dhe me shkresën protokolluar në KLSH me nr. 466/2 prot., datë 30.07.2020, kanë ardhur observacion nga shoqëria SHPK lidhur me Akt Konstatimin nr. 16 mbi procedurën me objekt Rikonstruksioni dhe mirëmbajtje të kanaleve ujitëse, NjA, Bashkia Dibër.

Pretendim i subjektit: Shoqëria shprehet se: Momenti i fillimit të punimeve ka qenë data 18.07.2019 sipas dhe procesverbalit të fillimit të punimeve, kjo ka ndodhur pasi në këtë moment është bërë dhe dorëzimi i sheshit të ndërtimit nga pala investitore. Pas fillimit të punimeve puna ka vazhduar deri në dt. 08.08.2019 ku pikërisht në këtë datë është kërkuar dhe shtyrja e afatit të punimeve. Nga dt 08.08.2019 deri më datë 10.09.2019 subjekti ynë nuk ka punuar për zbatimin e objektit të kontratës për shkak të pamundësive të krijuara nga situata në terren. Kjo faktohet dhe me praktikën për shtyrje punimesh me nr 3901 datë 13.08.2019 ku ndër të tjera kërkohet dhe shtyrja e punimeve deri në dt. 10.09.2018 për shkak të periudhës së vaditjes. Më datë 10.09.2019 shoqëria ka rifilluar punimet pjesërisht në disa zona pasi akoma nuk kishte përfunduar plotësisht ujitja dhe gjithashtu u hasën probleme sociale me banorët faktuar me shkresën nr. 4252 prot., datë 12.09.2019. Me shkresën nr. 4367 prot. datë 19.09.2019 është kërkuar shtyrje deri më datën 10.10.2019 nga ana e shoqërisë. Më datë 07.10.2019 kanë përfunduar punimet të cilat janë njoftuar dhe me shkresë tek AK. Gjithashtu në dokumentet e paraqitura OE është shprehur se Ak ka marrë në dorëzim objektin e kontratës dhe e ka vënë në shfrytëzim

Qëndrim i grupit të auditimit: Lidhur me pretendimet e shprehura nga ana Juaj, merren në konsideratë komentet dhe dokumentet shoqërore, të cilat i lihen për detyrë Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të realizojë një analizë dhe verifikim të veçantë, mbështetur në dokumentacionin financiar të bankës dhe mbi zbatimin e kontratave të cituara në projekt raport. Nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Dibër, të marren masa për realizimin e kësaj detyre, me paraqitjen e planit të punës për zbatimin e rekomandimeve. Në Raportin përfundimtar kamatëvonesat do të konsiderohen si efekte negative financiare në kundërshtim me parimet e eficensës, ekonomikitetit dhe efektivitetit, deri në analizimet financiare nga drejtoria e auditit të brendshëm.

Kriteri: Kontrata nr 11/11 datë 18.06.2018 me afat 25 ditë, amenduar me kontratën nr. 11/13 datë 27.06.2018, nenti 6, pika 4; nenti 6, pika 4, të kontratës datë 05.07.2018.

Ndikimi/Efekti: 1-Në procedurën e prokurimit me objekt “*Punime ndërtimi, rehabilitim, rikonstruksion, mirëmbajtje e rezervuarëve dhe kanaleve ujitëse, Bashkia Diber,* moszbatimi i kushteve kontraktuale ka sjell mos llogaritjen e penalteteve të parashikuara në nenin 6 pika 4 të kontratës së lidhur midis AK dhe OE, e cila konsiderohet efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Diber në shumën prej 1,100,159 lekë (pas shqyrtimit të observacionit të bërë nga OE), në ngarkim të OE òE.òShPK
2- Në procedurën e prokurimit me objekt *Rikonstruksioni dhe mirëmbajtje të kanaleve ujitëse, NjA, Bashkia Diber*”, zhvilluar në vitin 2019, moszbatimi i kushteve kontraktuale ka sjell mos llogaritjen e penalteteve të parashikuara në nenin 6 pika 4 të kontratës së lidhur midis AK dhe OE, e cila konsiderohet efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Diber në shumën prej 814,200 lekë, në ngarkim të OE “2” ShPK

Shkaku: Nga mos zbatimi i kushteve kontraktuale

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Diber, Drejtoria e Auditit të Brendshëm, mbështetur në dokumentacionin financiar dhe të zbatimit të kontratave të cituara në Raport Përfundimtar të ushtrisë auditim mbi vërtetësinë e tyre dhe të paraqesë planin e auditimit me paraqitjen e planit të punës për zbatimin e rekomandimeve dhe rezultatet me përfundimin e auditimit.

IV. Anullim i tenderit në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi

Titulli i Gjetjes: Anullim i procedurës së prokurimit në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, në procedurën e prokurimit me objekt *òNdërtim i Shkollës 9-vjeçare, Fshati Kërçisht, Bashkia Diber, 2019*ò, me vlerë të fondit limit 44,552,166 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 02.12.2019).

Situata:

" Ndërtim i Shkolles 9-vjeçare, Fshati Kërçisht, Bashkia Diber, 2019		
1.Urdhër Prokurimi nr. 36/4, datë 23.09.2019, me nr. 36/11 prot.	3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr. 36/4, datë 23.09.2019: F. K.; A. C.; I. S.;	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr. 36/5 datë 23.09.2019, nr.36/12.prot.): R. K.; I. S.; E. S.
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: òProcedurë e hapurò		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 44,552,166 lekë për herën e dytë	6.Oferta fituese:òS.òshpk, me vlerë 42,977,386 leke (pa tvsh)	7.Diferenca me fondin limit 1,574,780 (pa tvsh)
8. Data e hapjes së tenderit: 31.10.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i shtetit	10.Operatoret Ekonomik)Pjesëmarrësnë tender: OE b)Sòkualifikuar OE c) Kualifikuar OE
11.Ankimime AK: Po: OE Kevin shpk	12. Përgjigje ankesës nga AK: Po	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: Nuk ka

Kjo procedurë prokurimi për herë të parë është zhvilluar deri në fazën e vlerësimit të

ofertave, fazë në të cilën është anuluar dhe pastaj është zhvilluar përsëri në mënyrë të plotë.

Zhvillimi i procedurës për herën e parë:

Nga ish titullari i AK z.M. R. ka dalë urdhri nr. 36, datë 06.05.2019 për argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivave, ku urdhërohet për:

1- Ngritjen e komisionit për argumentimin dhe studimin e fondit limit prej 45,273,57 lekë pa TVSH të vëna në dispozicion nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

2- Të hartohen specifikimet teknike dhe preventivat për të realizuar këtë procedurë prokurimi.

3- Dokumentet e specifikuar në pikën nr. 2 të këtij urdhri, të dorëzohen edhe në formë elektronike pranë sektorit të prokurimeve.

Në këtë urdhër është përcaktuar komisioni i përbërë nga: z. S. Ç., me detyrë ish specialist i sektorit të planifikimit të territorit dhe studim projektimit, *me arsim të mesëm teknik i mesëm topograf*, ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të daljes në pension, me profesion, z. M. M. me detyrë specialist në sektorin e urbanistikës, *me profesion inxhinier gjeolog*, z. D. R., *me arsim të lartë juridik*, me detyrë specialist/jurist pranë sektorit juridik.

Përcaktimi i këtyre punonjësve në urdhër nga Titullari i Autoritetit Kontraktor është në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998, për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, neni 5 ku thuhet:

Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse”.

Anëtarët e komisionit të mësipërm nuk kanë as formimin e duhur inxhinier ndërtimi dhe as licencë për hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivit (fondit limit), për tenderin "Ndërtim i Shkollës 9-vjeçare, Fshati Kërçishtë, natyra e të cilit kërkon formim të inxhinierit të ndërtimit.

Gjithashtu konstatohet se në Bashkinë Dibër për zhvillimin e parë të procedurës, nuk ka dokument për marrjen e në dorëzim dhe verifikimin e saktësisë së projektit dhe preventivit, pra njësia vendore nuk janë shprehur nëse fondi limit i hartuar nga projektuesi është i argumentuar (përsa i përket çmimeve të preventivit, nëse ato janë sipas manualeve përkatëse, jo për volumet e punimeve).

Urdhri i mësipërm është formal, pasi në fakt specifikimet teknike projekti dhe preventivi janë hartuar nga projektuesi privat nga subjekti "Projektim-Mbikëqyrje-Kolaudim", me NIPT K....., me përfaqësues ing. Z. M..

Për hartimin e projektit nuk është zhvilluar procedurë prokurimi. Nuk ka kontratë të lidhur midis AK Bashkia Dibër dhe hartuesit të mësipërm të projektit ku të përcaktohen detyrimet dhe të drejtat kontraktuale midis palëve. Gjithashtu nuk ka akt dhurimi, që të shpjegojë marrëdhënien e njësisë vendore me subjektin privat të mësipërm lidhur me projektin dhe preventivin. Preventivi ka vlerën 45,273,597 lekë pa TVSH dhe nuk ka miratim të ish titullarit të AK Z. M. R.. Për procedurën e anuluar, nga ish kryetari i bashkisë z. M. R., ka dalë urdhri i prokurimit nr. 36/1, datë 29.05.2019, me nr. 36/2 prot. Në urdhër është përcaktuar njësia e prokurimit e përbërë nga z. F. K., me detyrë përgjegjës sektorit të prokurimeve, me arsim të lartë juridik, znj. I. S., me detyrë specialiste e prokurimeve, me arsim të lartë juridik, z. A. C., me detyrë përgjegjës i sektorit të mbrojtjes së mjedisit, me arsim të lartë inxhinier mjedisi. Në urdhrin e mësipërm të prokurimit vlera e fondit limit është 45,273,597 lekë.

Për herën e parë në DST emërtimi i procedurës është i gabuar: ÷Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Melan, NjA Melan, Bashkia Diber, 2019ö, pra tjetër procedurë, jo ajo e duhura.

Për herë të parë tenderi është hedhur në sistem në datën 29.05.2019 dhe ka vazhduar deri në datën 22.08.2019, datë në të cilën është anuluar nëpërmjet formularit të anulimit (reflektuar në sistem në datën 23.08.2019). Dorëzimi i ofertave ka filluar në datën 30.05.2019 dhe ka përfunduar në datën 08.07.2019.

Faza e vlerësimit të ofertave ka filluar në datën 08.07.2019 dhe ka përfunduar në datën 30.07.2019 (shfaqur në sistem më 31.07.2019), datë në të cilën është bërë njoftimi i operatorëve ekonomik për fazën e vlerësimit, pra 22 ditë, në kundërshtim me nenin 66 ÷Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveö, të VKM 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö, i ndryshuar, ku thuhet: ÷Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla”. Për tejkalimin e afateve në vlerësimin e ofertave ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave z. R. K., kryetar, me detyrë specialist i prokurimeve, z. I. S., anëtar, me detyrë specialist i prokurimeve, z. E. S., anëtar me detyrë përgjegjës i urbanistikës

Është bërë ankesë pas këtij vlerësimi të KVO, e cila është shqyrtuar nga AK, i është kthyer përgjigje OE, por nuk ka vazhduar procedura për plotësimin e fazës ÷kërkohet rivlerësimö, e cila plotësohet pas shqyrtimit të ankesave. Pra këtu është ndërprerë zhvillimi i procedurës, nuk është vazhduar plotësimin e fazës ÷njoftim i fituesitö, ÷publikim i njoftimit të fituesitö, konfirmim i fituesitö.

Ankesa për vlerësimin e ofertave në zhvillimin e parë të tenderit është bërë nga OE ÷E.ö shpk, protokolluar në Bashkinë Dibër më datën 07.08.2019. Në këtë ankesë në mënyrë të përmbledhur thuhet:

÷Duke u nisur nga fakti që në datën 30.07.2019 në sistemin elektronik të APP, është bërë klasifikimi i ofertave si më poshtë (faza e vlerësimit të tenderit):

Operatori ekonomik 2 SHPK, vlera e ofertës 32,409,230 lekë, refuzuar oferta nga KVO;

Operatori ekonomik “S.” ShPK, vlera e ofertës 34,638,557, pranuar oferta nga KVO;

Operatori ekonomik “E.” ShPK, vlera e ofertës 38,807,159 lekë, pranuar oferta nga KVO;

BOE “ S. & D. R.” ShPK, vlera e ofertës 38,881,156 lekë, refuzuar oferta nga KVO;

Operatori ekonomik “S.2.”, ShPK vlera e ofertës 42,222,222 lekë, pranuar oferta nga KVO.

Rrjedhimisht është shpallur në kundërshtim me ligjin dhe kriteret e APP, pasi shoqëria në fjalë (S. SHPK), i ka të angazhuara të gjitha mjetet, stafin dhe fuqinë punëtore në kontratën e shpallur fitues me objekt “Sistemim, asfaltim i rrugës së fshatit Melan, NJA Melan”. Është e njëjta shoqëri e cila është shpallur fitues në të njëjtin AK, brenda një muaji në dy procedura prokurimi. (OE “S.”, shpk). Për sa më sipër kërkohet që AK Bashkia Peshkopi të bëjë rivlerësim të barabartë të procedurës”.

Për shqyrtimin e ankesës së OE ÷E.ö ShPK, nga titullari i AK z. D. I. ka dalë urdhri nr.36/3, datë 07.08.2019, me nr.36/8 prot., me lëndë ÷Pezullimin e procedurës dhe caktimin e anëtarëve të komisionit të shqyrtimit të ankesës, për tenderin me objekt ÷Ndërtim i Shkollës 9-vjeçare, Fshati Kërçisht, Bashkia Dibër, 2019ö. Janë caktuar për shqyrtimin e ankesës: z. F. L., me detyrë specialist i pyjeve, z. D. R., me detyrë specialist-jurist, z. B. D., me detyrë ish specialist i shërbimeve publike.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni i mësipërm ka nxjerrë vendimin nr.1, datë 13.08.2019, me lëndë: Mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik shoqëria ÷E.ö, shpk, me nr.36/9 prot. Në këtë vendim shkurtimisht thuhet:

-Pranimin e ankesë së paraqitur nga OE "E." ShPK.

-Ka rekomanduar KVO që të rivlerësojë procedurën objekt ankimi, duke skualifikuar BOE "S." ShPK & "K." ShPK.

Argumentet e dhëna nga komisioni i shqyrtimit të ankesë lidhen me faktin se një pjesë të makinerive dhe punonjësve për BOE òS.ò ShPK & òK.ò ShPK janë të angazhuar edhe në tenderin òSistemin asfaltim i rrugës se fshatit Melan, NjA Melan, Bashkia Dibër, 2019ò, si rrjedhim nuk i plotëson kriteret për kualifikim.

Pranë grupit të auditimit u paraqit shkresa nr.3867/1 prot., datë 13.08.2019, e titullarit të AK, me lëndë òDërgohet vendimi nr.1, datë 13.08.2019, lidhur me shqyrtimin e formularit të ankesës pranë AK Bashkia Dibërò, drejtuar òBOE òE. & òS.ò ShPK, me përfaqësues z. R. D..

Në datën 15.08.2019, ing. Z. M., përfaqësues i Subjektit òProjektim-Mbikqyrje-Kolaudimò, me NIPT K....., hartues i projektit, specifikimeve teknike dhe preventivit (fondit limit), ka dorëzuar pranë Bashkisë Dibër dokumentin me lëndë òRelacionin Teknik mbi ndryshimin e çmimeve në preventivat e punimeve për objektin: Ndërtim i shkollës 9-vjeçare Kërçishtò, ku midis të tjerash thuhet:

Projekti teknik i shkollës 9-vjeçare Kërçisht, është hartuar në vitin 2018...Meqenëse nga periudha e përgatitjes së preventivit deri në momentin e përgatitjes së këtij relacioni, çmimet e disa zërave të materialeve të parashikuara për tu përdorur në këtë objekt kanë ndryshuar relativisht në mënyrë të ndjeshme, lind nevoja që preventivat e punimeve për këtë objekt të rishikohen. Ky ndryshim është i fokusuar në grupet kryesore të preventivit, të përshkruara si më poshtë:

-Punimet e ndërtimit, -Punimet mekanike, -Punimet elektrike, -Paisjet mekanike dhe elektrike.

Ndryshimet i përkasin vetëm zërave të cilat nuk përfshihen në zërat e manualit të çmimeve, të cilat të detajuara për secilën nga grupet e përmendura më sipër jepen në tabelën bashkëngjitur. Diferenca e vlerës së punimeve dhe paisjeve nga preventivi i rishikuar me preventivin e mëparshëm është 865,717 lekë me TVSH. Informacion i plotë lidhur me ndryshimet si dhe shuma e tyre respektive, jepen në preventivin e rishikuar të punimeve.

Nga hartuesi projektit duhet të ishin bërë ndryshime para zhvillimit të procedurës për herën e parë, e cila përkon me muajin maj 2019.

Në datën 16.08.2019 nga z. A. C., në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimeve, është hartuar informacioni drejtuar titullarit të autoritetit kontraktor z.D. I., ku midis të tjerash thuhet:

"Pasi u njoha me relacionin teknik, në rolin e anëtarit të njësisë së prokurimit, informojë titullarin e autoritetit kontraktor mbi ndryshimet e çmimeve në preventivat e punimeve, për objektin " Ndërtim i Shkollës 9-vjeçare, Fshati Kërçisht, Bashkia Dibër".Teksojmë se diferenca e vlerës së punimeve dhe paisjeve nga preventivi i rishikuar me preventivin e mëparshëm është 865,717 lekë me TVSH më e ulët se preventivi fillestar. Duke qenë se është një shumë e konsiderueshme për buxhetin e shtetit, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë që të shqyrtojë mundësinë ligjore që të rishikohet edhe njëherë procedura e prokurimit, bazuar në preventivin e rishikuar, me qëllim që të menaxhohen dhe të përdoren më mirë fondet publike...".

Me shkresën me lëndë òFormular i njoftimit të anulimitò, nr.36/10 prot datë 22.08.2019, (pasqyruar në sistemin elektronik të APP në datën 23.08.2019), nga titullari i AK z. D. I., është bërë anulimi i procedurës së prokurimit të mësipërme me nr. reference 24489-05-29-2019. Në formular është argumentuar se:

òBazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, Kreu

III, neni 24 ÷ Anullimi i një procedure prokurimi, pika 1 ÷ Autoriteti Kontraktor anulon procedurën vetëm, paragrafi a) për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik.

Nga verifikimi i bere lidhur me përputhshmërinë e çmimeve të zërave pjesë e preventivit të punimeve (punime ndërtimi, elektrike, hidraulike dhe mekanike), me manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre pjesë e VKM nr 629, datë 15.09.2015, si dhe bazuar në verifikimin e bërë lidhur me përputhshmërinë e çmimeve të zërave pjesë e preventivit të punimeve të përfuara nëpërmjet çmimeve të testuar në treg, (zëra të cilat nuk gjenden në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre), u konkludua që ka diferenca të pajustificuara në vlerën totale të preventivit të punimeve pjesë e procedurës objekt anulimi, gjë e cila është e papranueshme dhe jo në përputhje me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ÷ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar. Theksojmë se pas korrigjimit të gabimeve të konstatuara, AK Bashkia Dibër do të ripublikojë në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) procedurën objekt anulimi. Data e shpërndarjes së këtij njoftimi 22.08.2019.

Mos llogaritja e saktë e fondit limit dhe nevoja për rishikim të tij, ngarkon me përgjegjësi subjektin studio ÷ Projektim-Mbikqyrje-Kolaudim, me përfaqësues ing. Z. M., me NIPT K.....B, bazuar kjo në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998, ÷ Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, neni 5 ku thuhet:

“Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit”.

Hartuesi i projektit duhet të kishte ndërhyrë për korrigjimin e fondit limit qysh në muajin maj 2019, kur është filluar procedura për herën e parë.

Pra për herën e parë të zhvillimit të procedurës së prokurimit, procedura nuk duhet të ishte filluar të zhvillohej e të hidhej në sistem, pa u verifikuar dhe pa u marrë në dorëzim projekti nga njësia vendore (së bashku me të edhe preventivi), pa miratimin e projektit, specifikimeve teknike, preventivit nga Autoriteti Kontraktor, pa zhvillur procedurë prokurimi për hartimin e projektit (brenda të cilit përfshihet dhe preventivi, pra fondi limit, pa hartimin e një kontrate midis bashkisë dhe hartuesit të projektit ku të përcaktoheshin të drejtat dhe detyrimet dypalëshe, pa një akt dhurimi për projektin midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër dhe hartuesit të projektit z. Z. M.. Edhe për herën e dytë, nuk janë kryer këto veprime, përveçse është miratuar preventivi nga titullari i AK. Pra edhe për herën e dytë tenderi nuk duhet të ishte filluar të zhvillohej pa kruer veprimet e mësipërme. Anullimi i procedurës në fazën e klasifikimit të ofertave, edhe pse ka një argument nga hartuesi i projektit për llogaritje të gabuar të fondit limit, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. D. I., nuk duhet të ishte kryer, edhe pse në kushtet e një mungese përvoje (muaji i parë i fillimit të punës si kryetar bashkie). Gjithashtu nga anëtarë i njësive së prokurimit z. A. C. nuk duhet të ishte propozuar titullarit për rishikimin edhe njëherë të procedurës së prokurimit, bazuar në preventivin e rishikuar.

Fillimi i procedurës në sistem për herën e dytë është bërë në datën 23.09.2019.

Preventivi me vlerë 44,552,166 lekë është hartuar nga ing. Z. M., me NIPT K.....B, miratuar nga kryetari i bashkisë z. D. I.. Projekti nuk ka datë miratimi.

Për hartimin e projektit nuk është zhvilluar procedurë prokurimi. Nuk ka kontratë të lidhur midis AK Bashkia Dibër dhe hartuesit të mësipërm të projektit ku të përcaktohen detyrimet dhe të drejtat kontraktuale midis palëve. Gjithashtu nuk ka akt dhurimi, që të shpjegojë marrëdhënien e njësisë vendore me subjektin privat të mësipërm lidhur me projektin dhe preventivin.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. R. K., z. I. S., z. E. S. të tre anëtarë të KVO, z. Z. M., përfaqësues i subjektit Projektim-Mbikqyrje-Kolaudimö, me NIPT K.....B, hartues i preventivit (fondit limit), z. A. C. në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, si dhe titullari i AK z. D. I..

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për Prokurimin Publikö i ndryshuar, Kreu III, neni 24 dhe neni 66 i VKM 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö, i ndryshuar, ligjin nr.8402, datë 10.9.1998, ÷Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitö, neni nr.5.

Ndikimi/Efekti: Mos respektim i rregullave të procedurave të prokurimit publik.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit rregullator në fuqi

Rëndësia: E lartë

Rekomandim Për të eliminuar raste të tilla, AK duhet të zbatoj me korrektësi rregullat e prokurimit publik. Nëse është i pa qartë duhet ti drejtohet për konsulencë APP. Anullimi i procedurës bëhet vetmë në rastet kur parashikohet nga LPP.

V. Procedura të audituara, të cilat për shkak se nuk kanë mbartur anomali si në hartimin e kritereve të veçanta të DST edhe në vlerësimin e ofertave, nuk gjejnë pasqyrim në këtë raport:

1- Procedura e prokurimit me objekt ÷Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Melan, NjA Melan, Bashkia Dibërö, me vlerë të fondit limit 21,919,024 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.07.2019.

2- Procedura e prokurimit me objekt ÷Blerje karburant (naftë) për nevojat e Bashkisë Dibër, për vitin 2019ö, me vlerë të fondit limit 10,833,333lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.01.2019.

Në zbatim të programit të ri-auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 99/1 prot, datë 04.02.2021, për periudhën nga 01.01.2020 deri më 31.12.2020, janë audituar 6 procedura prokurimi me fond limit, si më poshtë:

1. Blerje bazë materiale ndërtimi për qëndrën balneare, Peshkopi, 4,833,333 lekë;
2. Furnizim me ujë nga burimi Gramës për Ujësjellësin e Peshkopisë, 650,000,000 lekë;
3. Rehabilitimi i Digës së Gramës-Bashkia Peshkopi, 47,426,209 lekë;
4. Blerje Tонера për nevojat e Bashkisë Diber, viti 2020, 1,833,333 lekë;
5. Sistemim asfaltim lagje Bulke-Begjunec, blloku 6-katësh Ltot=1730ml, 45,416,667 lekë;
6. Ndërtim linje e furnizimit me ujë, Gurra Epërme-Luzni-Peshkopi, 208,333,333 lekë.

Shuma totale e fondit limit të prokuruar në këto 6 objekte është 957,842,542 lekë.

Procedurat e prokurimit të zhvilluara në vitin 2020, do të auditohen në auditimin e rradhës së Bashkisë Dibër.

Procedurat me vlera të vogla.

1. **Për vitin 2018** janë zhvilluar gjithsej 26 procedura me vlerë të vogël me fond limit në shumën 13,467,611 lekë , me vlerë të fituar në shumën 11,517,706 lekë.

2. **Për vitin 2019** janë zhvilluar gjithsej 26 procedura me vlerë të vogël me fond limit në shumën 12,007,147 lekë , me vlerë të fituar në shumën 11,013,813 lekë.

3. **Për periudhën janar - qershor 2020** janë zhvilluar gjithsej 6 procedura me vlerë të vogël me fond limit në shumën 3,764,595 lekë, me vlerë të fituar në shumën 2,825,423 lekë.

Titulli i Gjetjes Në njëprocedurë blerje e vogël u konstatua se operatori ekonomik I shpallur fitues, është tërhequr nga procedura pasi është lidhur kontrata, duke sjellë mos realizim i kontratës së nënshkruar.

Situata: Nga auditimi me përzgjedhje të procedurave të prokurimit me vlera të vogla u konstatua se:

1. Nga ana e Ak është zhvilluar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: **“Shërbim Interneti për Njësiti Administrative për vitin 2018”** në vitin 2018 me urdhër prokurimi nr. 4/1, datë 09.03.2018 me fond limit 800,000 lekë pa tvsh. Në përfundim të procedurave të ndjekura nga ana e KVO është shpallur fitues OE òN.ò ShPK me vlerë të ofertës 599,000 lekë pa TVSH. Në Proces-Verbalin nr. 3 datë 13.03.2018 të mbajtur nga ana e Komisionit të Blerjeve të Vogla (KBV) është pasqyruar hapja e ofertave ku ka rezultuar 7 (shtatë) operator pjesëmarrës ku renditja është si më poshtë:

<i>Nr.</i>	<i>Operatori pjesëmarrës</i>	<i>ekonomik</i>	<i>Oferta ekonomike (pa TVSh)</i>
1	M.		598,000
2	N.		599,000
3	A. sha		704,000
4	F. A.		777,777
5	F.		779,000
6	I.		788,000
7	A.		800,000

Me proces-Verbalin nr. 4 datë 16.03.2018 nga ana e KBV pasi është bërë njoftimi i OE òM.ò për paraqitje është konstatuar se ky OE nuk është paraqitur pranë AK dhe nuk ka bërë asnjë njoftim zyrtar brenda afateve kohore të përcaktuara. Për rrjedhojë KBV vendosi të njoftojë OE òN.ò i renditur i dyti me ofertë në vlerën 599,000 lekë gjë e cila është konfirmuar dhe në Raportin Përmbledhës me nr. 4/10 prot., datë 16.03.2018 i miratuar me shkresën nr. 4/11 datë 16.03.2018. Formulari i Kontratës është mbajtur sipas shkresës nr. 04/12 prot., datë 16.03.2018 e cila është firmosur nga AK dhe nga OE òN.ò i shpallur fitues. Në inventarin e dosjes së prokurimit ndodhet e shënuar me numër rendor 14 Vendimi i anulimit të procedurës së tenderit po bashkëlidhur nuk ndodhet asnjë dokument. Nga ana e sektorit të Financës nuk ndodhet asnjë dokumentacion nën administrim lidhur me këtë procedurë sidhe nuk është lëshuar asnjë Urdhër Shpenzim për subjektin òN.ò. Edhe pse është nënshkruar kontrata nga të dyja palët nuk disponohet asnjë dokumentacion që vërteton kryerjen e shërbimit dhe realizimin e tij.

Me Urdhër Prokurimi nr. 5/1 datë 23.03.2018 është zhvilluar procedura ëBlerje shërbim Interneti për nevojat e Njësive Administrative për vitin 2018” me fond limit në vlerën 800,000 lekë pa tvsh. Në përfundim të procedurave të ndjekura nga ana e KBV është shpallur fitues OE òA.ò ShPK me vlerë të ofertës 704,000 lekë pa TVSH. Në Proces-Verbalin nr. 3 datë 26.03.2018 të mbajtur nga ana e Komisionit të Blerjeve të Vogla (KBV) është pasqyruar hapja e ofertave ku ka rezultuar 5 (pesë) operator pjesëmarrës ku renditja është si më poshtë:

<i>Nr.</i>	<i>Operatori pjesëmarrës ekonomik</i>	<i>Oferta ekonomike (pa TVSh)</i>
<i>1</i>	<i>A.</i>	<i>650,000</i>
<i>2</i>	<i>F. A.</i>	<i>666,666</i>
<i>3</i>	<i>A. sha</i>	<i>704,000</i>
<i>4</i>	<i>S. K.</i>	<i>799,000</i>
<i>5</i>	<i>ABCOM</i>	<i>800,000</i>

Me proces-Verbalin nr. 4 datë 27.03.2018 nga ana e KBV pasi është bërë njoftimi i OE òA.ò për paraqitje është konstatuar se ky OE nuk është paraqitur pranë AK dhe nuk ka bërë asnjë njoftim zyrtar brenda afateve kohore të përcaktuara. Për rrjedhojë KBV vendosi të njoftojë OE òF. A.ò i radhatur i dyti me ofertë në vlerën 666,666 lekë. Në Proces Verbalin nr. 5 datë 29.03.2018 nga ana e KBV është konstatuar se OE òF. A.ò është paraqitur pranë Ak sidhe nuk ka bërë njoftim zyrtar dhe për këtë fakt është skualifikuar dhe është njoftuar OE òA.ò i radhatur i treti me vlerë oferte 704,000 lekë për paraqitje gjë e cila është konfirmuar dhe në Raportin Përmbledhës me nr. 05/04 prot., datë 29.03.2018 i miratuar me shkresën nr. 05/05 datë 29.03.2018.

Formulari i Kontratës është mbajtur sipas shkresës nr. 05/6 prot., datë 29.03.2018 e cila është firmosur nga Ak dhe nga OE òA.ò i shpallur fitues.

Nga ana e AK nuk është marrë asnjë masë për përmbushjen e detyrimeve ligjore të përcaktuara në LPP për OE i cili duhet të njoftonte brenda 3 muajve nga konstatimi në APP për përjashtim nga procedurat e prokurimit shoqërinë “N.” bazuar:

a.Në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publik i ndryshuar konkretisht: - nenit ë- Agjencia e Prokurimit Publik ku përcaktohet se: Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, pavarësisht nga çështja penale, që mund të ketë filluar, për një periudhë nga 1 deri në 3 vjet për

- pika 3ç ó mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit

b.Në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikòi ndryshuar, Neni 77 Mbikëqyrja e kontratës konkretisht:

-Pika 2. Mospërmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit ë të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj , përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë.

Në zbatim të LPP dhe të Udhëzimit nr. 914 datë 29.12.2014 për veprimet dhe mosveprimet e mësipërmengarkojnë me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit e përbërë nga: z.F. K., znj.I. S. dhe z.N. S..

Kriteri: Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, neni ë, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 77 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos kryerje e shërbimit në kohë dhe zhvillim i përsëritur i procedurës, mos penalizim i OE i cili nuk ka respektuar procedurat e prokurimit public.

Shkaku: Mos respektim të procedurave të prokurimit publik

Rëndësia: E lartë

-Përsa ju përket procedurave të tjera me vlera të vogla të audituara u konstatua se:

- Në procedurat e audituara të formës së prokurimit oBlerje me vlerë të vogël, fondi limit nuk ka qenë mbi 800,000 lekë pa TVSH, pra mbi kufirin monetar të përcaktuar me vendimin e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 oPër rregullat e prokurimit publik, kreu II, pika 2 si dhe udhëzimin e APP nr. 3, datë 08.01.2018 oPër procedurën e prokurimit me vlera të vogla të ndryshuar.

-Shpallja elektronike në sistem e procedurës, është realizuar në kohën e përcaktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël në të gjitha rastet, pasi kanë krijuar në sistem dosjen e tenderit, u janë drejtuar nëpërmjet ftesës për ofertë (sipas formularit nr. 3), 5 (pesë) operatorëve ekonomikë për një periudhë 1-2 ditë nga nxjerrja e urdhrat të prokurimit.

- Nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është zbatuar limiti i përcaktuar për prokurimet me vlera të vogla i cili nuk është tejkaluar.

- Miratimi i kërkesës për prokurim në të gjitha rastet janë miratuar nga Nëpunësi i Autorizuar i AK.

- Në të gjitha rastet e audituara nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, është mbajtur procesverbal për shpalljen e OE fitues, mbi bazën e ofertës më të ulët të shpallur nga sistemi.

- Në të gjitha rastet e audituara është zbatuar kriteri i çmimit më të ulët për klasifikimin përfundimtar.

-Në të gjitha rastet e audituara OE fitues është njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik. Në rastet e tërheqjes së ofertave të vendeve të para është dokumentuar me shkresat zyrtare nga operatorët ose printimit nga sistemi i emali-ve të kryera nga AK(njoftimi) dhe OE(përgjigja).

- Për të gjitha rastet e blerjeve si për shërbimet dhe mallrat është kryer procesi i marrjes në dorëzim të mallit dhe shërbimit nga komisioni i ngritur për çdo rast nga sektori përkatës i cili ka dorëzuar kërkesën për zhvillim prokurimit.

D.2. Hartimi dhe zbatimi i kontratave të punëve publike

1. “Rikonstrukcion i godinave në pronësi të Njërive të Qeverisjes Vendore për strehim social”, Bashkia Dibër

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 48/9 prot datë 20.11.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër, të përfaqësuar nga Titullari z. M. R.dhe Operatorit Ekonomik oR.ö SHPK, me përfaqësues z. B. T., me licencë profesionale NZ..... Vlera e kontratës është 6,556,906 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 30 ditë kalendarike nga data e fillimit të punimeve.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr 54/10, datë 16.11.2018, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me ing. A. B., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK....dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 81,197 lekë pa tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, në bazë të aktit të kolaudimit, është caktuar OE oD.öSHPK, me përfaqësues z. V. T. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. Në dosje mungon kontrata për shërbimin e kolaudimit.

Projektpreventivi

Projekti për adaptimin për banesë sociale nga objekt ish Parku auto Peshkopi nga kati I deri në katin III është hartuar nga shoqëria oH&Sö SHPK. Është hartuar nga zyra e Urbanistikës së Bashkisë Dibër, ndryshimi i planimetrisë së katit përdhe (objekti në auditim) në vitin 2017,

i cili është firmosur vetëm nga ing. E. S. dhe nuk është miratuar nga titullari i AK. Në dosje nuk administrohet leja e ndërtimit për këtë objekt.

Për mangësitë e trajtuara sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Autoriteti Kontraktor.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 26.11.2018 dhe kanë përfunduar me datë 20.12.2018, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Me shkresën e protokolluar me nr. 4997/1, datë 14.12.2018, është kërkuar nga mbikëqyrësi miratimi i volumeve të ndryshuara, të cilat janë miratuar me shkresën e titullarit të Bashkisë Dibër, me nr. 4997/2, datë 18.12.2018. Preventivi i rishikuar dhe tabela e ndryshimit të volumeve (3,051,636 lekë me TVSH punime që hiqen dhe 4,363,010 lekë me TVSH punime që shtohen) që administrohen në dosje, nuk janë të nënshkruara nga titullari i AK. Nga auditimi i tabelës së mësipërme, rezulton se preventivi i rishikuar është 7,868,280 lekë më TVSH, ose 1,311,374 lekë më shumë se vlera e kontratës.

Nga verifikimi i situacionit përfundimtar, projektit të ndryshuar, librit të masave dhe verifikimi në terren, rezulton se në objekt nuk janë kryer zërat e punës: dyer të brendshme, shtresa e pllakave, vendosje ËC, lavamanë, lysterje, etj., duke i zëvendësuar me punime të tjera dhe duke detyruar përfituesit e këtyre banesave të bëjnë përfundimin e punimeve. Me këtë mosveprim nuk arrihet objektivi për të cilin është bërë investimi dhe efektiviteti i plotë i investimit, strehimi i familjeve në nevojë.

Komisioni i marrjes në dorëzim, i ngritur me urdhrin e titullarit nr. 222, datë 24.12.2018, i përbërë nga E. S., M. M. dhe D. R., ka marrë në dorëzim objektin me aktin e datës 26.12.2018, duke cituar që ò... *objekti është kolauduar dhe funksionon normalisht*. Nga sa është trajtuar më sipër, ky objekt nuk është funksional dhe komisioni nuk ka shprehur realitetin.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim të objektit me përbërje E. S., M. M. dhe D. R..

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projektpreventivi, Projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libri i masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion i godinave në pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore për strehim social", Bashkia Dibër		
14. Lidhja e kontratës nr. 48/9 prot datë 20.11.2018	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 6,556,906 lekë OE fitues "R." SHPK	16. Likuiduar deri dt 28.12.2018 6,556,896 lekë
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 6,556,896 lekë -Vlera pa tvsh 5,464,080 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 30 ditë, Zbatuar 24 ditë. Fillimi punimeve: 26.11.2018 Përfundimi punimeve : 20.12.2018	19. Zgjatja e kontratës Nuk ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE ing. A. B.	Licenca Nr: MK....	Kontrata me nr 54/10, datë 16.11.2018
21. Kolaudatori i punimeve D.	Licenca Nr: MK	Kontrata, Nuk ka
22. Akt Kolaudimi Dt. 22.12.2018	23. Akt i marrjes në dorëzim Datë 26.12.2018	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti

Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **336,610 lekë pa TVSH.**

Titulli i Gjetjes 1&2:	Diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera në objektin òRikonstruksion i godinave në pronësi të Njësisë të Qeverisjes Vendore për strehim socialö, Bashkia Dibër, nga zbatuesi i punimeve òR.ö SHPK, në zërat e punimeve I.8, II.1, II.8 dhe II.11.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punësöFV tub shkarkimi lavamaniö, öSuvatime të brendshmeö dhe FV dyer të jashtme të blinduara, çmimiö, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 öPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiö, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 öPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitö e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 48/9 prot datë 20.11.2018. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit nr. 54/10, datë 16.11.2018. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve,nëse ka patur.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Dibër në vlerën 336,610 lekë pa tvsh.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim,në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I ulët.
Rekomandime:	Nga Bashkia Dibër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 336,610lekëpa tvsh nga OE òR.ö SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 48/9 prot datë 20.11.2018 me òRikonstruksion i godinave në pronësi të Njësisë të Qeverisjes Vendore për strehim social”, <i>Bashkia Dibër</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Vlera prej 336,610lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Dibër.Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A. B. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. V. T. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën me logon e Bashkisë Dibër nr. 2646 prot, datë 30.07.2020, por e pavulosur nga Bashkia, është observuar nga z. D. R., në cilësinë e anëtarit të marrjes në dorëzim të objektit, me profesion jurist, si më poshtë:
ö... Në cilësinë e juristit, në konfirmimin e marrjes në dorëzim, unë jam bazuar mbi procesverbalin öMbi përfundimin e punimeveö në objektin òRikonstruksion i godinave në

pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore për strehim socialö, Bashkia Dibër, i mbajtur më datë 20.12.2018 nga ana e Mbikëqyrësit të punimeve ing. A. B. dhe sipërmarrësit òR.ö SHPK, përfaqësuar nga X. S..

Jam bazuar gjithashtu në deklaratën òMbi përfundimin dhe dorëzimin e objektit òRikonstrukcion i godinave në pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore për strehim socialö, Bashkia Dibër, të mbajtur më datë 20.12.2018 nga ana e Mbikëqyrësit të punimeve ing. A. B. dhe në Aktkolaudimin e datës 22.12.2018 nga Kolaudatori i Punimeve òD.ö SHPK, përfaqësuar nga ing. V. T.

... Citova faktin se jam jurist, për arsyen se konfirmimin tim për marrjen në dorëzim të objektit e kam kryer mbi bazë aktesh, kurse verifikimin në terren të zërave të punimeve e kryejnë inxhinierët, të cilët janë specialistët e fushës dhe mund ti konstatojnë parregullsitë në terrenö.

Opinion i grupit të auditimit:

1. Përsa i përket trajtimit të marrjes në dorëzim të objektit dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga parregullsitë e konstatuara, grupi i auditimit ka cilësuar se ò... në objekt nuk janë kryer zërat e punës: dyer të brendshme, shtresa e pllakave, vendosje ËC, lavamanë, lyerje, etj., duke i zëvendësuar me punime të tjera dhe duke detyruar përfituesit e këtyre banesave të bëjnë përfundimin e punimeve. Me këtë mosveprim nuk arrihet objektivi për të cilin është bërë investimi dhe efektiviteti i plotë i investimit, strehimi i familjeve në nevojë.”, duke ngarkuar me përgjegjësi të gjithë grupin e punës të ngritur për këtë qëllim. Ky grup pune, përfshirë edhe ju që e keni pranuar të jeni pjesë e tij, pavarësisht profesionit, duhet të bënte vizitën në objekt dhe të cilësonte konstatimin e bërë nga ana jonë, që mungojnë zërat jetësorë të punimeve për të bërë objektin efektiv dhe nuk është arritur objektivi për të cilin është bërë investimi. Përsa sipër, pretendimi i ngritur në observacion nuk merret në konsideratë.

2. “Sistemim Asfaltim i lagjes Llixha – Banjë- Bunisht, Nj.A. Peshkopi”, Bashkia Dibër

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 35/13 prot datë 01.08.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër, të përfaqësuar nga Titullari z. M. R.dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë òE.ö SHPK& òS.2.ö SHPK, me përfaqësues z. B. R. nga OE òE.ö SHPK, me licencë profesionale NZ..... Vlera e kontratës është 11,066,666 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 javë kalendarike nga data e fillimit të punimeve.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr 32/6, datë 24.09.2019, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE òU. S.öSHPK, me përfaqësues z. L.B., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.... dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 245,861 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr 7/16, datë 02.12.2019, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE òE.öSHPK, me përfaqësues z. E. T. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.... dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 0 lekë.

Projektpreventivi

Në dosje administrohet leja e ndërtimit për këtë objekt me nr. 2199/1, datë 06.05.2019 (paraqitur nga mbikëqyrësi bashkëlidhur observacionit).

Projektpreventivi i objektit është hartuar nga shoqëria òE.B.S.ö SHPK, në vitin 2019. Me shkresën nr. 261, datë 11.06.2019, mbikëqyrësi i punimeve ka vënë në dijeni AK, projektuesin dhe zbatuesin për mospërputhjet ndërmjet projektit të zbatimit dhe preventivit. Janë bërë ndryshimet dhe është hartuar preventivi i ripunuar nga mbikëqyrësi. Me shkresën

nr. 262, datë 12.06.2019 është kërkuar nga mbikëqyrësi i punimeve shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve për aq kohë sa do të kërkohej për aprovimin e ndryshimeve. Në dosje nuk administrohet asnjë amendament për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve të nënshkruar nga AK.

Për mangësitë e trajtuara sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Autoriteti Kontraktor.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 27.05.2019 dhe kanë përfunduar me datë 18.09.2019, ose 66 ditë jashtëafatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projektpreventivi, Projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libri i masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Sistemim Asfaltim i lagjes Llixha - Banjë- Bunisht, Nj.A. Peshkopi", Bashkia Dibër		
14. Lidhja e kontratës nr. 35/13 prot datë 01.08.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 11,066,666 lekë BOE fitues "E." SHPK & "S.2." SHPK	16. Likuiduar deri dt
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 11,066,617 lekë -Vlera pa tvsh 9,222,180 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 45 ditë, Zbatuar 111 ditë. Fillimi punimeve: 27.05.2018 Përfundimi punimeve : 18.09.2019	19. Zgjatja e kontratës Nuk ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "U. S." SHPK	Licenca Nr: MK...	Kontrata me nr 32/6, datë 24.09.2019
21. Kolaudatori i punimeve "E." SHPK	Licenca Nr: MK...	Kontrata me nr. 7/16, datë 02.12.2019
22. Akt Kolaudimi datë 28.02.2020	23. Akt i marrjes në dorëzim datë 28.02.2020	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **250,150 lekë pa tvsh.**

Titulli i Gjetjes 1&2:	Diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera në objektin "Sistemim Asfaltim i lagjes Llixha ó Banjë- Bunisht, Nj.A. Peshkopi, Bashkia Dibër, nga zbatuesi i punimeve "E.ö SHPK & "S.2.ö SHPK, për zërat e punimeve 1.5, 2.1 dhe 2.2.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punimeve "Transport zhavorri me auto deri 2 kmö, "Transport betoni me autobetonierë 2.5 kmö dhe "Strukturë monolite betoni C 10/15 për murin+kanalö, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 35/13 prot datë

	01.08.2019. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 32/6, datë 24.09.2019. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr.7/16, datë 02.12.2019.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Dibër.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I ulët.
Rekomandime:	Nga Bashkia Dibër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 250,150 lekë pa tvsh nga BOE fitues òE.ò SHPK & òS.2.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 35/13 prot datë 01.08.2019 me òSistemim Asfaltim i lagjes Llixha ó Banjë- Bunisht, Nj.A. Peshkopi”, <i>Bashkia Dibër</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Vlera prej 250,150 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Dibër.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. L.B. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. E. T. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

3. “Sistemim Asfaltim i rrugës së fshatit Melan, Nj.A Melan”, Bashkia Dibër

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 35/13 prot datë 01.08.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër, të përfaqësuar nga Titullari z. M. R. dhe Operatorit Ekonomik òS.ò SHPK, me përfaqësues z. M. S., me licencë profesionale NZ..... Vlera e kontratës është 19,230,565 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 90 ditë kalendarike nga data e fillimit të punimeve.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr 52/6, datë 24.09.2019, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE òR.ò SHPK, me përfaqësues znj. R.N., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.... dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 319,994 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është emëruar nga AK, ing. I. S., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.....Në dosje mungon kontrata me kolaudatorin.

Projektpreventivi

Në dosje nuk administrohet leja e ndërtimit për këtë objekt.

Projektpreventivi i objektit është hartuar nga ing. Z. M., në vitin 2019.

Për mangësitë e trajtuara sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Autoriteti Kontraktor.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 24.09.2019 dhe kanë përfunduar me datë 04.11.2019, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Është mbajtur procesverbal ndërmjet sipërmarrësit, mbikëqyrësit të punimeve dhe titullarit të institucionit për punimet që shtohen dhe hiqen (549,233 lekë pa TVSH) në datën 18.10.2019, si dhe të përdorimit të fondit rezervë, në vlerë 587,263 lekë pa TVSH.

Nga situacionin përfundimtar dhe librin e masave rezulton se tubat e çelikut janë me d=325 mm x 5.6 mm trashësi, të h/izoluar në fabrikë, me nr. analize 2.a60/1, me peshë 1.68 ton dhe vlerë 272,472 lekë pa TVSH. Në manualin e çmimeve të ndërtimit, zëri 2.a60/1 citohet *“Hidroizolimi tubave të çelikut bëhet direkt në fabrikë, nga jashtë me bitum të armuar, me shirit voal qelqi 3.5-8mm, nga brenda me llak capitol "BLC", rrëshirë epoksike me trashësi 100-300µö, ndërkohë që nga verifikimi në objekt, rezulton se tubi i vendosur, nga jashtë nuk është si i përshkruar në manual, si dhe i pahidroizoluar më llak nga brenda.*

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projektpreventivi, Projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libri i masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemim Asfaltim i rrugës së fshatit Melan, Nj.A Melan”, Bashkia Dibër		
14.Lidhja e kontratës nr. 35/13 prot datë 01.08.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 19,230,565 lekë OE fitues “S.” SHPK	16.Likuiduar deri dt
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 19,019,540 lekë -Vlera pa tvsh 15,849,617 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 90 ditë, Zbatuar 41 ditë. Fillimi punimeve: 24.09.2018 Përfundimi punimeve : 04.11.2019	19. Zgjatja e kontratës Nuk ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “R.” SHPK	Licenca Nr: MK...	Kontrata me nr 52/6, datë 24.09.2019
21. Kolaudatori i punimeve Ing. I. S.	Licenca Nr: MK...	Kontrata, Nuk ka
22.Akt Kolaudimi datë 28.02.2020	23.Akt i marrjes në dorëzim datë 28.02.2020	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt (verifikimi i ktyre punimeve sht kryer pa prezencn e mbikqyrësit dhe kolaudatorit t punimeve, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,151,623 lekë pa tvsh.**

Titulli i Gjetjes 1&2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin <i>“Sistemim Asfaltim i rrugës së fshatit Melan, Nj.A Melanö, Bashkia Dibër, nga zbatuesi i punimeve OE <i>“S.ö SHPK, për zërat e punimeve I.1, I.4, III.4, III.5, III,7, III.9 dhe III.12.</i></i>
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës <i>“Gërmim dheu në trup rruge + kanal me eskavatorö, <i>“Mbjellje bari në skarpatat e gërmimit dhe mbushjesö, <i>“Gabione me rrjet teli të zinkuar, gur kave 1x1x1 mö, <i>“Kunetë betoni M-200ö,<i>“Struktura monolite butobetoni me 20% gur, muret mbajtëse dhe uraö, <i>“H/betoni për soletën e urës dhe jastëkët <i>“Ø>10 mmö dhe <i>“Beton M-200 pr kokat e tombinoveö, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</i></i></i></i></i></i></i></i>
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 <i>“Për Kontrollin dhe Disiplininim e Punimeve</i>

	<p>të Ndërtimiö, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.</p> <p>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitö e konkretisht Kreu II, Pika 3.</p> <p>- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 35/13 prot datë 01.08.2019.</p> <p>- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr 52/6, datë 24.09.2019.</p> <p>- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, nëse ka patur.</p>
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Dibër.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim, në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga Bashkia Dibër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,151,623lekë pa tvsh nga OE òS.ö SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 35/13 prot datë 01.08.2019 me òSistemim Asfaltim i rrugës së fshatit Melan, Nj.A Melan”, <i>Bashkia Dibër</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Vlera prej 1,151,623 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Dibër.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. R.N. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. I. S. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

4. “Punime, ndërtime, rehabilitime dhe mirëmbajtje të kanaleve ujitëse”, Bashkia Dibër

a. Të përgjithshme mbi objektin dhe afatet sipas kontratës

- Objekti është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 11/11 prot datë 18.06.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër, të përfaqësuar nga Titullari z. M. R. dhe operatorit ekonomikë òE." SHPK, me përfaqësues z. R. D.. Vlera e kontratës është 11,614,380 lekë me TVSH dhe afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 25 ditë kalendarike nga data e fillimit të punimeve.

Me procesverbalin e datës **27.06.2018**, mbikëqyrësi i punimeve ka dorëzuar projekt-zbatimin e kontratës. Me procesverbalin e fillimit të punimeve datë 27.06.2018, mbajtur midis sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit të punimeve, konstatohet se fillojnë punimet në objekt. Me amendimin e kontratës nr. 11/13 datë 27.06.2018, palët AK dhe sipërmarrësi miratojnë fillimin e punimeve me afat realizimi prej 25 ditësh. Akti i piketimit është mbajtur më datë 27.06.2018.

- Me shkresën e dërguar nga sipërmarrësi i punimeve datë 17.07.2018, njoftohet pezullimi i punimeve. Sipërmarrësi me shkresën nr. 3110 prot. datë 17.07.2019, drejtuar Bashkisë Dibër, kërkon ndërhyrje për zgjidhje konflikti nga banorët e zonës të fshatit Begjunec, të cilët kanë dëmtuar bazën materiale. Për këtë konflikt është njoftuar policia e zonës dhe përfaqësues të bashkisë dhe rifillimi i punës është rihatur me rezistencën e banorëve, për vaditjen e zonës.

- Me procesverbalin e datës 17.07.2018, ndërpriten punimet të miratuara nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe Titullari i Bashkisë Dibër, deri në përfundimin e sezonit të ujitjes.

- Njoftimi i rifillimit të punimeve është realizuar më datë 07.09.2019, i njoftuar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

- Njoftimi i përfundimit të punimeve është realizuar me shkresën nr. 3819 prot. datë 12.09.2018.

Pra, nga data 27.06.2018 deri 17.07.2018, rezultojnë 20 ditë pune, nga data 07.09.2018 deri 12.09.2018, rezultojnë 5ditë pune, në total 25 ditë pune, brenda afateve kontraktuale.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur përcaktuar shoqëria òD.ò SHPK, me përfaqësues z. N. V.. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është përcaktuar nga Ing. V. Z.. Në dosje nuk administrohet leja e ndërtimit për këtë objekt.

b. Mbi zbatimin e punimeve

- Me shkresën e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit nr. 3111 prot. datë 17.07.2018, kërkohet miratimi i ndryshimeve në preventiv për ndryshimet e volumeve të punës.

- Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, të trajtuara më poshtë.

1. Zëri nr. 1, nr. analiz 3.87/b " Gërmim dheu me eskavator goma, 0.25m3, me shk në tokë për pastrim shembje dhe mbetje urbane, kanali furnizuar", në kapitullin e kanali sete-fushë-alije-kandër. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 200 m³. Në librin e masave, ky zë pune, nuk figuron i argumentuar, i justifikuar apo i përlllogaritur. Në librezat e masave janë llogaritur gërmime të tjera si zëri nr. 2 në sasinë 396 m3, zëri nr. 9 në sasinë 260 m3, zëri nr. 10 në sasinë 100 m3 dhe zëri nr. 11 në sasinë 104 m3. Nga verifikimi konstatohet se zëri nr. 1 është i mbivendosur dhe i paargumentuar, për pasojë ky volum pune nuk duhej situacionuar dhe vlera e tij është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri 6 "FV tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=400mm", në kapitullin e Vija e Somaticës, vija e madhe dhe vija e verendit dohoshisht. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 18 ml me çmimin 6,700 lek/ml. Çmimi për FV tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=400mm, konstatohet me ndryshime në kapitullin e kanalit trene-selane dhe në kanalin e liqenit shumbat me cmim prej 4,500 lek/ml. Rrjedhimisht konstatohen 2 cmime të ndryshme për të njëjtin zë pune me diferencë prej 2,200 lek, i përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi.

Aneksi, diferencat e volumeve pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Çmimi në zërat e tjerë	Diferenca në +	
								Vol./cmim	Vlera
1	Gërmim dheu me eskavator goma, 0.25m3, me shk në tokë për pastrim shembje dhe mbetje urbane, kanali furnizuar	m ³	450	200	-	0		200	90,000
16	FV tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=400mm	ml	6,700	18	18	18	4,500	2,200	39,600
Total									129,600

Për këtë investim rezultoi se janë likuiduar tepër në vlerën **129,600 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve N. V., ku nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit." Nga kolaudatori i punimeve V. Z. nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për

Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve” Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike. b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

3) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr 7/16 prot, datë 03.05.2019.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1) Z. N. V. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

2) Z. V. Z. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Titulli i Gjetjes 4:	Diferenca në volume në objektin ÷Punime, ndërtime, rehabilitime dhe mirëmbajtje të kanaleve ujtëseö, Bashkia Dibër.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punimeve ÷Gërmim dheu me eskavator goma, 0.25m ³ , me shk në tokë për pastrim shembje dhe mbetje urbane, kanali furnizuarö, dhe ÷FV tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=400mm, ÷, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ÷Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiö, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ÷Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitö e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 35/13 prot datë 01.08.2019. Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 32/6, datë 24.09.2019. Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 7/16, datë 02.12.2019.
Ndikimi/Efekti:	Dëme ekonomike në vlerën 129,600 lekë pa tvsh.
Shkaku:	Pasaktësi nga mbikëqyrësi i punimeve në situacionin përfundimtar
Rëndësia:	I Lartë.
Rekomandime:	Bashkia Dibër të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 129,600 lekë, nga sipërmarrësi i punimeve.

5. “Mirëmbajtje dimërore e rrugëve rurale 2019”, Bashkia Dibër

a. Të përgjithshme mbi objektin afatet dhe marrja në dorëzim

- Objekti është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 51/19 prot datë 27.12.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër, të përfaqësuar nga Titullari z. D. I. dhe operatorit ekonomikë ÷S. SHPK, me përfaqësues z. Aif S.. Vlera e kontratës është 3,860,100 lekë me TVSH dhe afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 12 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër. Objekti i kontratës është realizimi i mirëmbajtjes dimërore

të rrugëve rurale, bashkisë dibër, sipas volumeve të punimeve të parashikuara në preventiv me cmimet e zërat e punës. Në aneksin 1 të preventivit parashikohen vetëm 2 procese pune "Heqja e borës me fadromë" dhe "Hedhje Kripë, skorie, granil, rrafshim, pastrim me krahë. Preventivi i parashikuar paraqitet në formën e mëposhtme:

Nr	Nr. anal	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia	Cmimi
1	73	Heqje Bore	O.P	40 - 112	3,600
2	2.19a	Hedhje Kripë, skorie etj	O.P	25 - 98.5	300

- Për mbikëqyrjen e punimeve, është lidhur kontrata nr. 51/21 datë 30.12.2019 midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër, të përfaqësuar nga Titullari z. D. I. dhe ing. A. B..

- Për kolaudimin e punimeve, është përcaktuar shoqëria "E.", i përfaqësuar ing. G. I. dhe më datë 04.05.2020 realizohet procesverbali i kolaudimit të objektit. Me urdhrin e titullarit nr. 171 prot. datë 17.06.2020, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim i mirëmbajtjes i përbërë nga F. J., L. Q. dhe B. M.. Certifikata e marrjes në dorëzim të punimeve të mirëmbajtjes është realizuar më datë 17.06.2020.

-Kontrata e mirëmbajtjes është realizuar nga data 27.12.2019 deri më datë 30.03.2020, pra për një periduhë 3 mujore është realizuar e gjithë puna prej 12 muajsh. Situacioni përfundimtar është realizuar më datë 31.03.2020 në vlerën e plotë të kontratës prej 3,860,100 lekë me TVSH.

- Nga auditimi i librezës së masave, konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me orët e punës të realizuara nga sipërmarrësi i punimeve. Volumet e përcaktuara me njësinë "**Orë Pune**", janë subjektive dhe nuk kanë asnjë mundësi verifikimi ose mundësi matjeje konkrete. Nga verifikimi i dosjes nuk është realizuar asnjë analizë se si janë matur apo verifikuar orët e punës të realizuara nga sipërmarrësi, por janë marrë të mirëqëna.

- Nuk ekziston asnjë dokumentim i akteve të rrugëve (Kala e Dodës, Sllovë, Kastriot, Tomin, Rec, Zall-Dardhë, Muhurr, Selishtë, Luzni, Melan, Maqellarë, Fushë-Cidhën, Arras, Peshkopi), ku të llogariten orët e punës së realizuar për 1 m² rrugë.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve A. B., ku nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

*"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."*Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 52/6 prot, datë 24.09.2019.

2) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr 51/21 prot, datë 30.12.2019.

Nga kolaudatori i punimeve G. I. nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve" Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike. b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A. B. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

2. Z. G. I. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Titulli i Gjetjes5:	Mos argumentim në lidhje me orët e punës të realizuara nga sipërmarrësi i punimeve
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Kontrata e mirëmbajtjes është realizuar nga data 27.12.2019 deri më datë 30.03.2020, pra për një periudhë 3 mujore është realizuar e gjithë puna prej 12 muajsh. Situacioni përfundimtar është realizuar më datë 31.03.2020 në vlerën e plotë të kontratës prej 3,860,100 lekë me TVSH. Nga auditimi i librezës së masave, konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me orët e punës të realizuara nga sipërmarrësi i punimeve. Volumet e përcaktuara me njësinë " Orë Pune ", janë subjektive dhe nuk kanë asnjë mundësi verifikimi ose mundësi matjeje konkrete. Nga verifikimi i dosjes nuk është realizuar asnjë analizë se si janë matur apo verifikuar orët e punës të realizuara nga sipërmarrësi, por janë marrë të mirëqëna. - Nuk ekziston asnjë dokumentim i akteve të rrugëve (Kala e Dodës, Sllövë, Kastriot, Tomin, Rec, Zall-Dardhë, Muhurr, Selishtë, Luzni, Melan, Maqellarë, Fushë-Cidhën, Arras, Peshkopi), ku të llogariten orët e punës së realizuar për 1 m2 rrugë.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve i padokumentuar saktë me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 òPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimitò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 òPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 35/13 prot datë 01.08.2019. Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 32/6, datë 24.09.2019. Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 7/16, datë 02.12.2019.
Ndikimi/Efekti:	Mos saktësim i vlerës së punimeve.
Shkaku:	Njësia matëse subjektive dhe e pamatshme
Rëndësia:	I Mesëm.
Rekomandime:	Bashkia Dibër të marrë masa në të ardhmen, të ngrejë një grup pune të veçantë, për të analizuar dhe detajuar orët e punës për objektet e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve, në mënyrë që vlera e punës së realizuar të dokumentohet saktë.

E. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

Titulli i Gjetjes:	i	Realizimi i Rekomandimeve për ndryshime ligjore, masa organizative, masa shpërbllim dëmi dhe masave disiplinore, sipas cilësimeve në plan veprimin e hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.
Situata:		Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë: <i>b . Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 13 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 13 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 5 masa, janë në proces zbatimi 6 masa organizative dhe 2 masa nuk ishin zbatuar.(rekomandimi nr. 9 dhe 12-në proces gjyqësor);</i>

c/I. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 9 masa me vlerë 71,835,638 lekë, është pranuar e gjitha por nuk kanë filluar arkëtimet. Janë dërguar njoftimet dhe më pas kanë filluar procedurat gjyqësore, ku në të gjitha rastet janë kthyer kërkesë paditë nga gjykata me të meta të cilat nuk janë plotësuar nga ana e bashkisë Dibër.

c/II. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet në një masë në vlerën prej 134,824,358 lekë, nga të cilat 204,158,386 lekë pa tvsh në procedurat e prokurimit dhe 21,835,715 lekë në procedurat e zbatimit të investimeve. (janë analizuar këto rekomandime dhe rezulton që janë në proces).

c/III. Për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore është dhënë 1 rekomandime në shumën 29,908,406 lekë. (janë arkëtuar 1,658,253 lekë, duke mbetur pa u arkëtuar vlera prej 28,250,154 lekë).

d/I. I janë rekomanduar APP të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për 15 punonjës dhe ish – punonjës.

Nga verifikimi rezultoi se: APP me vendimin nr.4, datë 16.01.2019 përcjellë për në Bashkinë Dibër dhe KLSH-në, duke vendosur masa dënim me gjobë për 15 persona në vlerën në total prej 3,020,000 lekë. Ka filluar ndalesa në pagesë për 6 punonjës dhe deri në datën 30.06.2020 janë arkëtuar 167,232 lekë ndërsa ka ngelur pa u arkëtuar vlera prej 2,852,768 lekë.

d. I janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Dibër t'ia kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendortë vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) 50,000 lekë në raport me shkeljet e konstatuara për 5 persona, 2 mbikëqyrës dhe 3 kolaudatorë, nga verifikimi rezulton se për një rast gjykata ka shfuqizuar dënimin me gjobë ndërsa për 4 rastet e tjera gjykata i ka kthyer mbrapsht kërkesë paditë e paraqitura nga bashkia, pasi kanë qenë me të meta, të cilat nuk janë plotësuar nga ana e bashkisë.

e. Janë rekomanduar 6 masa disiplinore,

e/I-Sipas "Ligjit për Nëpunësin Civil" janë rekomanduar 6 masa nga "Largim nga shërbimi civil", neni 58, germa (c) "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", neni 58 germa (b, c).

Nga verifikimi rezulton se janë dhënë 6 masa disiplinore "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë"

1. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Dibër rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 545/11, ndërsa nga Bashkia Dibër për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.3099/4 datë 14.11.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr.545/15 datë 19.11.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. **Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Dibër, ishin marrë masat si vijon:**

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.200, datë 26.10.2018 dhe 200/1 datë 14.11/2018, është ngritur grupi i punës për hartimin e plan veprimit dhe akteve

	të tjera për zbatimin e rekomandimeve të KLSH; Zbatuar 2. Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Dibër, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.545/11, datë 11.09.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 11.03.2019 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154 datë 27.11.2014 për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA), por nuk është raportuar. Pa zbatuar
Kriteri:	Veprim në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Dibër.
Ndikimi/ Efekti:	Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e detyrimeve për masa shpërblim dëmi në vlerën 71,835,683 lekë.
Shkaku:	Përgjegjësi e strukturave drejtuese.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin e Auditimit të kryer në Bashkinë Dibër, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, nenit 50-Auditimi i jashtëm pika 4 dhe 5 ku përcaktohet se: Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.

Lidhur me gjetjen me numër rendor 7, në rubrikën e masave për shpërblim dëmi, konkluzioni I auditimit është si vijon:

Gjetja dhe rekomandimi:

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Sistemi asfaltim rruga Borde - Peshkopi, Nj.A. Luzni”*, Bashkia Dibër, me vlerë të kontratës 62,980,962 lekë me tvsh, fituar nga Operatori Ekonomik òS.ò Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 3,105,722 lekë me tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 48/18 prot datë 06.09.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër dhe Operatori Ekonomik òS.ò Shpk

7.1. Rekomandim: Nga Bashkia Dibër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **3,105,722 lekë** me tvsh nga Operatori Ekonomik òS.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. nr. 48/18 prot datë 06.09.2016 me objekt *“Sistemi asfaltim rruga Borde-Peshkopi, Nj.A. Luzni”*, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga auditimi, lidhur me këtë çështje të mësipërme rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit të KLSH, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Dibër, i është dërguar subjektit òS.ò shpk shkresa nr.3170 prot, datë 07.06.2019, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit për objektin òSistemi asfaltim rruga Borde-Peshkopi, Nj.A. Luzni. Nga ana e subjektit me anë të shkresës nr.41/1 prot, datë 14.06.2019 drejtuar Bashkisë Dibër (dhe protokolluar në KLSH me nr.545/19, datë 21.06.2019) me lëndë kundërshtim i njoftimit nr.3169 prot datë 07.06.2019 dhe kërkon të

kontrollohet objekti dhe të ribëjë matje faktike. KLSH me shkresën nr.545/20, datë 02.07.2019, protokolluar në bashkinë Dibër me nr.3529, datë 03.07.2019, i është kërkuar bashkisë ngritja e një grupi pune së bashku me njësinë e auditit të brendshëm me qëllim verifikimin e dokumentacionit lidhur me zbatimin e kësaj kontrate. Gjithashtu po me këtë shkresë është rekomanduar që vlera e TVSH për këtë objekt në shumën prej 517,620 lekë e cila është derdhur në buxhetin e shtetit dhe padrejtësisht nga KLSH është shtuar në shumën e dëmit ekonomik, të zbritet nga shpërblimi i dëmit. **(duke ngelur në vlerën 2,588,102 lekë pa tvsh).**

Kryetari i Bashkisë Dibër me Urdhërin nr.155, datë 05.08.2019 ka ngritur grupin e punës për verifikimin e zbatimit të këtyre dy kontratave. Përbërja e grupit është si më poshtë vijon:

Ing. E. S. ó Përgjegjës i Urbanistikës, Përgjegjës

E. P. ó Përgjegjës i Financës, Anëtar

S. C. ó Specialist i Urbanistikës;

Ing. D. D. ó ing. Drejtorja e Shërbimeve;

Ing. G. I. ó ish mbikqyrësi i kontratës, anëtar;

Teknik M. S. ó përfaqësues i Kontraktorit òS.ò shpk, anëtar.

Me Urdhërin nr.171, datë 30.08.2019, grupit të mësipërm të punës do t'ia shtohet edhe njësisia e auditit të brendshëm e cila ka përgatitur programin tematik me nr.4087 prot., datë 30.08.2019 lidhur me verifikimin e zbatimit të kontratave të zbatimit të punimeve në dy objektet òSistemim asfaltim rruga Borde-Peshkopi, Nj.A. Luzniò dhe òSistemim asfaltim rruga Starvec-Shimcan-Zimurò.

Me shkresën nr.3529/1, datë 03.09.2019, nga ana e bashkisë Dibër i është kthyer përgjigje Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku i vihen në dispozicion dy akt verifikimet e mbajtura nga grupi i punës dhe nga njësisia e auditit të brendshëm për këto dy objekte. Nga aktverifikimet e mbajtura nga grupi i punës rezulton se nuk qëndrojnë diferencat e konstatuara nga auditimi i mëparshëm për të dyja këto objekte.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH:

Akt konstatimi i grupit të KLSH është mbajtur me mbikëqyrësin e punimeve dhe kolaudatorin e punimeve, si palët e kontraktuara nga AK për ndjekjen e punimeve dhe jo me kontraktorin që ka kryer punimet.

Përsa i përket aktverifikimit të mbajtur nga grupi i punës i ngritur me urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Dibër me nr.155, datë 05.08.2019, për zërat e mëposhtëm të punës:

Zëri 2.1: Shtresë çakëlli mbeturine kave t=20cm, përhapur e ngjeshur makineri,

Zëri 2.2: Shtresë stabilizant t=15cm,

Zëri 2.3: Shtresë stabilizant t=10cm (bankina),

Zëri 3.4: Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri,

Zëri 5.3: Struktura monolite betoni C 16/20 (mure betoni),

nuk janë paraqitur në dosje (siç thuhet në aktverifikimin e grupit të punës) dokumente plotësuese bashkëlidhur. Për këtë arsye konstatimi i grupit të punës është subjektiv dhe i paargumentuar teknikisht dhe për pasojë nuk është i besueshëm.

Përsa i përket zërave

Zëri 3.1: Spërkatje me emulsion bituminoz 1 l/m²

Zëri 3.3: Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m².

Në aktin e mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH nuk është cituar që këta zëra pune nuk janë realizuar. Këta zëra pune, në analizat teknike të punimeve të ndërtimit (manuali i çmimeve) janë të përfshirë në zërat e punës òshtresë binderiò dhe òshtresë asfaltobetoniò. Nisur nga ky fakt, ky zë pune nuk duhej situacionuar.

Për sa më sipër nuk qëndrojnë konkluzionet e auditit të brendshëm të njësisë vendore.

G. Shqyrtim ankese

Për kryerjen e verifikimit të ankesës së bërë nga Dega e Partisë Demokratike Dibër, protokolluar në KLSH me nr.417 prot., datë 06.05.2020, u mbajt aktverifikim, me përmbajtje si vijon:

Kjo ankesë u shqyrtua në zbatim të pikës G, të Programit të Auditimit: ÷Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur problematikat e ngritura në ankesë lidhen me pretendimet rreth dy çështjeve për procedurën e prokurimit publik me objekt ÷Ndërtimi i linjës së furnizimit me ujë te pijshëm Gurra e Epërme-Luzni-Peshkopiö, si vijon:

- 1) ky prokurim publik nuk duhet të kishte filluar;
- 2) kriteret e vendosura në DST për këtë procedurë prokurimi janë në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi.

Më gjerësisht si më poshtë vijon:

1- Në ankesë ngrihet problemi se Bashkia Dibër nuk duhet të kishte zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt ÷Ndërtimi i linjës së furnizimit me ujë te pijshëm Gurra e Eperme-Luzni-Peshkopiö, me fond limit 208 333 333,5 leke pa TVSH, te publikuar në faqen zyrtare te APP me nr. REF-54743-03-23-2020. Nga ankimesi thuhet se Bashkia Dibër ka vepruar në kundërshtim me njoftimin e APP, ku theksohet se për shkak të situatës së pandemisë Covid 19, duhet të vijojë procesi i prokurimit vetëm me ato procedura prokurimi që lidhen ngushtësisht me mbulimin e nevojave të dala në kuadër të situatës së pandemisë dhe që konsiderohen të domosdoshme. Autoritet kontraktore duhet të pezullojnë të gjitha procedurat e prokurimit, duke përfshirë edhe procedurat me vlerë të vogël. Kërkohe nga ankimesi që KLSH të denoncojë veprimet e paligjshme të Bashkisë Dibër, lidhur me zhvillimin e këtij objekti prokurimi.

2- Në ankesë thuhet se AK Bashkia Dibër në kriteret e DST ka vendosur disa licence diskriminuese, ose përjashtuese të disa firmave, për të përcaktuar firmën fituese. Në ankesë janë paraqitur edhe licencat për të cilat pretendohet se janë diskriminuese. Gjithashtu në ankesë pretendohet se kriteret për numrin e punonjësve, numrin e makinerive etj., janë vendosur në kundërshtim me kërkesat ligjore në fuqi.

Trajtimi i pikës nr.1 të ankesës:

Në këtë akt verifikim do të shqyrtohet vetëm pika nr. 1 e ankesës, ndërsa pika nr. 2 do të shqyrtohet nga audituesi G. H. në auditimin e tenderit për të cilin është bërë kjo ankesë, pasi lidhet me trajtimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve standarde të tenderit.

.Për shqyrtimin e saj u shqyrtuan dokumentet e mëposhtme:

1. Nga auditimi konstatohet se prokurimi me objekt ÷Ndërtim i Linjës së Furnizimit me ujë të pijshëm Gurra e Epërme-Luzni-Peshkopiö, është miratuar për tu kryer si investim me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 42, datë 10.03.2020

1. Shkresa e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorrit, Bashkia Dibër me lëndë ÷Relacioni teknik mbi bilancin e nevojaveö, pa datë, i cili shpjegon gjendjen aktuale të furnizimit me ujë të pijshëm dhe argumenton nevojën e këtij investimi, miratuar nga titullari i AK z. D. I.
2. Shkresa e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorrit, Bashkia Dibër me lëndë ÷Detyrë projektimi për hartimin e projektitö, pa datë, në të cilën është bërë një panoramë orientuese për projektin, një llogaritje paraprake e investimit etj.
3. Kontrata Projektimit lidhur mes ShA Ujësjetllës ó Kanalizime Dibër dhe firmës projektuese ÷H. K. S.ö, datë 04.03.2019.
4. Shkresa e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Teritorrit, Bashkia Dibër, nr. 571/ 1 prot, datë 01.11.2019 me lëndë ÷Për miratimin e projekt-preventivitö.

5. Shkresa e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Teritorit, Bashkia Dibër nr. 263 prot, date 21.01.2020, drejtuar Institutit të Ndërtimit, me lëndë òPër kryerjen e oponencës teknikeò.
6. Akt-Marrveshja e lidhur mes Bashkise Dibër dhe Institutit të Ndërtimit me nr 383 prot, date 29.01.2020 (Bashkia Dibër) me nr 179/1, date 24.01.2020 (Instuti i Ndërtimit), me lëndë òPër kryerjen e oponencës teknike për tenderin òNdërtim i linjës se furnizimit me ujë te pijshëm Gurra e Epërme-Luzni-Peshkopiò.
7. Shkresa e Agjencisë Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikesò me lëndë òNjoftim për mbledhjeò, nr 338/1 prot, date 04.02.2020, e cila bënë fjalë se do të organizohet mbledhja e këshillit teknik për shqyrtimin e projektit. Ftohet bashkia Dibër për të marrë pjesë në këtë mbledhje.
8. Shkresa e Agjencisë Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikesò nr 434 prot, date 11.02.2020 òDetajimi i fondit për investimin: Ndërtim i Linjës se Furnizimit me ujë te pijshëm Gurra e Epërme-Luzni-Peshkopiò.
9. Shkresa e Agjencisë Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikesò njoftim për mbledhjeò, nr 480 prot, date 14.02.2020, me lëndë ò Detajimi i Buxhetit për vitet 2020-2022ò .
10. Projekti i hartuar nga shoqëria òH. K. S.ò.
11. Urdhri i Titullarit të Autoritetit Kontraktor z. D. I. me nr. 09 prot. datë 10.03.2020, për ngritjen e komisionit për argumentin e fondit limit dhe specifikimeve teknike dhe preventivave.
12. Relacioni i komisionit mbi argumentimin e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike me nr. 09/1 date 16.03.2020.
13. Urdhri i prokurimit i Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr.09/1 datë 19.03.2020 për kryerjen e prokurimit publik për këtë procedurëprokurimi.
14. Urdhri i prokurimit i Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 09/2 datë 19.03.2020 për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
15. Formulari i njoftimit të kontratës me nr. REF-54743-03-23-2020, me numër prot. 09/4, datë 20.03.2020 i ngarkuar ne SPE të APP.Pra, procedura është bërë e disponueshme në sistemin e prokurimit elektronik të APP në datën 23.03.2020.
16. Dokumentet Standarde të Tenderit, të cilat kanë datën 20.03.2020, të hartuara nga njësia e prokurimit e ngritur me urdhrin nr. 09/1 date 19.03.2020.
17. Miratimi i DST nga ana e Titullarit të Autoritetit Kontraktor z. D. I., datë 20.03.2020, me nr.09/5 prot., datë 20.03.2020.
18. Procesverbali datë 20.03.2020, i hartua nga ana e njësia e prokurimit mbi argumentimin e kriterëve të kualifikimit.
19. Relacioni mbi argumentimin e kriterëve të kualifikimit nga specialisti i fushës.

- Mbështetur në udhëzimet e nxjerra nga APP në kuadër të situatës së pandemisë Covid

19, konstatohet se njoftimi i parë për këtë situatë lidhur me zhvillimin ose jo të procedurave të prokurimit publik, ka dalë më datën 12.03.2020, Nr. 2245 Prot., ku midis të tjerash thuhet:

1. *Autoritetet kontraktore të pezullojnë shpalljen e procedurave të reja prokurimi, për një afat 15 ditor, duke filluar nga dita e sotme, datë 12.03.2020.*
 2. *Për procedurat e prokurimit që janë në proces, pra ato që janë të shpallura nga autoritetet kontraktore apo janë në proces vlerësimi, të shtyhen si afati i dorëzimit të ofertave ashtu dhe afati i vlerësimit të tyre me 15 ditë, duke nisur nga dita e sotme, datë 12.03.2020.*
 3. *Autoritetet kontraktore të pezullojnë zbatimin e kontratave të nënshkruara për mallra, punë, shërbime, për një afat 15 ditor, duke nisur nga dita e sotme, datë 12.03.2020.*
- Bëjnë përjashtim nga zbatimi i këtij Njoftimi,procedurat e prokurimit që vlerësohen si emergjente apo të domosdoshme nga autoritetet kontraktore, si dhe zbatimi i kontratave që*

vlerësohen të domosdoshme për shkak të objektit të tyre, të cilat mund të vijnë normalisht, për sa është e mundur.

Autoriteti Kontraktor bashkia Dibër, e ka vlerësuar dhe gjykuar si të domosdoshme për nevojat e saj këtë procedurë prokurimi.

- Në datën 27.03.2020, ka dalë njoftimi i APP, Nr. 2339 Prot., ku midis të tjerash thuhet:
*Në vijim të Njoftimit Nr. 2245 Prot., datë 12.03.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik mbi shpalljen e procedurave të reja të prokurimit publik, apo vijimin e procedurave apo kontratave në proces, në mbështetje të nenit 13 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, APP sqaron si më poshtë vijon:
Autoritetet kontraktore mund të pezullojnë apo shtyjnë afatin e pritjes së ofertave për procedurat e prokurimit që kanë shpallur, nëse për shkak të situatës së krijuar në vendin tonë, vlerësojnë se janë në pamundësi të vijimit normal të punës, ndërkohë nuk ka pengesë për asnjë autoritet kontraktor që të shpallë apo zhvillojë procedura prokurimi, për sa kohë vlerësohet e nevojshme dhe e mundur.*

Në kuptim të sa më sipër, në rast se autoritetet kontraktore vlerësojnë se janë në kushtet që të vijnë me shpalljen e njoftimeve të reja për procedurat e prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik, apo me hapjen dhe shqyrtimin ofertave të paraqitura, për procedurat në proces, të vijnë me punën në sistemin e prokurimit elektronik.

Njoftimi i mësipërm ka lejuar të zhvillohen procedurat e prokurimit të prokurimit publik për sa kohë vlerësohet e nevojshme dhe e mundur nga autoritet kontraktor.

- Në datën 31.03.2020 ka dalë njoftimi i APP, Nr.2371 Prot, ku thuhet:
*“Autoritetet kontraktore duhet të vijnë procesin e prokurimit vetëm për ato procedura prokurimi që lidhen ngushtësisht me mbulimin e nevojave të dala në kuadër të situatës së shkaktuar nga pandemia Covid 19 dhe që konsiderohen të domosdoshme.
Në kuptim të sa më sipër, autoritetet kontraktore të pezullojnë gjitha procedurat e prokurimit, përfshirë këtu edhe procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, për objekte prokurimi të cilat nuk lidhen ngushtësisht me këtë situatë, deri në një njoftim të dytë.
Gjithashtu, të pezullohen edhe ato procedura prokurimi që janë në proces, objektet e të cilave nuk lidhen me situatën e shkaktuar nga pandemia, deri në një njoftim të dytë.*

- Në zbatim të këtij njoftimi të APP, nga titullari i AK z. D. I. është pezulluar procedura e prokurimit, nëpërmjet urdhrin nr.09/3prot, date 31.03.2020 për pezullimin e procedurës së prokurimit Ndërtim i Linjës së Furnizimit me ujë të pijshëm Gurra e Epërme-Luzni-Peshkopiö.

- APP, në vijim të Njoftimit Nr.2371 Prot., datë 31.03.2020 bënë sqarimin, ku thuhet:
*“Në vijim të Njoftimit Nr.2371 Prot., datë 31.03.2020 për pezullimin e shpalljes së procedurave të reja të prokurimit publik, si dhe atyre që janë në proces, APP, sjell në vëmendje të autoriteteve kontraktore si më poshtë vijon:
Në këtë kuptim, sqarojmë se autoritetet kontraktore mund të vijnë procesin e prokurimit (shpalljet e reja apo procedurat që janë në proces) për mbulimin e nevojave të dala në kuadër të situatës së shkaktuar nga pandemia Covid 19, dhe për ato objekte që janë të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës së autoriteteve kontraktore, duke përfshirë objektet e prokurimit të lidhura me ofrimin e shërbimeve për komunitetin”.*

Pra APP ka lejuar që përveç procedurave që lidhen me mbulimin e nevojave të dala në kuadër të situatës së shkaktuar nga pandemia Covid 19, të zhvillohen edhe procedurat që sipas autoriteteve kontraktore janë të domosdoshme dhe që lidhen me ofrimin e shërbimeve për komunitetin.

- Agjencia e Prokurimit Publik me datën 03.04.2020 ka sjell me e-mail në faqen zyrtare të Bashkisë Dibër, Rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik për procedurën me objekt Ndërtim i Linjës së Furnizimit me ujë të pijshëm Gurra e Epërme-Luzni-

Peshkopiö, rekomandime për shqyrtimin dhe implementimin e kritereve të kualifikimit. Në këto rekomandime APP midis të tjerash shprehet:

öNga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), sa i takon autoritetit kontraktor “Bashkia Dibër” (në vijim AK) rezulton se, ndërmjet të tjerash është shpallur edhe procedura me REF-54743-03-23-2020 me objekt “Ndërtim i Linjës së Furnizimit me ujë të pijshëm Gurra e Epërme-Luzni-Peshkopi”, me fond limit 208,333,333.50 lekë pa TVSH.ö

Në vijim APP ka dhenë rekomandime konkrete lidhur me disa ndryshime të kritereve të DST dhe në fund shprehet se:

*1 Kur nga AK konsiderohet i nevojshëm ndryshimi i dokumenteve të tenderit, përfshirë këtu edhe kriteret për kualifikim, mbështetur në përcaktimet e nenit 42 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, **Autoriteti Kontraktor nuk duhet të anullojë procedurën**, por mund të bëjë ndryshime përmes hartimit të një shtojce, e cila ju vihet në dispozicion operatoreve ekonomikë, në Dokumentet Standarde të Tenderit të publikuara në SPE”.*

Nuk konstatohet që APP të jetë shprehur për pezullim të kësaj procedure.

- Në datë 15.04.2020 njësia e prokurimit ka shqyrtuar rekomandimet e sjella nga APP për procedurën objekt prokurimi të mësipërm dhe ka hartuar shtojcën nr.1 dhe proces-verbalin nr. 2 për këtë qëllim.

Titullari i Autoritetit Kontraktor me urdhrin nr.09/5 datë15.04.2020, në zbatim të sqarimit të APP, lidhur me Njoftimit Nr.2371 Prot., datë 31.03.2020, ka hequr nga pezullimi procedurën e prokurimit me objekt *Ndërtim i Linjës së Furnizimit me ujë të pijshëm Gurra e Epërme-Luzni-Peshkopi*”. Pas kësaj procedura është zhvilluar normalisht.

Për të verifikuar nëse edhe autoritete të tjera kontraktore në vend, gjatë fazës së pandemisë dhe gjatë kohës që përkon me zhvillimin e procedurës së mësipërme të Bashkisë Dibër, kanë zhvilluar procedura të ngjashme prokurimi dhe, nëse këto procedura janë lejuar të zhvillohen nga APP, u bë një vëzhgim i faqes elektronike të APP dhe konkretisht öBuletini i njoftimeve publike të APP, nr. 19, datë 14.04.2020ö. Në buletin e APP përveç të tjerash, botohet edhe njoftimi i kontratave për procedurat e porsa filluara elektronike. Nga vëzhgimi i këtij buletini u konstatua se nga APP është publikuar fillimi i procedurave të reja të prokurimit publik për disa subjekte e konkretisht:

Është botuar (pra është lejuar nga APP), fillimi i procedurës së prokurimit publik të AK Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Këlcyrë: me objekt öRikonstruksion i Ujësjetllësit të fshatit Rodenj - Fshat i Riö. Numri i referencës së procedurës: REF-55843-04-07-2020, shfaqur ne sistemin e APP në datën 07.04.2020.

Është botuar (pra është lejuar nga APP), fillimi i procedurës së prokurimit publik të AK Sh.A. Ujësjetllës Kanalizime Kurbin, objekti i kontratës öNdërtimi i rrjetit të jashtëm e të brendshëm të ujësjetllësit të qytetit Laç faza II. Numri i referencës së procedurës: REF-55903-04-08-2020, shfaqur ne sistemin e APP në datën 08.04.2020.

Është botuar (pra është lejuar nga APP), fillimi i procedurës së prokurimit publik të AK Bashkia Berat, objekti i kontratës öNdërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarjes të furnizimit me ujë të Njësjet Administrative Velabisht, Bashkia Beratö. Numri i referencës së procedurës: REF-55654-04-06-2020, shfaqur ne sistemin e APP në datën 06.04.2020.

Në buletin nr.18, datë 06.04.2020 të APP është botuar (pra është lejuar nga APP), fillimi i procedurës së prokurimit publik të AK Ujësjetllës Kanalizime ShA Durrës me objekt:

oPërmirësimi i furnizimit me ujë lagjia nr.1, Vadardhë, Njësia Administrative Suktho, me nr reference 55077-03-27-2020.

Si përfundim, nga verifikimi i ankesës rezultoi që:

Përsa më sipër, nga auditimi nuk konstatohen shkelje të bazës ligjore në fuqi, përfshirë edhe njoftimet e nxjerra nga APP për periudhën e pandemisë, për fillimin e zhvillimit të procedurës së prokurimit publik me objekt Ndërtim i Linjës së Furnizimit me ujë të pijshëm Gurra e Epërme-Luzni-Peshkopi". Kjo për arsyet që janë përmendur edhe më lart: APP ka lejuar që gjatë fazës së pandemisë të zhvillohen edhe procedura prokurimi që sipas autoriteteve kontraktore janë të domosdoshme dhe që lidhen me ofrimin e shërbimeve për komunitetin.

Në këtë arsyetim nuk jepet vlerësimi për pikën tjetër të ankesës, pra për faktin nëse ka anomali ose jo në hartimin kritereve të DST nga ana e Autoritetit Kontraktor, pasi si u tha më lart, kjo është trajtuar në auditimin e procedurës së këtij objekti prokurimi, në të cilin nuk janë konstatuar anomali. Hartimi i kritereve fillimisht ka pasur pasaktësi nga AK, por janë evidentuar nga APP, e cila i ka sugjeruar AK korigjimin e tyre dhe ky i fundit ka bërë korigjimet e nevojshme.

Lista dhe përmbajtja e dokumentacionit të cilit i referohemi më lart, gjatë shqyrtimit të ankesës, paraqitet në Aneksin nr. 5. Pika G. Shqyrtim ankese, në fund të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se llogaria 210 oToka, troje, terreneo, në pasqyrat financiare të vitit 2019 dhe 2018 ka vlerën 28,394,404 lekë, pa ndryshime nga njëri vit në tjetrin dhe përbëhet vetëm nga dy asete: oShpronësim truall shkolla e mesme dhe konvikti në vlerën 27,500,000 lekë dhe oShpronësim rruge për tek oGjimnazi i Riö, në vlerën 894,404 lekë.

Llogaria 211 oPyje kullota plantacioneo në pasqyrat financiare të vitit 2019 ka vlerën 1,268,000 lekë ka vlerën, pa ndryshime nga viti i mëparshëm 2018.

Dy llogaritë e mësipërme nuk pasqyrojnë vlerën e saktë të asetëve që njësia vendore ka në fakt, sepse në to nuk janë përfshirë tokat, trojet dhe terrenet, pyjet kullotat plantacione që njësia vendore ka në fakt si pasuri të saj, të cilat janë transferuar me VKM nr 433, datë 08.06.2016 oPër transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkiveo.

- Llogaria 212 oNdërtesa e Konstruksioneo në pasqyrat financiare të vitit 2019 ka vlerën 949,002,810 lekë, ndërsa për vitin 2018 ka vlerën 980,198,159 lekë. Për vitin 2019 ka një zvogëlim të kësaj llogarie me një vlerë prej 31,195,349 lekë, e cila vjen për shkak të amortizimit në vlerën 49,937,652 lekë dhe shtesave (bruto) në vlerën 18,742,303. Për vitin 2018 dhe 2019 është përdorur norma e amortizimit 1%, në kundërshtim me kërkesat e pikës nr.36 të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 oPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të

pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeë. Njësia vendore edhe pse ka listë analitike për këtë llogari e cila përbëhet nga 211 objekte, nuk jep siguri se kjo llogari paraqet vlerën e saktë të saj, sepse komisioni i inventarizimit nuk është shprehur për këtë llogari, pra nuk e ka inventarizuar, si dhe nuk është hartuar regjistri i aktiveve për këto prona. Anomalitë që mbart kjo llogari nga mangësitë e mësipërme vlerësohen materiale.

- Llogaria 2130Rrugë, rrjete, vepra ujoreë, për vitin 2019 ka vlerën 3,311,844,643 lekë, ndërsa për vitin 2018 ka vlerën 3,234,280,705 lekë. Në pasqyrat financiare të vitit 2019 kjo llogari është rritur me vlerën neto 77,563,938 lekë, e cila nuk është e saktë, sepse shtesat bruto për vitin 2019, sipas listës analitike për 16 objekte që administron njësia vendore, kanë vlerën 108,450,488 lekë, ndërsa sipas pasqyrave financiare të vitit 2019 është pasqyruar shtesë vlere bruto 111,005,701 lekë, duke u pasqyruar një shtesë bruto më shumë nga realja në vlerën 2,555,213 lekë.

Për katër llogaritë e mësipërme njësia vendore nuk ka rregjistër kontabël të aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë, si dhe nuk ka bërë regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë, kapitulli IV. pika 74 dhe 96 dhe të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeë (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 38-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtoria Ekonomike, të marrin masa për sistemimin dhe saktësimin e aseteve të llogarisë 210 0Toka, Troje, Terreneë, llogarisë 211 0Pyje, kullota, plantacione, llogarisë 212 0Ndërtesa e Konstruksioneë llogarisë 213 0Rrugë, rrjete, vepra ujoreë. Për këtë të hartohet regjistri kontabël i tyre me të gjitha të dhënat e nevojshme (vendndodhje, sipërfaqja, statusi i pronës etj.) dhe, mbi bazën e këtij dokumenti të kryhet inventarizimi. Në vijim të merren masa për regjistrimin e këtyre aseteve në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe pasqyrimin në pasqyrat financiare të vitit 2021.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 466 0Kreditorë për mjetet në ruajtjeë (garanci punimesh në masën 5% të vlerës së investimit), u konstatua se:

a) Në pasqyrat financiare të vitit 2019 kjo llogari ka vlerën kontabël 34,394,184 lekë, e cila ka të njëjtën vlerë me aktin e rakordimit me degën e thesarit Dibër, por njësia vendore ka listë analitike vetëm për vlerën 23,474,067 lekë për 38 raste, ndërsa për diferencën prej 10,920,117 lekë, nuk ka dokumentacion vërtetues dhe nuk ka informacion se me cilat investime dhe me cilat shoqëri lidhet kjo garanci punimesh. Drejtoria ekonomike ka pranuar si të mirëqenë këtë vlerë prej 34,394,184 lekë, të dhënë nga Dega e Thesarit Dibër, me arsyetimin se diferenca prej 10,920,117 lekë, janë regjistrime në thesar nga ish komunat, si detyrim që këto të fundit kanë pasur për garancinë e punimeve ndaj firmave private, por nga njësia vendore nuk administrohet dokumentacion që të vërtetojë se ajo vetë apo dega e thesarit Dibër kanë evidencë analitike për këtë vlerë.

b) Sipas listës analitike që administron Drejtoria Ekonomike, llogaria 466 0Kreditorë për mjete në ruajtjeë ka vlerën 23,474,067 lekë për 38 raste, por bazuar në afatin një vjeçar të garancisë së punimeve, vlere prej 13,013,172 lekë për 38 nga rastet e mësipërme, ka plotësuar dhe tejkualuar afatin dhe duhet të ishte likuiduar, ose duhet të ishte përfituar nga njësia vendore nëse detyrimet kontraktuale nuk janë zbatuar nga kontraktori.

Kjo vlerë i përket periudhës 2015-2019, me përjashtim të garancisë së punimeve për një investim i cili i përket vitit 2012, në vlerën 3,269,266 lekë.

Nga njësia vendore nuk janë marrë masa për zbatimin e detyrimeve kontraktuale, për llogarinë 466 òKreditorë për mjetet në ruajtjeò (garanci punimesh në masën 5% të vlerës së investimit), në kundërshtim me UMF nr. 8 datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, si dhe kushtet e kontratës të lidhur midis palëve (*Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 38-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dibër dhe nëpunësi zbatues, të analizojnë dhe saktësojnë përbërjen analitike të vlerës 10,920,117 lekë, ngurtësuar në thesar, duke përcaktuar arsyen e mos likuidimit, emrin e investimit, emrin e shoqërisë. Të merren në referencë kontratat e lidhura për këtë qëllim, detyrimet e përcaktuara në to dhe të bëhen krahasime nëse vlera e ngurtësuar akordon me detyrimet e përcaktuara në kontratën dypalëshe. Për këtë të hartohen akte akordimi midis degës së thesarit Dibër dhe njësisë vendore, me të dhëna të detajuara për shoqëritë dhe investimet.

2.2. Rekomandim: Nga njësia vendore të përcaktohet nëse vlera e pa analizuar prej 10,920,117 lekë, si dhe vlera që ka listë analitike prej 13,013,172 lekë për 38 nga raste, është ende e ngurtësuar për shkak të mos kryerjes së detyrimeve nga kontraktori (dhe në këtë rast vlerat duhet të kalojnë në favor të njësisë vendore), apo nga mos përgatitja e dokumentacionit nga kontraktori. Nëse nuk është përmbyllur garancia e defekteve të punimeve dhe nëse nuk janë bërë korrigjimet e punimeve për çdo kontratë së cilës nuk i është likuiduar kjo garanci dhe ka mos realizime të punimeve, atëherë në përputhje me përcaktimet e bëra në kontratë, kjo vlerë nuk duhet të likuidohet, por të kalojë në llogarinë e njësisë vendore për përdorim në buxhetin e vet.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2019 llogaria 401-408 òFurnitorë e llogari të lidhura me toò ka vlerën 167,254,617 lekë, por kjo vlerë nuk rakordon me vlerën që pasqyrojnë librat e kontabilitetit, pasi sipas analizës përbërëse të saj që administrohet nga drejtoria ekonomike, kjo llogari përbëhet nga detyrimet e njësisë vendore për 78 subjekte në vlerën 42,206,100 lekë. Vlera prej 125,048,418 lekë është paraqitur tepër në këtë llogari dhe nuk ka dokumentacion vërtetues për të justifikuar këtë diferencë (*Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 38-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për sistemimin e llogarisë 401-408 òFurnitorë e llogari të lidhura me toò, në mënyrë që kjo llogari të pasqyrojë vlerën reale të detyrimeve që njësia vendore ka ndaj furnitorëve. Për këtë të saktësohet nëse ka mangësi në listat analitike, apo mangësia i përket pasqyrave financiare.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Llogaria 202 òStudime dhe kërkimeò, në pasqyrat financiare të vitit 2019 ka vlerën 35,724,228 lekë. Në këtë llogari në mënyrë të gabuar përfshihet edhe vlera e 61 projekteve dhe dy supervizimeve në vlerën totale 41,379,137 lekë, që i përkasin periudhës përpara vitit 2018 (viti 2009 e në vazhdim). Investimet me të cilat lidhen projektet dhe supervizimet e mësipërme kanë qenë të përfunduara përpara datës 31.12.2019 dhe për këtë arsye vlera 41,379,137 lekë nuk duhet të ishte pjesë e llogarisë 202 òStudime dhe kërkimeò, por duhet të ishte bërë pjesë e vlerës së objektit me të cilin lidhet projekti, menjëherë pas përfundimit dhe marrjes së tij në dorëzim.

Llogaria 203 òKoncesione, Patenta, Licenca e të ngjashmeò në pasqyrat financiare të vitit 2019 ka vlerën 12,207,842 lekë. Në këtë llogari bëjnë pjesë 14 projekte që janë hartuar nga firmat private për investimet që janë kryer në Bashkinë Dibër, nga të cilat nëntë prej tyre, në vlerën 6,503,594 lekë ju përkasin investimeve të cilat kanë përfunduar përpara datës 31.12.2019, por në mënyrë të gabuar vlera e këtyre projekteve nuk është bashkuar me vlerën e investimit të cilit i përkasin. Gjithashtu për vitin 2019 janë përfituar pa pagesë tre projekte në vlerën 91,950,921 lekë, por kjo vlerë nuk është e regjistruar në librat e kontabilitetit dhe

nuk është e pasqyruar në bilanc. Nuk ka akt dhurimi apo dokument tjetër midis njësisë vendore dhe subjektit hartues të projektit, ku të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet midis palëve.

Gjatë vitit 2019 janë kryer investime për të cilat ka projekte përkatëse për të dy llogaritë e mësipërme dhe për këtë arsye këto llogari duhet të kishin pësuar rritje, por në fakt të dy këto llogari nuk kanë shtesa në vlerë nga viti 2018 në vitin 2019.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, nenin 7, 9, 10, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 òPër përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël, Kap. II (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 38-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për:

a) Sistemimin e llogarisë 202 òStudime e kërkime, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 41,379,137lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

b) Sistemimin e llogarisë 203 òKoncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme, duke pakësuar këtë llogari për vlerën e nëntë projekteve prej 6,503,594 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara. Për këtë qëllim njësi vendore ti referohet investimeve të realizuara dhe të marra në dorëzim.

c) Regjistrimin në kontabilitet të projekteve të dhuruara nga subjekte private. Në raste të tjera të ngjashme të hartohet akti i dhurimit që identifikon mallin dhe subjektin dhurues, si dhe kontratë midis palëve, ku të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet midis tyre.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Llogaria 468 òDebitorë të ndryshëm në pasqyrat financiare të vitit 2019 ka vlerën 86,504,128lekë. Kjo llogari përfaqëson të drejtat mbi debitorë për 378 subjekte. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në debi të saj janë debitorët për taksat dhe tarifave vendore në vlerën 8,619,354 lekë, vlera 73,085,749 lekë janë debitor të lënë nga KLSH në auditimin e mëparshëm, vlera 1,670,300 lekë janë debitorë në kopshte dhe çerdhe dhe vlera 3,129,063 lekë janë debitor të letrave me vlerë. Për vlerat e mësipërme ka listë analitike, por konstatohet se vlera e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore për vitin 2019 prej 8,619,354 lekë, nuk shpreh vlerën reale të këtyre detyrimeve, pasi nga auditimi u konstatua se borxhi tatimor progresiv nga taksapaguesit privat dhe familjar, në datën 31.12.2019 ka vlerën 47,459,984 lekë. Llogaria 468 òDebitorë të ndryshëm në pasqyrat financiare të vitit 2019, nuk pasqyron vlerën e saktë të të drejtave që ka njësi vendore mbi të tretët. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, nenin 7, 9, 10, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 òPër përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël, Kap. II (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 38-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandim:Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Dibër në bashkëpunim me sektorin e taksave dhe tarifave vendore, mbështetur në listën e debitorëve, të bëjë rregullimet përkatëse të vlerës së detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, si dhe për të gjitha llojet e tjera të detyrimeve.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2019 llogaria 35 òMallra, ka vlerën 10,107,240 lekë dhe përbëhet nga lëvizja e letrave me vlerë si pulla të gjendjes civile, bileta tregu, vërtetime të ndihmës ekonomike etj., vërtetime të kësaj natyre.

Nga auditimi i ditarit të lëvizjeve të letrave me vlerë konstatohet se kjo llogari ka vlerën 10,223,607 lekë, pra pasqyrat financiare të vitit 2019, për llogarinë 35 òMallra, pasqyrojnë një vlerë 116,367 lekë më pak nga gjendja reale e aktiveve. Nga auditimi i ditarit të lëvizjeve të letrave me vlerë konstatohet se në vitin 2020, është bërë çelja në ditar sipas vlerës reale 10,223,607 lekë dhe jo sipas vlerës së bilancit, duke arritur në përfundimin se nuk ka anomali në administrimin real të letrave me vlerë, por anomali në paraqitjen e vlerës në pasqyrat

financiare (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 38-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Dibër, të bëjë sistemimet e duhura të vlerës së llogarisë 35 ÷ Mallra, në mënyrë që pasqyrat financiare të vitit 2020, të pasqyrojnë në këtë llogari vlerën që mbartin librat e kontabilitetit të mbajtur gjatë vitit ushtrimor (ditari i lëvizjeve të letrave me vlerë).

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në datën 31.12.2019 Bashkia Dibër ka një vlerë të detyrime të prapambetura prej **288,500,252** lekë, e cila përbëhet nga:

- Detyrime për investime në vlerën 125,048,518 lekë;
- Detyrime për vendimet gjyqësore në vlerën 124,458,768 lekë;
- Detyrime për shërbime në vlerën 36,497,523 lekë;
- Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga ish komunat në vlerën 2,495,464 lekë.

Mungesa e realizimit të të ardhurave dhe marrja e angazhimeve buxhetore në mungesë të tyre, është shkaku kryesor i krijimit të detyrimeve të prapambetura, vlera e të cilave si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave është 254,778,897 lekë. Vlera e detyrimeve që i përket mos alokimit të plotë të fondeve nga FZHR është 30,116,909 lekë dhe ju përket dy investimeve të përfunduara në vitin 2017 dhe vitin 2018, ndërsavlera e detyrimeve që i përket grantit qeveritar (detyrimi i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë për tetë procedura prokurimi për blerje mallra ushqimore për kopshte dhe çerdhe), ka vlerën 3,604,466 lekë.

Bazuar në ligjin nr. 68, datë 27.04.2017, ÷ Për financat e vetëqeverisjes vendore, kreun XI-Vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 dhe 56, si dhe në udhëzimin e MF nr. 26, datë 27.09.2019, ÷ Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore, konstatohet se njësia vendore Bashkia Dibër ndodhet në vështirësi financiare, pasi vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta është 38% e shpenzimeve vjetore (duke mos përfshirë te shpenzimet vjetore vlerën e llogarisë 466- Mjete nën ruajtje, vlerën e taksës së pullës, vlerën e ndihmës ekonomike dhe pagesën e paaftësisë, pasi këto nuk janë shpenzime për njësitë vendore). Në datën 30.06.2020 vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta është 28% e shpenzimeve vjetore. Nga auditimi konstatohet se nuk janë marrë të gjitha masat e duhura për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi përveç detyrimeve të mbartura, si për vitin 2018 edhe për vitin 2019 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, i ndryshuar, neni 40 ÷ E drejta për të kryer shpenzime; UMF nr. 5, datë 27.02.2014 ÷ Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ÷ ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014; Udhëzimin plotësues nr. 2 të MF, datë 10.01.2018 ÷ Për buxhetin e vitit 2018, pikat 82-91 ÷ Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore; UMF nr. 22, datë 30.07.2018 ÷ Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 38-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Dibër të analizohet situata e detyrimeve të prapambetura dhe të nxirren përgjegjësitë për këtë situatë. Të mos merren angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, në mënyrë që të mos krijohen detyrime të reja në vijimësi. Për detyrimet e prapambetura, të hartohet një grafik për likuidimin e tyre, duke zbatuar radhën e pagesave sipas kronologjisë së tyre. Të paraqitet në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara si dhe planin dhe grafikun për likuidimin e tyre. Detyrimet financiare të konstatuara dhe të papaguara ndaj palëve të treta të ulen në nivelin 15 për qind të shpenzimeve vjetore.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm në Bashkinë Dibër u konstatuan mangësi në njohjen dhe implementimin në praktikë të pesë elementëve të këtij sistemi.

Mjedisi i kontrollit. Në Bashkinë Dibër nuk është miratuar kodi i etikës, si dhe nuk është evidentuar puna e anëtarëve GMS. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Politika dhe praktika e burimeve njerëzore nuk garanton ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit, pasi nuk ka programe trajnimi për punonjësit, për të ngritur në vazhdimësi nivelin e tyre profesional.

-Menaxhimi i riskut. Nga titullari në cilësinë e kordinatorit të riskut dhe menaxherët e tjerë, nuk është hartuar regjistri i riskut, si dhe nuk është bërë identifikimi, vlerësimi dhe kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë. Mungon dokumenti i gjurmës së auditimit dhe listës së proceseve të punës për veprimtaritë kryesore të njësisë publike.

-Veprimtaritë e kontrollit. Nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit, mungojnë rregulla të shkruara për ruajtjen e aktiveve, si dhe sistemi rezervë (back-up) për ruajtjen e të dhënave. Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT.

-Informacioni dhe komunikimi. Realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të nenit 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, por nuk janë përcaktuar me shkrim llojet e raporteve, frekuenca e raportimit me shkrim te titullari nga secila drejtori/sector, etj.

-Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit. Nuk janë përcaktuar rregulla të qarta lidhur me ndjekjen e zbatimit të kontratave të lidhura pas procedurave të prokurimit me tender. Për projektet në bujqësi, arsim, urbanistikë, infrastrukturë etj., në rregulloren e funksionimit të brendshëm nuk janë përcaktuar detyra se kush duhet të ndjekë zbatimin e kontratave lidhur me afatet dhe cilësinë e punimeve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19, neni 16 pika 2, neni 20 dhe neni 22, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar Kap. III, pikat 42, 47 (*Më hollësisht trajtuar në pikën A.1, faqe 14-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtori i Drejtorisë Ekonomike të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò dhe kërkesat e òManualit për menaxhimin financiar dhe kontrollinò. Të miratohet Kodi i Etikës, të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim te titullari nga secila drejtori/sector, etj. Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2018-30.06.2020 kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 150 punonjës (me detyra të ndryshme si, drejtor kabineti, drejtor i qendrës kulturore, përgjegjës i njësisë së prokurimit, specialiste financash, etj), të cilët përpara largimit nga puna nuk kanë bërë dorëzimin e detyrës me procesverbal (dorëzimin e dosjeve shkresore, elektronike, pra të gjithë punës së krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion). Nuk janë hartuar rregulla të shkruara për veprimet që duhet të kryhen nga punonjësi gjatë marrjes dhe dorëzimit të detyrës, si dhe veprimet që kryejnë strukturat e tjera të institucionit në këtë proces (Njësia e burimeve njerëzore, Financa etj.). Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen e aktiveve, bazën e të dhënave, transmetimin e të dhënave lidhur me punën nga një punonjës te tjetri etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 13, VKM nr. 124, datë 17.2.2016

Ëpër pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil, pikat 27 deri 30, Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 ËKodi Punës i Republikës së Shqipërisë dhe i ndryshuar, nenin 25 ËDetyrimi i dhënies llogari dhe i kthimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën A.1, faqe 14-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandim: Nga Titullari i njësisë vendore të hartohen rregulla të shkruara për veprimet që kryhen nga punonjësi dhe strukturat përkatëse të kësaj njësie gjatë marrjes dhe dorëzimit të detyrës. Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Financës, të marrin të gjitha masat e nevojshme që përpara largimit nga puna, punonjësi të bëjë dorëzimin e plotë të dokumentacionit që ka për shkak të detyrës, si dhe të inventarit fizik në ngarkim, sipas kartelës përkatëse për këtë qëllim.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi. Në Bashkinë Dibër është organizuar dhe funksionon struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), e cila është e përbërë nga Përgjegjësi i Sektorit, i cili është i pajisur me certifikatën e auditit të brendshëm, si dhe dy specialistë të cilët nuk janë të pajisur me këtë certifikatë. Nuk është bërë kontrolli i cilësisë së auditimit të kryer.

Për vitin 2018 nga 6 auditime të planifikuara janë realizuar 6, nga ku janë konstatuar 51 gjetje dhe janë lënë 51 rekomandime me karakter organizativ.

Për vitin 2019 nga 5 auditime të planifikuara janë realizuar 4, nga ku janë konstatuar 14 gjetje dhe janë lënë 14 rekomandime me karakter organizativ.

Për vitin 2020 nga 5 auditime të planifikuara janë realizuar 3 auditime deri në datën 30.06.2020, nga ku janë konstatuar 14 gjetje dhe janë lënë 14 rekomandime me karakter organizativ.

Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, taksat dhe tarifat vendore, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, ËPër miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar, nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 ËPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm i miratuar me UMF nr. 100, datë 25.10.2016, Kap. II, pika 10 (*Më hollësisht trajtuar në pikën A.2, faqe 16 - 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandim: NJAB të marrë masat e nevojshme për të rritur cilësinë e auditimeve në zbatim të standardeve dhe kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Kjo njësi, në planet e saj vjetore të programojë auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, të ardhurat, pasqyrat financiare etj., në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. NJAB të ketë në monitorim të vazhdueshëm funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Kryetari i Bashkisë Dibër të marrë masat e nevojshme për të pajisur me certifikatën e auditit të brendshëm dy audituesit e njësisë së auditit të brendshëm, të cilët nuk e kanë këtë certifikatë.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Bashkia Dibër është audituar nga KLSH në vitin 2018 dhe në vijim është bërë verifikimi i zbatimit të rekomandimeve, por nga auditimi konstatohet se njësia vendore nuk ka marrë masa të plota për realizimin e të gjitha rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Nga 13 masa organizative të lëna për zbatim, janë zbatuar plotësisht 5 masa, janë në proces zbatimi 6 masa dhe nuk janë zbatuar 2 prej tyre. Nga 9 masa për shpërbllim dëmi në vlerën 71,835,683 lekë është kontabilizuar e gjithë vlera, por nuk janë realizuar arkëtimet. Në zbatim të rekomandimeve të KLSH, Agjencia e Prokurimit Publik ka

dërguar vendimin nr. 4 datë 16.01.2019, në të cilin ka vendosur të dënojë me gjobë 15 punonjës në vlerën 3,020,000 lekë, nga e cila është arkëtuar vlera 167,232 lekë nga 6 punonjës, pa arkëtuar vlera prej 2,852,768 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 89-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të KLSH në auditimin e mëparshëm. Të vazhdohet ndjekja dhe zbatimi i masave që rezultojnë ende të pa zbatuara dhe të përshpejtohet zbatimi i atyre që janë në proces. Drejtoria juridike të ndjek të gjitha procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerave për shpërblim dëmi prej 71,835,683 lekë të lëna nga KLSH.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratave me nr. 48/9 prot datë 20.11.2018, me objekt òRikonstruksion i godinave në pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore për strehim socialë, Bashkia Dibër, si dhe me nr. 35/13 prot datë 01.08.2019, me objekt òSistemim Asfaltim i rrugës së fshatit Melan, Nj.A Melanë Bashkia Dibër, nuk është lidhur kontrata me kolaudatorin e punimeve, në kundërshtim me nenin nr.12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën D.2, faqe 82-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandim: Nga Bashkia Dibër të merren masa që shërbimi i kolaudit të objekteve të kryhet pasi të lidhet kontrata me kolaudatorin, në të cilën të sanksionohen të drejtat dhe detyrat e palëve kontraktore, në mënyrë që të dalin përgjegjësitë për volumet dhe cilësinë e punimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Dibër nuk janë llogaritur detyrime për taksat dhe tarifave vendore për subjektet të cilat kanë zhvilluar aktivitetet në territorin e njësive vendore, si rezultat i lidhjes së kontratave për kryerjen e punimeve, gjatë shpalljes fitues në procedurat e prokurimit publik. Këto veprime janë në kundërshtim me paketën fiskale, miratuar me VKB Dibër nr.107, datë 20.12.2017 dhe nr.138, datë 24.12.2018 òPër miratimin e paketës fiskaleë e në vazhdim, neni 43 pika 1/1, të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëë i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreë i ndryshuar, Kreut VII, neni 35 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëë i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe UMF nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1 (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1, faqe 24-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1 Rekomandim: Nga sektori i prokurimeve, të merren masat që me lidhjen e kontratës për kryerjen e punimeve ndërmjet Bashkisë Dibër dhe operatorit ekonomik të shpallur fitues, të njoftohet sektori i taksave dhe tarifave vendore me qëllim për llogaritjen e detyrimeve për subjektin sipas VKB përkatëse për taksat dhe tarifave vendore.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr. 51/19 prot datë 27.12.2019, me objekt òMirëmbajtje dimërore e rrugëve rurale 2019ö, Bashkia Dibër, të lidhur me kontraktorin òS.ö SHPK, me vlerë të kontratës 3,860,100 lekë me TVSH, u konstatua se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me orët e punës të realizuara nga sipërmarrësi i punimeve. Volumet e përcaktuara me njësinë "Orë Pune", janë subjektive dhe nuk kanë asnjë mundësi verifikimi ose mundësi matjeje konkrete. Nga verifikimi i dosjes nuk është realizuar asnjë analizë se si janë matur apo verifikuar orët e punës të realizuara nga sipërmarrësi, por janë marrë të mirëqena. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 56-74 të Raportit Përfundimtar të Ri-Auditimit*).

14.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër të marrë masa në të ardhmen, të ngrejë një grup pune të veçantë, për të analizuar dhe detajuar orët e punës për objektet e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve, në mënyrë që vlera e punës së realizuar të dokumentohet saktë dhe të jetë sa më afër realitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit neni 15 germa (b) dhe (c) *óTë drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 *óKodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për vetëqeverisjen vendore dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, **nga Titullari i Njesisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **10,362,487 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Dibër ka lidhur kontrata për dhënin me qira të aseteve të cilat janë pronë e njësisë vendore, por llogaritja e vlerës së qirasë nuk është bërë e saktë, duke bërë që qiramarrësit të kryejnë pagesë më të ulët se vlera e duhur. Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën e auditimit u konstatua se:

a) Subjekti *óA.óShPK* dhe *óB.ó ShPK* me NIPT L.....R dhe K.....O kanë marrë në përdorim sipërfaqen 1.0535 ha, e cila është pjesë e fondit pyjor/ kullor të Bashkisë Dibër, por nga auditimi konstatohet se subjektet i detyrohen Bashkisë Dibër vlerën 3,074,174 lekë, për arsye se nga ana e njësisë vendore nuk janë zbatuar kërkesat e VKM nr.391, datë 2.6.2006 për përcaktimin e tarifës në sektorin e pyjeve dhe kullotave të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010, lidhja 2, neni 11 dhe 12.

b) Subjekti *óH. L.ó ShPK* me NIPT L.....H, ka marrë në përdorim sipërfaqen prej 0.1416 ha, e cila është pjesë e fondit pyjor/ kullor të Bashkisë Dibër. Në nenin nr. 3 të kontratës lidhur mes palëve, është përcaktuar afati i kontratës 10 vjet, duke filluar nga data 05.03.2015 deri më datën 04.03.2025. Në kontratë është përcaktuar se vlera e qirasë është 68,260 lekë, e cila do të paguhet vitin e parë, ndërsa për vitet e tjera qiraja është lënë zero lekë, si rezultat i së cilës nga auditimi rezultoi se subjekti detyrohet ti paguaj njësisë vendore vlerën 2,386,410 lekë.

c) Subjekti *óL. E.ó ShPK* me NIPT L.....Q, ka marrë në përdorim sipërfaqen 0.1162 ha, e cila është pjesë e fondit pyjor/ kullor publik të Bashkisë Dibër. Në nenin nr. 3 të kontratës është përcaktuar afati i kontratës 10 vjet (2017-2027). Nga përllogaritja jo e saktë e vlerës së qirasë në kontratë rezulton se subjekti detyrohet ti paguaj njësisë vendore vlerën 88,425 lekë.

d) Subjekti *óH. S.ó ShPK* me NIPT L.....T, ka marrë në përdorim me qira sipërfaqen prej 2.7086 ha, me afat 10 vjeçar. Me këtë subjekt është lidhur dhe një kontratë qiraje tjetër me ish Komunën Lurë për përdorim të sipërfaqes prej 4.4856 ha, e cila është pjesë e fondit pyjor/ kullor publik ish Komuna Lurë. Në nenin nr. 3 të kontratës është përcaktuar afati i kontratës 10 vjet (2015-2025). Nga përllogaritja jo e saktë e vlerës së qirasë në kontratë, për periudhën e auditimit subjektit i lind detyrimi ndaj njësisë vendore në vlerën 2,945,495 lekë.

Në total, për katër rastet e mësipërme, për arsye se në llogaritjen e vlerës së qirasë është vepruar në kundërshtim me VKM nr 1064 datë 22.12.2010 për disa ndryshime në vendimin nr. 391 datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave pika 2 lidhja 11, Bashkisë Dibër i është shkaktuar **një dëm**

ekonomiknë vlerën 8,494,504 lekë (Më hollësisht trajtuar në pikën B.1, faqe 24-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtoria Juridike të merren masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **8,494,504 lekë**, sipas subjekteve në vijim:

- Subjekti òA.ò ShPK & òB.ò ShPK, për vlerën 3,074,174 lekë;
- Subjekti òH. L.ò ShPk, për vlerën 2,386,410 lekë;
- Subjekti òL. E.ò ShPK, për vlerën 88,425 lekë;
- Subjekti “H. S.ò ShPK për vlerën 2,945,495 lekë

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt òSistemim Asfaltim i rrugës së fshatit Melan, Nj.A Melan, Bashkia Dibërò, me vlerë të kontratës 16,025,471 lekë pa TVSH, lidhur midis Bashkisë Dibër dhe kontraktorit òS.ò ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **1,151,623 lekë pa TVSH, dëm ekonomik në buxhet**, në zërat e punës òGërmim dheu në trup rruge + kanal me eskavatorò, òMbjellje bari në skarpatet e gërmimit dhe mbushjesò, òKunetë betoni M-200ò, òStruktura monolite bruto betoni me 20% gur, muret mbajtëse dhe uraò dhe òBeton M-200 për kokat e tombinoveò, etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr.35/13 prot., datë 01.08.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër dhe kontraktorit òS.ò ShPK (Më hollësisht trajtuar në pikën D.2, faqe 82-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtoria Juridike të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,151,623 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve òS.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 35/13 prot datë 01.08.2019, me objekt òSistemim Asfaltim i rrugës së fshatit Melan, Nj.A Melan Bashkia Dibërò, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt òRikonstruksion i godinave në pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore për strehim socialò Bashkia Dibër, me vlerë 5,464,088 lekë pa TVSH, lidhur midis Bashkisë Dibër dhe kontraktorit òR.ò ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt, në vlerën **336,610 lekë pa TVSH**, në zërat e punës òFV tub shkarkimi lavamaniò, òSuvatime të brendshmeò dhe òFV dyer të jashtme të blinduaraò. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 48/9 prot datë 20.11.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër dhe kontraktorit òR.ò ShPK (Më hollësisht trajtuar në pikën D.2, faqe 82-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtoria Juridike të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **336,610 lekë pa TVSH**, nga OE òR.ò ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 48/9 prot., datë 20.11.2018, me objekt òRikonstruksion i godinave në pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore për strehim socialò, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt òSistemim Asfaltim i lagjes Llixha-Banjë-Bunisht, Nj.A. Peshkopiò, Bashkia Dibër, me vlerë të kontratës 9,222,222 lekë pa TVSH, lidhur midis Bashkisë Dibër dhe kontraktorit BOEòE.ò ShPK & òS.2.ò ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt, në vlerën 250,150 lekë pa TVSH, në zërat òTransport zhavorri me auto deri 2 kmò, òTransport betoni me auto betoniere 2.5 kmò dhe òStrukturë monolite betoni C 10/15 për murin+kanalò. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr.

35/13 prot., datë 01.08.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër dhe BOE òE.ò ShPK & òS.2.ò ShPK (Më hollësisht trajtuar në pikën D.2, faqe 82-89të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtorja Juridike të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **250,150 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve òE.ò ShPK & òS.2.ò ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 35/13 prot datë 01.08.2019, me objekt òSistemim Asfaltim i lagjes Llixha-Banjë-Bunisht, NjA Peshkopiò, Bashkia Dibër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Punime, ndërtime, rehabilitime dhe mirëmbajtje të kanaleve ujitëse, me vlerë të kontratës 11,614,380 lekë me TVSH, nga sipërmarrësi i punimeve òE." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 129,600 lekë pa tvsh, në zërin òGërmim dheu me eskavator goma, 0.25m³, me shk në tokë për pastrim shembje dhe mbetje urbane, kanal furnizuarò, dhe òFV tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=400mmò, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 74-158 të Raportit Përfundimtar të Ri-Auditimit).

5.1. Rekomandim: Bashkia Dibër të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën **129,600 lekë**, nga sipërmarrësi i punimeve òE.òSHPK.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMIMIN E PALIGJSHMËRISË, PARREGULLSIVE, EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimeve të zhvilluara në Bashkinë Dibër, u konstatua se pesë procedura prokurimi të zhvilluara në vitin 2018 dhe konkretisht òPunime ndërtimi, rehabilitim, rikonstruksion, mirëmbajtje e rezervuarëve dhe kanaleve ujitëse, Bashkia Dibërò, me fond limit 9,992,079 lekë, òMirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale, Bashkia Diber, 2018ò me fond limit 5,833,333 lekë, òRehabilitim i Ambienteve te jashtme te Shkollës se Mesme Maqellareò, me fond limit 3,538,477lekë, òBlerje artikuj ushqimorë për nevojat e kopshteve dhe çerdheve të Bashkisë Dibër për vitin 2018ò me fond limit 4,462,805 lekë dhe òBlerje dru zjarri per nevojat e Institucioneve Arsimore, Bashkia Dibërò me fond limit 10,500,000 lekë, janë kryer në kundërshtim me nenin 2, òParimet e përzgjedhjesò, nenin 55, òKriteret e përcaktimit të ofertës fitueseò, nenin 24, òAnulimi i një procedure prokurimiò dhe pika 5 e nenit 53, òShqyrtimi i ofertaveò, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër rregullat e prokurimit publikò, i ndryshuar, pasi:

Operatorët ekonomikë janë shpallur fitues edhe pse nuk plotësojnë kriteret për kualifikim të vendosura në DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor. Në të gjitha këto raste tenderi duhej të anulohet. Mos anulimi i procedurës së prokurimit ka çuar në kualifikim dhe shpallje fitues të OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, duke shkaktuar përdorim të fondeve publike në kushtet e paligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik, në një vlerë prej **33,345,802 lekë** (shuma e vlerave të kontratave të lidhura me këta operatorë ekonomikë). Konkretisht procedurat e prokurimit të cilat duhet të ishin anuluar:

1. ÷Punime ndërtimi, rehabilitim, rikonstruksion, mirëmbajtje e rezervuarëve dhe kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër, me fond limit 9,992,079 lekë, zhvilluar në vitin 2018, shpallur fitues OE ÷E.÷ ShPK, me vlerë të kontratës 9,678,650 lekë pa TVSH;
2. ÷Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale, Bashkia Dibër, 2018, me fond limit 5,833,333 lekë, zhvilluar në vitin 2018, shpallur fitues OE ÷S.÷ ShPK, me vlerë të kontratës 5,789,313 lekë pa TVSH;
3. ÷Rehabilitim i ambienteve të jashtme të Shkollës së Mesme Maqellarë, me fond limit 3,538,477 lekë, zhvilluar në vitin 2018, shpallur fitues OE ÷D. N.÷ ShPK, me vlerë të kontratës 3,365,623 lekë pa TVSH;
4. ÷Blerje Artikuj Ushqimorë për nevojat Kopshteve dhe Çerdheve të Bashkisë Dibër për vitin 2018, me fond limit 4,462,805 lekë, zhvilluar në vitin 2018, shpallur fitues OE ÷J.÷ ShPK, me vlerë të kontratës 4,135,676 lekë pa TVSH;
5. ÷Blerje dru zjarri për nevojat e Institucioneve Arsimore, Bashkia Dibër, me fond limit 10,500,000 lekë, zhvilluar në vitin 2018, shpallur fitues OE ÷S. V.÷, me vlerë të kontratës 10,376,540 lekë;

(Më hollësisht trajtuar në pikën D.1, faqe 50-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të analizojë shkaqet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për anomalitë e konstatuara në gjashtë procedurat e mësipërme të prokurimi, në të cilat janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST. Të marrë masa nëpërmjet strukturave përkatëse të prokurimit publik, për eliminimin e praktikave të tilla në të ardhmen.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën Janar 2018 - Dhjetor 2020, për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim për largime nga puna të punonjësve, si dhe me objekt për çështje të tjera gjyqësore, si ÷kthim detyrimi, ÷shpërblim dëmi, ÷detyrim situacioni, etj., Bashkia Dibër ka shpenzuar vlerën **66,962,990 lekë gjithsej**, e cila përbën efekt negativ financiar në buxhetin e njësisë vendore.

Vetëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim për largime nga puna të punonjësve është shpenzuar vlera 12,915,472 lekë, prej së cilës 2,298,136 lekë për 18 raste i përket vitit 2018, ndërsa vlera 10,617,336 lekë në vitin 2019 për 39 raste. Koha e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës së punonjësve për rastet e mësipërme, i përket periudhës 2015-2016, e cila përkon me zbatimin e reformës administrative-teritoriale, përveç një rasti i cili i përket vitit 2018.

Për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt për çështje të tjera gjyqësore, Bashkia Dibër për periudhën Janar 2018-Dhjetor 2020, ka likuiduar vlerën 54,047,518 lekë (për vitin 2018 vlera 3,300,000 lekë, për vitin 2019 vlera 21,598,029 dhe për periudhën Janar-Dhjetor 2020 vlera 29,149,489 lekë).

Periudha në të cilën janë hapur çështjet gjyqësore që lidhen me pagesat e mësipërme, kryesisht shtrihet përpara vitit 2018 (viti 2006, 2012 etj, përveç katër çështjeve gjyqësore, dy prej të cilave i përkasin vitit 2018 dhe dy vitit 2019).

Konstatohet se përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga Titullari i njësisë vendore nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62, të udhëzimit nr. 2, datë 06.02. 2012 ÷Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit÷*(Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 19-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dibër, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore, të nxjerrë përgjegjësitë dhe arsyet që kanë çuar në lindjen e një procesi të tillë gjyqësor, arsyet për humbjen e tyre, që të kuptohet se çfarë praktika janë bërë të gabuara, me qëllim shmangien e tyre në të ardhmen.

Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga sektori juridik dhe titullari të zbatohen të gjitha procedurat e nevojshme të afateve të njoftimit dhe të pagesave të duhura ligjore, me qëllim që të ulët risku i humbjes së proceseve gjyqësore. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor titullari të nxjerr përgjegjësitë administrative për personat përgjegjës, si dhe aktin që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës për objektet ÷ Punime ndërtimi, rehabilitim, rikonstrukcion, mirëmbajtje e rezervuarëve dhe kanaleve ujitëse, Bashkia Dibëro dhe ÷ Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje të kanaleve ujitëse NjA, Bashkia Dibëro, rezultuan kamat vonesa në shumën **1,914,359 lekë**.

Sipas komenteve të paraqitura nga Bashkia Dibër, në adresën zyrtare të postës elektronike si dhe me shkresën protokolluar në KLSH me nr. 466/2 prot., datë 30.07.2020, vonesat në përfundimin e punimeve kanë qenë të justifikuar. Nga dokumentacioni i paraqitur në observacion për projekt raportin e auditimit, merren në konsideratë komentet dhe dokumentet shoqëruese, të cilat i lihen për detyrë drejtorisë së auditit të brendshëm të realizojë një analizë dhe verifikim të veçante, mbështetur në dokumentacionin financiar të bankës dhe mbi zbatimin e kontratave të cituara në projekt raport. Nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Dibër, të marren masa për realizimin e kësaj detyre, me paraqitjen e planit të punës për zbatimin e rekomandimeve. Grupi i auditimit ka marrë në konsideratë faktin që nga Bashkia Dibër ka patur financime të ulëta mbi kontrata publike. Në raportin përfundimtar kamatëvonesat do të konsiderohen si efekte negative financiare në kundërshtim me parimet e efektivitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit, deri në analizimet financiare nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën D.1, faqe 50-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Dibër, Drejtoria e Auditit të Brendshëm, mbështetur në dokumentacionin financiar dhe të zbatimit të kontratave të cituara në Raport Përfundimtar të ushtrojë auditim mbi vërtetësinë e tyre dhe të paraqesë planin e auditimit me paraqitjen e planit të punës për zbatimin e rekomandimeve dhe rezultatet me përfundimin e auditimit.

Deri më 31.12.2021

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga puna e pa mjaftueshme e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër, borxhi tatimor i krijuar vetëm gjatë vitit 2019 ka vlerën 20,015,289 lekë. Borxhi progresiv në datën 31.12.2019 ka vlerën **47,459,984 lekë**, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore, e cila përbëhet nga:

-270 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 7,427,427 lekë

-15,568 familje debitorë për tokën bujqësore në vlerën 6,494,144 lekë

-22,153 familje debitorë për tarifatat vendor në vlerën 26,210,566 lekë

- vlera 7,327,847 lekë, e cila përbën detyrim për taksën e ndikimit në infrastrukturë për vitin 2018 në vlerën 5,385,190 lekë, për 139 taksapagues, vitin 2019 në vlerën 1,942,657 lekë për 53 taksapagues.

Borxhi tatimor i krijuar gjatë vitit 2019 në vlerën 20,015,289 lekë, përbëhet nga:

-106 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël 2,997,045 lekë

-7,472 familje debitorë për tokën bujqësore në vlerën 3,141,029 lekë

-10,072 familje debitorë për tarifatat vendore në vlerën 11,934,558 lekë

- 53 taksapagues për taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 1,942,657 lekë.

Mos arkëtimi i plotë i detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përveçse është mos përmbushje e detyrimeve ligjore, sipas detyrës funksionale të punonjësve të kësaj strukture, krijon mungesa financiare në buxhet dhe për pasojë ulë nivelin e investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njësia vendore ka parashikuar në shërbim të komunitetit. Mungesa e të ardhurave është ndikim i drejtpërdrejtë në mosrealizimin e buxhetit në zërin e shpenzimeve për periudhën 2018-2019.

Nga Bashkia Dibër nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore në rend shterues, për arkëtimin e debitorëve, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendore, nenet 91, të ligjit nr. 9920 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë ò i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1, faqe 24-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Drejtori Juridik dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **47,459,984lekë**. Për këtë, *për të gjitha subjektet e private* të nxjerrë njoftim vlerësimet tatimore dhe në vazhdim të merren masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankar.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë).

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të **bëhet kallëzim penal.**

e- Për debitorët familjar, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës, të ndërtesave dhe tarifatat familjare dhe të realizojë arkëtimin e detyrimit të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Deri më 31.12.2021

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për procedurat e dhënies me qira të aseteve të njësisë vendore për periudhën janar 2018-qershor 2020, u konstatua se për dy subjekte të cilët janë të pajisura me leje nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, Bashkia Dibër nuk ka lidhur kontratë qiraje, si rrjedhojë krijimin e të ardhurave të munguara si vijon:

a- Subjektit òH.ò ShPK, me sipërfaqe sipas lejes 0,5 ha, nuk i janë llogaritur detyrimet për këtë sipërfaqe në vlerën 550,000 lekë, e ardhur e munguar për njësinë vendore;

b- Subjektit òP.ò ShPK, me sipërfaqe 216,5 ha, nuk i janë llogaritur detyrimet për këtë sipërfaqe në vlerën 238,150,000 lekë, e ardhur e munguar për njësinë vendore.

Mos lidhja e kontratës nga njësia vendore, është në kundërshtim me pikën 2, lidhja nr.2, pika 6/1 dhe pika 9/4 të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, me VKM 1064 datë 22.12.2010 "Për Përcaktimin e Tarifave në Sektorin e Pyjeve dhe të Kullotave" (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1, faqe 24-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtorja Juridike të marrin të gjitha masat e duhura ligjore për lidhjen e kontratave të qirasë me dy subjektet e mësipërme, të cilat janë miratuar me leje nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, dhe shfrytëzojnë sipërfaqet pyjore dhe kullosore që administrohen nga njësia vendore, si dhe të kërkojnë arkëtimin e

vlerës 550,000 lekë nga subjekti òH.ò ShPK dhe vlerës 238,150,000 lekë nga subjekti òP.ò ShPK.

Deri më 31.12.2021

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për arkëtimin e taksës për lëshimin e autorizimeve/licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, naftës, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundor, u konstatua se nga Bashkia Dibër nuk janë marrë të gjitha masat e duhura ligjore për paisjen me autorizim dhe arkëtimin e detyrime për 11 subjekte, duke shkaktuar **të ardhura të munguara në vlerën 13,800,000 lekë**, konkretisht: Subjekti òK.ò ShPK në vlerën 800,000 lekë, subjekti òM. 96òShPK në vlerën 800,000 lekë, subjekti òS. G.ò ShPK në vlerën 800,000 lekë, subjekti òA.ò ShPK në vlerën 800,000 lekë, subjekti òD.ò ShPK në vlerën 800,000 lekë, subjekti òO. E.ò ShPK në vlerën 800,000 lekë, subjekti òB.ò ShPK në vlerën 1,000,000 lekë, subjekti òM. M.ò në vlerën 1,000,000 lekë, subjekti òH. 2014ò ShPK në vlerën 800,000 lekë, subjekti òK. P.ò ShPK në vlerën 1,000,000 lekë, subjekti òI. N.ò në vlerën 1,000,000 lekë. Nga njësia vendore është vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò, i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa òbò, pika 9, *(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1, faqe 24-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

3.1. Rekomandim: Bashkia Dibër, nëpërmjet Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **13,800,000 lekë** për 16 subjektet e mësipërme, me aktivitet tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, naftës, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundor.

Deri më 31.12.2021

4. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Dibër nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT). Për periudhën janar 2018-Dhjetor 2020, nga Policia Bashkiake janë vendosur 116 gjoba me vlerë 171,000 lekë, por janë arkëtuar vetëm 25,000 lekë, pa arkëtuar vlera **146,000 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Dibër (për vitin 2018 vlera 19,000 lekë, për vitin 2019 vlera 23,000 lekë, për vitin 2020 vlera 104,000 lekë).

Nga IMT janë vendosur gjithsej 30 gjoba, 23 prej të cilave janë në vlerën **1,350,000 lekë** dhe nuk janë arkëtuar, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Dibër (për vitin 2018 vlera 1,050,000 lekë, për vitin 2019 vlera 250,000 lekë, për vitin 2020 vlera 50,000 lekë). Nga Policia Bashkiake dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, pas aplikimit të gjobës ndaj kundravajtësit, nuk është bërë dorëzimi i aktit të gjobës në Drejtorinë e Financës, duke mos bërë të mundur rregjistrimin dhe kontabilizimin, njohjen e gjendjes për gjobat e pa arkëtuar, si dhe marrjen e masave në kohë për arkëtim *(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1, faqe 24-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

5.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtoria Juridike, të ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e gjobave të pa arkëtuar të Policisë Bashkiake dhe të IMT, respektivisht në vlerën **146,500 lekë** dhe në vlerën **1,350,000 lekë**. Në rastet e aplikimit të gjobave nga këta sektorë, kopje origjinale e aktit të gjobës të dorëzohet në financë për arsye kontabilizimi, evidentimin e debitorëve në kohë dhe marrjen e masave për arkëtim nga strukturat përkatëse.

Deri më 31.12.2021

F. MASA ADMINISTRATIVE

I.Referuar parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 òPër kundërvajtjet administrativeò, si dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, òPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) ndaj **9 (nëntë)punonjësve**, për shkeljet në procedurat e prokurimit si më poshtë:

a) Për katër anëtarët e njësisë së prokurimit:

1. Z. F. K., me detyrë ish përgjegjës i sektorit të prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për shkeljet e konstatuara në katër procedura prokurimi si vijon:

- “*Punime ndërtimi, rehabilitim, rikonstruksion, mirëmbajtje e rezervuarëve dhe kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër*”, viti 2018ò, me fond limit 9,992,079 lekë, zhvilluar me datë 23.05.2018.

- ò*Rehabilitim i Ambienteve të jashtme të Shkollës së Mesme Maqellare*”, viti 2018ò, me fond limit 3,538,477 lekë, zhvilluar me datë 31.10.2018.

- “*Blerje karburant (Naftë) për nevojat e Bashkisë Dibër, viti 2020*”, me fond limit 10,000,000 lekë, zhvilluar me datë 12.03.2020.

- “*Blerje dru zjarri për nevojat e Bashkisë Dibër për vitin shkollor 2019-2020*”, me vlerë të fondit limit 11,250,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.06.2019.

2. Znj. I. S., me detyrë specialiste prokurimesh, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për shkeljet e konstatuara në katër procedura prokurimi si vijon.

- “*Punime ndërtimi, rehabilitim, rikonstruksion, mirëmbajtje e rezervuarëve dhe kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër*”, viti 2018ò, me fond limit 9,992,079 lekë, zhvilluar me datë 23.05.2018.

- ò*Rehabilitim i Ambienteve të jashtme të Shkollës së Mesme Maqellare*”, viti 2018ò, me fond limit 3,538,477 lekë, zhvilluar me datë 31.10.2018.

- “*Blerje karburant (Naftë) për nevojat e Bashkisë Dibër, viti 2020*”, me fond limit 10,000,000 lekë, zhvilluar me datë 12.03.2020.

- “*Rrugë Rikonstruksion dhe mirëmbajtje e kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër, 2020*”, me fond limit 7,492,066 lekë, zhvilluar me datë 23.04.2020.

3. Z. N. S., me detyrë ish-specialist i administrimit të regjistrimit në drejtorinë e planifikimit dhe kontrollit të territorit, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për shkeljet e konstatuara në dy procedura prokurimi si vijon:

- “*Punime ndërtimi, rehabilitim, rikonstruksion, mirëmbajtje e rezervuarëve dhe kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër*”, viti 2018ò, me fond limit 9,992,079 lekë, zhvilluar me datë 23.05.2018.

- ò*Rehabilitim i Ambienteve të jashtme të Shkollës së Mesme Maqellare*”, viti 2018ò, me fond limit 3,538,477 lekë, zhvilluar me datë 31.10.2018.

- “*Rrugë Rikonstruksion dhe mirëmbajtje e kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër, 2020*”, me fond limit 7,492,066 lekë, zhvilluar me datë 23.04.2020.

Tre anëtarët e mësipërm të njësisë së prokurimit, kanë vepruar në kundërshtim me VKM 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, Neni 26- Kontrata për punë publike, pika a, pika 5, pika 6, neni 61 pika nr.1. nr.2, pasi nuk kanë argumentuar të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DST.

4.Z. A. C., me detyrë përgjegjës i sektorit të mbrojtjes së mjedisit, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për arsye se në tenderin me objekt “*Ndërtim i Shkollës 9-vjeçare, Fshati*

Kërçisht, Bashkia Dibër, 2019”, me vlerë të fondit limit 44,552,166 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 02.12.2019 i ka propozuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor anulimin e tenderit. (Më hollësisht trajtuar në pikën D.1, faqe 50-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

b) Për 4 anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Titullarin e AK:

1. **Z.E. S.**, me detyrë ish-përgjegjës sektori i planifikimit të territorit dhe studim projektimit;
2. **Z.I. S.**, me detyrë specialist prokurimesh;
3. **Z. E. M.**, me detyrë ish-specialist prokurimesh, për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit, si vijon:

-“*Punime ndërtimi, rehabilitim, rikonstruksion, mirëmbajtje e rezervuarëve dhe kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër, viti 2018*”, me fond limit 9,992,079 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.05.2018.

-“*Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale, Bashkia Dibër, viti 2018*”, me fond limit 5,833,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 02.11.2018.

-“*Rehabilitim i ambienteve të jashtme të Shkollës së Mesme Maqellarë*”, viti 2018”, me fond limit 3,538,477 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.10.2018.

-“*Mirëmbajtje e kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër, 2020*”, me fond limit 7,492,066 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.04.2020.

-“*Blerje dru zjarri për nevojat e Institucioneve Arsimore, Bashkia Dibër, viti 2018*”, me fond limit 10,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.08.2018.

-“*Ndërtim i Shkollës 9-vjeçare, Fshati Kërçisht, Bashkia Dibër, 2019*”, me vlerë të fondit limit 44,552,166 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 02.12.2019.

4. **Z. R. K.**, me detyrë specialist prokurimesh, për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit si vijon:

- “*Ndërtim i Shkollës 9-vjeçare, Fshati Kërçisht, Bashkia Dibër, 2019*”, me vlerë të fondit limit 44,552,166 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 02.12.2019.

- “*Blerje dru zjarri për nevojat e Institucioneve Arsimore, Bashkia Dibër, viti 2018*”, me fond limit 10,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 06.08.2018.

- “*Mirëmbajtje e kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër, 2020*”, me fond limit 7,492,066 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.04.2020.

Katër anëtarët e mësipërm të KVO, gjatë vlerësimit të ofertave kanë shpallur fitues operatorë ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret për kualifikim të vendosura në DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor. Në të gjitha këto raste procedura e prokurimit duhej të anulohet. Mos anulimi ka çuar në kualifikim dhe shpallje fitues të OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, duke shkaktuar përdorim të fondeve publike në kushtet e paligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik.

5. Për Titullarin e Autoritetit Kontraktor **z. D. I.**, për shkeljet e konstatuara në procedurën prokurimit në *Ndërtim i Shkollës 9-vjeçare, Fshati Kërçisht, Bashkia Dibër, 2019*ö, me vlerë të fondit limit 44,552,166 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 02.12.2019, procedurë e cila është anuluar në kundërshtim me nenin nr. 24 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 për Prokurimin Publikö, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën D.2, faqe 50-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

II. Për përjashtim nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik

Bazuar në nenin 13, pika 3/a, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, për prokurimin publikö, ndryshuar, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, **përjashtimin nga procedurat e prokurimit publik për një vit të operatorit ekonomik “N.” SHPK**, për shkeljet e mëposhtme:

Operatori ekonomik öN.ö SHPK është shpallur fitues në procedurën e prokurimit publik me objekt öShërbim Interneti për Njësitë Administrative për vitin 2018”, me vlerë të fondit limit

800,000 lekë, me vlerë të ofertës 599,000 lekë. Në vijim, midis këtij operatori ekonomik dhe autoritetit kontraktor Bashkia Dibër për realizimin e shërbimit është hartuar Formulari i Kontratës, sipas shkresës nr. 04/12 prot., datë 16.03.2018 e cila është firmosur nga autoriteti kontraktor dhe nga operatori ekonomik (OE) òN.ò, i shpallur fitues, por pas këtij veprimi OE nuk është paraqitur për kryerjen e shërbimit, duke mos përmbushur detyrimet kontraktuale, veprim që ka çuar në ribërjen e procedurës së prokurimit publik nga AK.

Bazuar në nenin 77, pika nr.2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, òMos përmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-sëò.

G. MASA DISIPLINORE

G.1.1 . Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, në zbatim të nenit 58, òllojet e masave disiplinoreò të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 òPër nëpunësin civilò, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 òPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilò dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 òPër vetëqeverisjen vendoreò, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Dibër, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për **13 (trembëdhjetë)** punonjësit e mëposhtëm:

a- Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, për punonjësit e mëposhtëm:

1.Z.B. M., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore,

2.Z.R. G. me detyrë Specialist i Sektorit tëTatim-Taksave dhe vlerave,

3.Z.D. S. me detyrëSpecialist i planifikimit të të ardhurave, për shkeljet si vijon: përmos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 òPër sistemin e taksave vendoreò, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, kreu XI-òMbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguaraò, Nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 23 dhe sipas pikës 2 të nenit 27 të dhe VKM. Nr.860 datë 10.12.2014,etj, lidhur me mos marrjen si duhet të masave për arkëtimin e detyrimit prej 47,459,984 lekë, më 31.12.2019.Për mos marrjen e masave për arkëtimin e tarifës të licencave të karburanteve për 11 subjekte të Bashkisë Dibër dhe të Njësisve Administrative, në vlerën 11,000,000 lekë, të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.

4. Znj.K. L. me detyrë Specialiste e pyjeve,

5. Z.V. T., Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, për mos llogaritje të saktë të detyrimeve të kontratave të dhënies më qira të pyjeve dhe kullotave, për subjektet e HEC-eve, në kundërshtim me VKM nr 1064 datë 22.12.2010 òPër disa ndryshime në vendimin nr. 391 datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotaveò pika 2 lidhja 11 (*Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqja 24 deri në faqen 38*)

6. Z.K. E. me detyrë specialist i pyjeve,

7. Z.I. G. me detyrë specialist i pyjeve, për mos veprim për lidhje kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga MEI, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore me sipërfaqe totale prej 217 ha, ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi (*Më hollësisht trajtuar faqe 24-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8. Z.E. X., me detyrë, Kryeinspektor i IMTV prej 11.04.2018 e në vazhdim,

- 9. Z.J. O.**, me detyrë inspektor i IMTV prej 27.06.2016 e në vazhdim,
- 10. Z. F. R.**, me detyrë inspektor i IMTV prej 17.08.2016 e në vazhdim,
- 11. Z. B. B.**, me detyrë inspektor i IMTV prej 23.04.2018 e në vazhdim, për shkeljet e përbashkëta si vijon: për mos marrje të masave për arkëtimin e gjobave të vendosura për periudhën objekt auditimi, bazuar në procesverbale të mbajtura dhe vendimet e gjobave të IMTV, për 23 raste në vlerën 1,350,000 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër, në kundërshtim me ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 ÷Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeö, i ndryshuar, ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 ÷Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritö, i ndryshuar, VKM nr. 894, datë 4.11.2015 ÷Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësive vendoreö; Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005ö Për zbatimin e punimeve të ndërtimitö; Udhëzim i KM nr. 3, datë 15.02.2001: ÷Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitö, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar faqe 24-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
- 12.Z. L. C.**, me detyrë Drejtor Ekonomik, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, për moszbatim të kërkesave të nenin 50-Angazhimet buxhetore, nenin 52-Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëö, i ndryshuar, UMF plotësues nr. 2, datë 10.01.2018, ÷Për buxhetin e vitit 2018ö, pikat 82-91 ó Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëö nenet 2, 3, 6, 9, 10,15,15, 27, 32, 52, etj., lidhur me zbatimin e buxhetit, me pasojë krijimin e detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2019 në vlerën 288,500,252 lekë (Më hollësisht trajtuar faqe 19-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
- 13. Znj.V. K.** me detyrë ish përgjegjëse e financës, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare, për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publikö, kapitulli IV. pika 74 dhe 96 dhe të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitet e Qeverisjes së Përgjithshmeö, lidhur me anomalitë e konstatuara në pasqyrat financiare Më hollësisht trajtuar faqe 38-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

G.1.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitö, shkronjat öeö dhe öçö, të nenit 1, kreun IV dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 öKodi i Punës në Republikën e Shqipërisëö, i ndryshuar, **nenit 12 –Masat disiplinore, të kontratës individuale të punës, i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Dibër**, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a- vërejtje me paralajmërim për largim nga puna, për 4 (katër) punonjës si më poshtë:

- 1. Z. D. T.** me detyrë ish inspektor i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore nga data 03.10.2018 deri në datën 15.06.2020, aktualisht, punonjës arkivi në Njësinë Administrative Maqellarë;
- 2. Z.I. M.** me detyrë ish inspektor i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore nga data 27.06.2016 deri në datën 14.04.2020, aktualisht punonjës i sektorit të transportit dhe ndriçimit;
- 3 . Z.L. G.** me detyrë ish inspektor i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore deri në datën 14.04.2020, aktualisht punonjës i sektorit të transportit dhe ndriçimit;

4. Z.M. Z. me detyrë inspektor Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore deri në datën 15.06.2020, aktualisht inspektor i taksave në Njësinë Administrative Tomin;

për shkeljet e mëposhtme:

Përmos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 òPër sistemin e taksave vendoreò, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, kreu XI-òMbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguaraò, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 23 dhe neni 27, pika 2 dhe VKM. Nr.860 datë 10.12.2014,etj, lidhur me mos marrjen e masave për arkëtimin e detyrimit progresiv prej 47,459,984 lekëderi në datën 31.12.2019.

G.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin emasës disiplinore.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” sipas të dhënave të mëposhtme:*

2. Znj. B. M. me detyrë ish inspektor Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, ndërprerë marrëdhëniet e punë me urdhrin nr.210, datë 15.06.2020

4. Z. S. T., me detyrë ish Drejtor i Drejtorisë së Teknologjive Bujqësore, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin nr.118, datë 25.06.2018.

Shënim: Për shtatë punonjësit që kanë bërë shkelje, mangësi apo të meta më të ulta se risku, nuk rekomandojmë masë disiplinore:

1. Z. I. K., me detyrë ish/Kryeinspektor i Policisë Bashkiake nga data 07.03.2018-29.05.2019, aktualisht specialist në Drejtorinë e Emergjencave Civile;

2. Z. M. M., me detyrë inspektor i Policisë Bashkiake, aktualisht i komanduar si Kryeinspektor në këtë strukturë, për shkak se anomalitë e konstatuara për dy personat e mësipërm dhe pasojat e parregullsive janë minimale (mos arkëtim i gjobave në vlerën 105,500 lekë për periudhën 2.5 vite).

Punonjësit e mëposhtëm janë konstatuar me shkelje vetëm në një procedurë prokurimi dhe shkeljet konsiderohen jo materiale:

3. Znj. L. S., me detyrë ish-specialiste prokurimesh, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për shkeljet e konstatuara në një procedurë prokurimi si vijon:

- *“Blerje karburant (Naftë) për nevojat e Bashkisë Dibër, viti 2020”*, me fond limit 10,000,000 lekë, zhvilluar me datë 12.03.2020.

4. Z.F. Z., me detyrë specialist prokurimesh, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për shkeljet e konstatuara në një procedurë prokurimi si vijon:

- *“Rrugë Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje e kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër, 2020”*, me fond limit 7,492,066 lekë, zhvilluar me datë 23.04.2020.

5. Znj. V. K., me detyrë ish-Përgjegjëse finance;

6.Znj.Z. G., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Arsimit, Kulturës dhe Turizmit;

7.Znj. L. M., me detyrë ish-specialiste e Sektorit të Arsimit, Kulturës dhe Turizmit, për shkeljet e përbashkëta të konstatuara në procedurën e prokurimit *“Blerje Artikuj Ushqimorë për nevojat Kopshteve dhe Çerdheve të Bashkisë Dibër për vitin 2018”*, me fond limit 4,462,805 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 05.04.2018.

H. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Dibër, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të **ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 öPër Nëpunësin Civilö, indryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 öPër Nëpunësin Civilö, indryshuar.

I. TË TJERA

Nisur nga fakti që,mbulimi me auditim i procedurave të Prokurimit Publik të periudhës 01.01.2020 ó 31.12.2020, nuk jep mundësinë e një sigurie të arsyeshme për dhënien e një opinionit të plotë, objektiv dhe të saktë të tyre, auditimi i procedurave të Prokurimit Publik për vitin 2020, do të kryhet në auditimin e radhës në Bashkinë Dibër.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

Grupi i Auditimit, sipas Programit të Auditimit nr.466/1 prot., datë 02.06.2020

1. B. M., përgjegjës grupi

2. A. Gj., auditues

3. G. H., auditues

4. L. B., auditues

5. A. Z., auditues

Grupi i Auditimit, sipas Programit të Ri-Auditimit nr.99/1, datë 04.02.2021

V. R., *Auditues*

A. K., *Auditues*

DREJTOR I DEPARTAMENTIT

M. LI.

